

Shtypshkronja "Vlora, në Vlore



Нрд. №. 141.470

PJES' E PARË


HISTORI

E

SHQIPËRISË SË RE


Mbi gjëndëjen, ngjarëjet dhe ndryshimet
fort t'enteseratëshme të gjallërimit

КОМВЁТАР



Kurkush nukē munt t'a botojē pa lején
e pa firmön tē auktorit





PARËTHËNËJE.

Vellezër të dashur! Shkaku që më shtyjti të shkruaj e të plotësoj pjesën e parë të kësaj Histori me shumë mundime e cila përmban tërë njëjarëjet e ndryshme që janë shkaktuar në Mëmëdhenë t'oni të dashur mbi kurris të popullit e të fisit eroik shqipëtar, nukë ishte tjatër gjë për veç më tepër dashuri e madhe e dëshir e plotë e shërbimit t'Atdheut dhe veçanërisht duk'e parë nevojën e madhe për një të tillë Histori të vogël e t'asnjanëshme e cila do të jetë një pasqyrë mbi tregimin e njëjarëjevet të çuditëshme; gjith ashtu Situata, gjendëja dhe njëjarëjet njëra pas tjatërsë qysh në kohëra të kaluara që vazhdoninë në Shqipëri me kishin çtuar kurajon, me kishin hequr ca më shumë vrejtëjen.

Nevoj'e njëj të tillë mejtimi, shërbimi për Shqipërin'e dashur e cila s'mundi dot më parë të përsitonte nga fatorët e samëshm të



saj duk'e bërë Shqipërinë me vete qysh nga kohërat e vjetëra, më ish dukur e domosdoshme që kurse gjëndeshë në mbsim mbi tryezat e Shkollavel por këjo dëshirë më ish çtuar akoma ca më tepër që kur se noroj'e kohës s'enteresit Kombëtar dhe të mejtimit të shenjtë t'Atdheut më kish shtyjtur në fushënë politike në euterës të lartë t'Atdheut.

Dëshir e thelpit të zëmërsë për realizimin e Ideulit kombetar shumë herë ish vënë në praktik duk'e shkrnajtur artikulla shumë t'enteresatshme më 1907-1911 në fletoret t'Amrikës si dhe në fletoren (Ymid) të Gjiritit në të cilat ishia shkronjës-korrispondent.

Me mish e me shpirt sakrifikova jetën t'ime për të sjellur ndonjë dobi Atdheut dhe no një mirësim enteresit të përgjithëshm të bashkatdhatarisë s'ime.

Gjilh- ashtu tash jam fort i kënaqur që munda të paraqit përpara juvej një vepër të tillën. Për të çpallnr akoma shërbimet e ndienjat me anë të libravet për dashurinë që ushqejte rrotull bashkimit, zgjimit e përhapëjes e dëshirës përparimtare e shoqërore në zvillimin, realizimin, bashkimin e mejtimeve të gjithë nënështetasvet shqipëtarë të cilët e të kenë çdo farë besimi, duhet pa tijatër të bashkohen me vëllezërit e vetë për t'a mirësuar.

sa më parë rëndin e tyrej që ka mbetur në duar të feodaleret, t'atdhetarëvet gjakpirës e të pa dijtur; gjith ashtu për realizimin e këtij qëllimi të shenjtë duhet punuar pa ldhur e me çdo mënyrë duk'e sakrifikuar jetë e pasuri që të ndihet një dhëmbëje e cila do të çfarojë krejt çdo çështje mizore që munt të luhet prej njerës të shitur e dashakeqër për që të mos mundë kurrë dot njeri të lozë si kurdoherë me fatin, jetën e shenjtë të fisit shqipëtar.

Me gjithë që fatkeqësisht kohërat e kalluara na suallën shnmë dëme e prishje të cilat shkakëtuanë antidobinë e jetës njërzore e kombëtare t' onën por për veç kësaj i shlyjtur nga dëshir'e onor i jetës shoqërore si me dashëje dhe pa dashëje refuzimi i razhdimit në rrjedhëjet e tmeruara antikombëtare të kohëravel të ndryshme të pushtimet e djallëzivet n'a suallë shumë ndalime në përsfundimin e qëllimit duk'e vuajtur, duk'e humbur kredit kredinë e pasurinë t'onë. Mbanë tjetër gjurmimi gjat e gjerë në formimin e njej fjalori mbi gjuhën e fjeshtë të rjetr të Labëris e disa libra të tiera si Letylrat e të vegjëjet, Histori e lustës së Janinës dke ajo e Ceno Sharrës më prunë shumë vonime në përsfundimin e botimit të shpejtë të pjesës e parë të kësaj Historie.



Ndofta shumë njëritë të ndryshmë e mëndie lartë merren që të bëjnë Historin' e Shqipërisë por ato do të dalën përpara popullit me një fytyrë të ndryshuar dhe mjastë të mërguer nga e drejta e nga enteres e kombit. Me këtë fjalë të mos pandehet se dua të them mbasë këjo Hishtori e vogël do të zërë plotësisht një t'atillë vent por jam sigur se vetëm do të jetë një bazë e mejtimevet themelore e cila do t'u shërbejë brezit të ri dhe opinionit e popullit për të ngrehur jepin'e godinës kombëtare. Munt të them se deshir e plotë e cila me kohë më ka shtytur e guxuar të kem kujdesimin më të plotë të mejtohem e të marr shënimë të dobishme e të duhura mbi këtë çështje me një karakter t'asnjanëshm, kam shpresë se do të shihet miaftë pëlqyer shërbimi i të nënëshkruarit duk' e përfytyruar gjarëjet e njëj kohë në të cilën për veç q'At-dheu i ynë ish ndarë më shumë lloisundimesh por akoma nukë kish dhe shlyp të plotë kombëtar që të shoshitëshin e mbasi të kulloheshin të hidheshin në gjykim të meitimis pUBLIK gjith ato gjarëje me shumë rëndësi, gjith' ato ndryshime e trathëtira, gjith ato drama e lodra që janë lozur fatkeqësisht mbi kurrizin e popullit. Pra mejtoj se ky shërbim i vogël i filluar që me kohë do të zërë mjast



një vënt të kënaqshm në zëmërat e fjeshta të pa ambici shqipëtare.

Fytyr'e ndryshuar e Historive që do të dallen para mejtimit publik shkakëtonet nga që përfundimet e vepërimevet e të shërbimevet patriotikë t'atyrej që muarrë shum'a pakë frën e këtij populli në dorë deri tash, kanë arrijtur 99 % në një gradë aqë të dohërt sa munt të thuash se s'ka mbetur as një njeri pa mos i trathëtuar o pa u bindur rrjedhimit, e kohëvet, të sundimevet të cilat i kanë leruar; tërë ato lera natyrrish kush e kush me metodet e vetë do të përpinqet t'i ndryshojë duk'e i u dhënë një fytyrë e cila t'i qirtë në shesh të bardhë; duk'e paraqitur ca dokumenta të rrëma me shpresë që populli, mejtimi publik t'i pandehë t'arrësyshme.

Por prandaj mbase nevoj'e madhe e mungimit të deri tashm të tregimit e pa anësi të rrjedhjevet në baza të vërteta, mëdha më të madhin guxim t'u paraqit më parë qakevet shqërrore e përparimtare këtë dritëzë të vogël e cila përfundërisht do të jetë miaft lehtë për realizimin e qëllimit kombëtar.

Për të qënë mbësim që të mos n'a përsëriten prapë, në kurrizin plot plagë vojtëjet, lodrat e tmeruara të shkakëtuara nga njëresh me inslyencë antiligjore, familjare, nga njëresh



agallarë, patriotër me sytyrë e me maskë atdhetarie me qellim të arrijnë ca më lart nga aristokratia e shdukur e të trashen si lubia duk' e grabitur, thethijtur gjakun e popullit, nga njerës të shtyjtur nga ambicia, vegël e verbër e të huajvet e të padijturi, gjith ashtu duhet që të jenë si një pasqyrë në popull, të dijtura, të mbasuara lodrat e tmershme të cilat shkakëtuanë, do të shkakëtojnë kurdoherë në rrastin e mos zgjimit e të mos kujdesimit të popullit humbëjen e përjetëshme të përparimit, të fatit e të mirësimit të popullit bujar.

Populli Shqipëtar katundar përmbi supe të sëcilit qëndron jeta shqipëtare i cili ka vuajtur duhet të shohë e të shijojë të mirat. Ay popull që ka derdhur gjak si lumë duhet të shohë shpërbimin e tij. Ay popull që ka dijtur të mburojë Atdynë me armë, duhet të menjohet prapë ay vetë t' a shpëtojë dhe me politikë e me fuqi pënde duk' e mos shikuar hatër e duk' e bazuar mbi të ndrejtë se jemi në mest të fqinjëvet lakëmuës e ujqër të cilët me politikën e dobët që janë duk' e vazduar përpigen me ç' do mënyrë të n' a çfarosën.

Frika e kujdesisë së popullit do të ndalojë guximin e kujdo njeriut që për interesë të vetë të mos mundë të lozë me organin

themelor duk' e e përdorur si mbas ëndës së vetë. Nga gjaku që derdhet për shpëtimin e Shqipërisë duhet të përsitojë Atdheu e kurse-si është bërë deri tash që kanë përsituuar një-rës të ndryshm ambicioza e të verbuem të cilët kanë mohuar edhe patriotizmën, Idealizmën dhe theorin' e samëshme të fisit bujar.

Shumë fatore të këtij kombi sot janë harruar! Sami, Neim Frashëri, Vaso Pasha dhe Ismail Qemali e të tierë të cilët qenë përpjekur që në kohë normale t' a ndanin Shqipërinë nga Sulltani i kuq e të bëhej më vete si gjithë shoqet. Ah! të qenë digjuar kshillimet e tyrej në popull; Shqipëria duaj që sot një mbretëri e fortë, e dijtur e e rrë-njosur, e njohur e e begatëshme deri më një shkallë sa t' ish e zonja, sa t' i bënte ballë rrezikut e ç' do ndryshim e të ç'do pushtimit që doj të gjante.

Shumë njerës të kupëtuar, duk' e mejtuar rreziket e fundit që i erdhë Shqipërisë, kishin përkrahur mejtimin e fatorevet, por idetë fanatikë në interes Greko-Turke nukë lanë t' a çmojnë e t' a pratikojnë dhe t' a realizojnë mejtimin e shënjtë të tyrej dhe mënë sunt i quajtin si të shitur.

Me gjithë që profiti i lirisë Arbërore Ismail Qemali pati satin deri sa t' i arrjet



qëllimit për të cilën ish munduar shumë por dhe ay nukë u përkrah prej popullit deri në ditë të fundit dhe ashtu program i tij i vërtetë i cili kish me e s.guruar japinë kombëtarë që nga themeli deri te kulmi mbeti pothua në fillim.

Shqipëtari la fatorin e thinjër dhe u bashkua me Esatin, me Zografon e të tierë beilerë e agallarë të cilët nukë kishin tiatër qellim për veç — që të humbasën diellin e të duken yjtë — që të thëthijnë si shushënje gjakun e popullit të shtyjtur nga të huajtë deri sa shkakëtuanë fatkeqësit' e mbëdha në popull duk' e u pushtuar Shqipëria.

Nga situata me shumë rând si që trashëgon Shqipëria, u lirua prapë prej armiqvet dhe u krijua në një shkallë sa të ketë dhe Parlamentin e saj.

Por kundreshtarët e Qemalit, antarët e Qeverrisë së Durrësit, me disa të tierë të dalur më vonë në fushën politike, nga ndryshimet e kohëravet, të ndihmuar nga armiqtë, me fuqi familjare e ambicioze, me qëllim që të bëhen ata diell, kundreshtojnë njeri jatrin më një shkallë sa të shkakëtojnë prapë humbëjen e Shqipërisë bujare.

Populli ruajtës i fatit të vetë nukë u bashkua duk' e lënë më nj' anë këta njerës,



këto parti me ndienja të huaja dhe të marrën në dorë fatin e Atdheut duk' e emnuar përsaqësonjës nga gjiri i vetë i qarkut të fëmijës por u përçanë, u gënjen duk' e u ndihmuar ambicivet e tyrej të cilët janë krejt injorantë, të xheshur nga ndienjat fisnike, zakonet, nevojat e Shqipëtarit.

Shqipëria e sotme e ngulur mbi themele të forta të gjakut e mijëra dëshmorëvet sot është lënë në ditë të pikës politikisht ashtu ca më shumë ekonomikërisht ku përkëtë të fundit as që nukë janë marrë masa as dhe që nukë ka t'atillë mejtim; fajt' e mbëdha gati si gjithë monë vazhdojnë grindëjet imperialistike në një padrejtësi të çuditëshme në dëm të të pa fuqishmit. Situat' e tyrej munt të shkakëtojë një tiatër lustë botore. Fqinjët t' anë përpigen me ç' do mënyrë të n' a sjellën prapë katastrofe me qëllim të bëjnë shesh luste prapë vëndin t' onë bujar duk' e përsituar nga përçarëjet e popullit të therën shqipëtarë si kanë zakonë.

Populli Shqipëtar i cili nukë është më ay i 1914-ës, duhet të marrë srën' e mbretërisë së zhgabës në dorë duk' e ndrejtuar enteresin kombëtar, duk' e formuar Shoqërima e të bashkohen që të prapsën ret' e zeza që duken mbi Orizonin e Shqipërisë.



Parti thashë, po jo si partitë politike që janë formuar deri tash në Shqipëri të cilat në vënt q' ato t' i apën më të madhen fuqi Qeverisë e re, ata kanë guxuar të ndajnë ndaj tyrej fuqinë e Organit zyrtar dhe nënë atë miskë Qeverrimi kanë përdorur, përgojur dhe praktikuar çuditë më të mbëdha në dobinë personale e në dem t' atdheut.

Përfundim i këtyrej vepravet ka sjellur një dëm aqë të math sa për veç që nukë është bërë as një lloji përparimi ca më tepër në ekonomi e cila është armiku ma i math por në rënt që të ecëjnë përpara punërat kanë ikur dhe ca akoma nga ç' qenë më të prapë,

Bota Shqipëtare e cila ka vuajtur shumë, tash ka nevojë dhe kërkon sigurimin e rrojtëjes e të begatisë nënë një organ të fortë, popullor e të vërtetë i cili të jetë miaft i zoti të quajë të mirin nga i ligu, të dënojë, të shdukë të ligun e të lërë të lir, lirinë njërrëzore, njërrëzit e mirë që dinë të përpigjen me shumë sakrifika që t' i sjellë lulëzimin e mirësin e duhur jetës shoqërore e përparrimitare.

Për të ndaluar sëmundjen e keqe shtetnore — një shtet si yni që ësht' i lindur tash në kohëru të fnndit — ka nevojë për Doktorra të mbaruar si më ç' do pikëpamje, si me

dijturi, me mshirë dhe me kurajo; Doktorrë të cilët duhet të dalën nga diçiplina e vërtetë e popullit, të fisit shqipëter pa mos shikuar ndryshim feje. Pra thérres Idealistet, popullin e vërtetë shqipëtar që i dhëmpset për Atdhen' e dashur i cili pasi të formoj idenë e plotë duhet të bëjnë detyrën e tyre si e lyp nevoja duk' e forcuar demokracinë për që të sigurojnjë Shpëtimin e Shqipërisë së dashur.

Munt të them edhe se pjes' parë e kësaj Historië përbëhesh prej ma se 600 faqesh në të cilën tregohesh gjat e gjerë mejtimi i im mbi çdo lloji ngjarje në Shqipëri si dhe shumë dokumente të mbëshefëta të kohevët, të sundimevet e kaluara të lozura prej armiq-vet në dëm të popullit Shqipëtar. Tue mej-tuar pozitën në të cilën gjendet sot Shqipëria, i riservova tue pritur një kohë ma favorabl në të cilën shteti i ynë të ketë cakë-tuar formën, të ketë sigruar politikën e brëndëshme e të jashtëme e deri sa demokracia shqipëtarë të jetë e forcuar në një shkallë sa të presë e të prapsë hovin e lakëmisë të personavet për front, të fronit e naltë të Shqipërisë që mbas pozitës ka një randësi të veçantë sa nukë i ka dhënë rrast as kujt, t' a trashëgojnë dot personaliht në një kohë



të gjatë me gjithë që ka qenë nevojë për një diktatori të ligjëshme e të përkohëshme:

Pra, në pjesën e dyjtë të Historisë, kur të shfaqë dëshirë demokracia do të shkruaj gjat' e gjerë gjithë sa kam riservuar, tue ndriçuar mejtimin publik mbi sa i përkel Historisë së kombit për të cilat jam munduar shumë me çdo mënyrë për t' i kupëtuar e për t' i hëdhë në dorë.

Pra tash për tash, ashtë miaftë të themi muarm shënim tue radhitur ngjarjet e kaluara në Shqipëri, vojtëjetë e theroritë të popullit për të cilat ka bërë sakrifika, e sakrificat e tyrej të shumta prenë hovin e tradhë-tbrëvet deri sa siguruancë formimin e njëj Qeverrië kombëtare me qëndër Tiranën.

Viti 1920

S. НАЬКОКОНДИ



Situata e Shqipërisë në Ballkan.

Kur njërzit kryelartë të cilët kanë kuptuar mirë situatën dhe rëndësinë e kujdovëndi, dinë të çmojnë shumë mirë rëndëinë më të çquar e më të plotë gjeografike dhe etnike që ka patur Shqipëria në Sinsin' e Ballkanit që nga kohërat më të vjetëra.

Historia e vërtetë dhë e asnjë anëshme, na dëfton se Atdheu ynë i dashur Shqipëria, më të vërtetë ka qënë çerdhia e sinisis së Ballkanit, ka qënë më e para e më fisnike e trashëguar nga Pellazgët duke marrë emrin Shqipëri.

Përveç pozitësë me aqë rëndësi që ka patur Shqipëria në botë por dhë populli i saj, populli shqipëtar ka patur aqë një bujë e një trimëri sa përveç fqinjëvet tanë por dhë e tërë bota akoma kur ndiente emrin e tij bujar, për së largu i dridhej mishtë, i morrej goja dhe kurdoherë që bëhej ndër-



hyrje me aqë lehtësi në të drejtat kombëtare të popujvet e tjerë; në Shqipëri ishte përkundrazi me që s' qasej dot kurrë një komp fqinjë o i mërguar, i math o i vogël që t' a shkelte këtë popull trim, fisnik, besnik dhe luftëtar kombëtar. Shqipëtari, me këtë bashkim të çuditëshmë, me këtë ndienjë të lartë e të shënjtë patriotike që kish patur për prënsip dhe që kish trashëguar nga pellazgët, nga Pirua (më i madhi armik i Greqisë), dhe nga Leka i math akoma; kish mundur t' a ruante më therori Mëmëdhenë e tij të dashur si dhe zakonin, karakterin dhe të ndrejtat kombëtare të cilat n'ato kohëra fortë të trubulluara nukë kish mundur dot kurkush t' ia prishtë e t' ia çkatërronte.

Mirë po s' ka dyshim se vikundër është parë dhe në gjithë botë koha është fuqi prishëse por dhe nga një herë fnqi ndreqëse, fuqi që prish e rrëzon por dhe godit, ndreq e lulëzon si mbas konditavet jetënore të c' do kombi.

Në Shqipëti, koha 4-5 shekullore përfat të keq, gjeti konditat jetnor të kembësisë t' onë për prishje se sa të vinte një themel gjallnor:

• Këjo fatkeqësi, zuri të fillojë tregimin e

saj në Shqipëri që nga pushtimi i Turqisë e t' hu i cili i kushtoi aqë shtrënjtë Shqipëris sa e demoralizoi kreit. Pushtim i Turqisë, i humbi natyrën, i shoi ndienjat fisnike dhe i solli një përçarje, një karakter prishije sa s' bahet më. Ky pushtim e la një grup të çarë e për t'u parë midis botës dhe bashkë kombëtarëvet e tij ku u çfaqnë fé të ndryshme, fea myslimanë. Shqipëtar i parë mithologjikë, nukë qenë miaft fetë katolike e ortodokes të cilat dhe ato në kohëra të fundit do t'i sillin ngatërrime, përçarëje të veçantë duke iku katolikët me qeverrië e perëndimit dhë orthodhoksët me atë të lindijes por u çpall dhe një e tretë fë e cila e ndau fuqinë dhe bashkimin e çuditëshm të shqipëtarit më trish.

Mbret i Shqipërisë, i famëshmi Skënder bej, duke qënë i ditur në tërë këto humbije, qëndroi si burrë, si trim i vërtetë sa i bëri ballë tërë atij sulmi, atij rremeti Turk të cilit nuk i pat bërë dot ballë as fqinjët t'anë të Ballkanit por të tërë i kish pushtuar sa që u bë zot i gjithë Siniшинë e Ballkanit.

Sado që sulmit Turk i bëri ballë në 27 luftëra por fatkeqësisht më pastaj më 17



Nëntor 1467, Vdiq i brengosur duke lënsë bijt e tij nënë thundër të barbarit dhe ashtu Atdheu ynë i dashur ra në gëthetëra të barbarëvet e Asis të cilët e çkatërruan kreit, e dërrëmuant dhe e humnë për jetë.

Shqipëtari, u duk më i bindur, nuë i lidhur në fën e rë, fenë më moderne mbasi moderata i përlqen sa me një herë shumica e tyrej e pranoi por mbasandaj eci duke humbur gjithë mejtimin, duke futur nënjetë haus të thellë e të pa shkallë dhë pa mos shikuar farej se ku vete e se ku del por vuri për bas enteresin e kohës e të vehtes së tij.

Po t'a thellojmë këtë psikologji, mundet të themi se Myslimasizma e përkrah Shqipëtarin njgjer më një pikë sa të mbetet i fortë në zakonet e veta të lumptura.

Mbasi Myslimani hodhi trupin e vetë në lumin Asian dhe përpinqet me gjith fuqinë e vet për t'a siguruar e shpëtuar me më të mbëdhuratë thrrori, nga ana tjatër bashkë kombasit të krishterë, Katolikë e Ortodokssë gjethnë rrastin më të mirë për t'i bërë ballë Shqipëtarit e transformuar duke përkrahur dhe ata më elementë dhë fuqira kundra Turqizmës.

Myslimanët Shqipëtarë duke verbuar nga

lavdia dhe enteresa e kohës që ju tregonte Turqia duke ju dhënë emërin Turk harruanë, ndërin e mëmëssë tyrëj dhe punonin për ndërin e Turqisë.

Kleri Grek, duke përzier fenë me kombësi gjeti dhe ai një rrast më të bukur se nga Turqia për të pagëzuar pëssëduyti herë Shqipëtarët Orthodhoksë duke ju dhënë emërin Grek se kështu ka thënë Z. Krisht që Ortodoksi është Grek; buizi prapaganda Greke me anë të qishavet e të shkollavet.

Turqia e sëmurë dhe e shtërguar nga politika e kohëravet lë të lirë hapien e shkollave Greke në Shqipëri dhe për të siguruai Myslimanët Shqipëtat që t'i heqë për freri nga të detë vëtë mbylli shkollat Shqip. Të dy mënyrat e lart tregueme shkakëtuanë ftohësi, mërgim dhe armiqësi midis të dy besimevet.

Mbasi Turqia dhe Gërqia, armiqte më të rrepët i lidhë shumë mirë shqipëtarët me Zinxhirët e trashë të fevet, ata për të fituar influencë në këtë gjëndje gatitnin pas endës dhe pas kohës prapagandat më të rrepeta sa e prunë më një shkallë të mjerin shqiptar që njëri t'a quante veten Turk dhe tjatëri Grek; vriteshin vëlla me vëlla dhe nga gjaku i tyrej i derdhur si



lumë herë fitonte njeri nga armiq e herë tjatëri.

Kështu pra situata e Shqipëris polli gjendien kritike dhe fqinjët t' anë gjetnë, gjëjnë më të mirë sheshin e operazionit mbi dëmin, mbi kurrizin e popullit Shqipëtar. Fqinjët e Shqipëris duke shpetuar dhe ata nga xjedha Turke e cila dhe ata si nevë ikishte pushtuar dhe duke shkundur nga ajo robëri e gjatë zunë t'i zgurdhullojnë sytë më të djatht e më të mengjér përtë copëtuar vëndé nga të Shqipëris duke u bazuar më disa tema të kalbura; mbi ca troje të rëna duke u bazuar në një të ndrejtë pushtimi qe kishin më parë Sërbët në Shqipërin veriore në kohërat e Dinastiës e Dushanit dhe në Shqipërinë e jugës Grekërit me Illusjone dhe fantazira duke pjesuar e përmënduar kur se Greqia në të famëshmen historin e saj nuk'e kish pushtuar kurrë Shqipërinë e jugës.

Çarja e rracës shqipëtare nga pikëpamia fetare, ju hapi udhënë e gjërë fqinjëvet e përmëndur, armiqvet e rreptë të këtij populli për të lozur rrolet e tyrej dinake si mbas enteresit për të hapur gjithë intrigat në gjëndien e sëmurë e të demoralizuar të Shqipëris.



Përpiekëjet materiale midis të dy besimevet të, gaditura, të kumbisura e të organizuara nga organizma e të dy prapagandavet fetare e armike të cilat vazhdonin pa reshtur e pa pushuar, me të vërtet çtuanë një grindje, mbuall një farë të hidhur e një armiqësi midis të dy elementevet sa që do të dojë kohë të çrrënjoset e të çduket nga që armiqjtë e të katër pëqive duke dijtur rëndësinë dhe pozitën që ka Shqipëria në Ballkan i shtërngonin akoma zinxhirët e prapagandavet fetare. Populli shqipëtar i pa mësuar që të kupët joë këto rrole që lozën për t'á shtyrë në trap, i pa stërvitur mirë dhe si mbas situatës politike e interesës midis Austrisë e Italis për sa shikonte çështja e jonë nga e cila populli shqipëtar nuk pati kurrë një fitim o një kumbizmë politike o një shpëtim; që i shtrënguar të bëhet therar i të dy prapagandavet e famëshme deri në mbarim të njëi kohe të pa caktueme duke derdhur gjakun e shënjtë për fitimin e armiqëvet të kombit e jo kurrë për fitimin e kombit të vët.

Shqipëtarëv e të dy elementëvet, përvèç që u bën theror për kondër enterezit të vëtë, për të shpëtuar nga rrëziket kufit e



të huajvet për të cilat përpinqeshin me gjith shpirt por dhe me sakrificë mejtimesh e dhurim të hollash si Zhapa e Averfio e të tjërë të cilët fatkëqësisht janë munduar, janë tretur kot duke goditur armë të pështë që 'të mundnin t'a varrosnin sa më parë mëmën e tyrej dhe bijt' e saj.

Fqinjët t' anë si thamë, dhe ata si nevej të shkelur nga fuqia e imparatorisë Turke, duke pasur kumbizmën dhe ndihmën politike, morale e materiale, mundë shumë çpejt nga nevej të xjuhen, të bashkohen, dhe të dërrmojnë fuqinë e saj. Kështu muar indipendencën e tyrej njëri pas tjetërit, por Shqipëria e ndar më tre besime, e bindur në propagandat fetare nukë guxoi më të përpinqet të shpëtojë por mbeti deri 1912 afro 435 vjet robëri e cila ja çkatërrroi kreit ndienjat dhe fuqinë morale të saj.

Berlin
Më 1877 kur Bismarku në Versaj bisedonte mbi luftën Turko-Ruse për sa i përkiste Ballkanit atë kohë sado që u përpojnë shumë shqipëtarë si Abdul Frashëri e të tjërë por u vanë kot mundimet duke mos mundur të kenë bashkimin midis besimevet si dhe nga të mos pasnjrit kumbizmë polilike.

Pas liris Turke kur Shqipëtarët kuptuan ca më mirë dhe u erdhi në mënt — duhet

punuar për kombësi për gjallërimin e kombit për të mos humbur një ditë të ndrejtat e tyrej kompëtare — duke filluarë nga kryengritiet më ç' do anë.

Çpallia e kryengritievet në ç' do anë të Shqipëris kundër tiranis Turke shkakëtoi ca më shumë xgimin e përgjithëshm, bashkimin e rrepët të shqipëtarit dhe njo-hijen e tij si kombëtar në qarket dhiplomatike t' Evropës. Këto krye ngrijtie që bënte shqipëtari duke derdhur gjak për të marrë lirinë e kombit e vet perkraheshin me anë të shtypit dhe nga ana e fqinjëvet t'anë të cilët dëshëronin të shpëtonte Shqipëria nga sundimi Turk e të krijohet më vetë por pa mos lerë mirë e pa mos marrë të mëkëpsët mirë, t' i prisnin kokën e t'a copëtonin në midis tyrej duke punuar ketij populli dramat më të mbëdha, fundi i fjalës ato të këqia që dëri më sot nuk' i ka punuar jo Turku po as një komp tjetër në faqe të dheut.

Si tham, katër vjet më radhë vazhduanë kryengrijtëje në Shqipëri kû protestonin rrëptësisht më, çdo anë të botës duke kérkuar të ndrejtat kombëtare dhe njohëjën e indipendencës kombetare, duke kérkuar



nga fuqitë e mbëdha kumbizmën politike e ndihmën e duhur.

Buçimi i puçkës e i dyfekut në Shqipëri u është botës të kupëtojnë dhe vëçanërisht fqinjëvet lakëmuës t'anë në zvillimin e çuditëshmër të Shqipëtarit. Fqinjët armikë, duke parë këtë zhvillim të fortë, këtë përparim të rrepët, zunë të vështrojnë së largu me habi, zunë të bisedojnë mbëshehtazi duke përgjuar bashkarisht si macia minë dhe ata për të hedhur në dorë Shqipërinë gjëndenë duke marrë masëra të rrepëta. Duke qënë e pa mundur lidhia e tyrej u rruffuanë një copëhere dhe me të çpejtë shkuancë te Edëvarg Grey i cili ju fërmoi bashkimin.

Prandaj, munt të themi çiltazi se përfundimi i marrë veshjevet midis tyrej përlakëmitë e zakonëshme shkakëtoi bashkimin e tyrej përluftë të Ballkanit. Lufta e Ballkanit munt të themi sigurisht u shkakëtua nga idealet e fqinjëvet t'anë ushqyer prej shumë kohë përrrealizimin e grabitëjes e cila e katandisi dhe Shqipërinë sa me zitë ftihosë vetëm mbajtejen e një grusht vëndi.

Lufta dhe xgjim' i fundit kombëtar që u dëftua përpëra botës do e mos do hodhi

një frikë të madhe në zëmërat barbare të fqinjëvet e pangopur t'anët dhe mbasi shpejtëimi i luftës Ballkane me aqë një nxitim të çuditëshmë i barroset pa dyshim zhvillimit kombëtar t'onit.

Lëvizia e shqipëtarëvet në kohë të fundit si në Toskëri ashtu ca më mirë në Gegëri por ca më shumë bocitëja e armëvet të Shqipëtarëvet e Kosovës të cilët kurdoherë duallë mundës, i dha një bujë të madhe kombit shqipëtar në tërë anë t'Evropës.

Luftimi i rrepët në grykën e Kaçamikut të cilën nukë mundi dot Turqia e madhe t'à mirr nga duart e shqipëtarvet përfundoi sigurimin moral të indipendencës e të njohëjes e Shqipëris.

Lufta e Balcanit

Mbasi Imparaetoria Turke u munt shumë herë nga Shqipëtarët në shumë kryengrijtje të famëshme të cilavet nuk mundi as pak t'u bënte ballë, u dëshpërua kreit. Politika e saj Imperialistike e ndaloj së gjykuari çashtijen e Shqipërisë me gjak të ftohët duke ju siguruar të ndrejtat kombëtare, si mbas propozimit që i u bëri Qamil Pashai, veziri math i Turqisë të bënin



lidhje e miqësi më Shqipëtarët. Zhon Turqërit e pa besë muarrë hekurat në për këmbë duke mos bedhuar as pakë në marrëveshje e në lidhje miqësore me kombin e fortë bujar të cilin jo vetëm për interesë të Shqipërisë po ca më shumë për mirësimin e vehtës së tyrej. Mos njohija e të ndrejtave kombëtarë të Shqipëris prej tyrej për veç që i solli dëm të math Atdheut t'oni të dashnr ca më shumë shkaktoi humbien e saj politike e materiale në Ballkan. Mos dëgjimi i proponimit të Qamil Pashait për sa shikon enderesa ndër-kombëtarë e jonë rrotull cakëtimit e kufivet Etyike të Shqipëris për veç që pasi thamë më lart shkakëtoi shdukejen e tyrej nga Ballkani por shkaketoj edhe lidhjen e të 4 fuqive Ballkanas të cilët mbas politikëslakëmonjëse të tyrej e dërrëmuancë kreit Shqipërin.

Shtetet' e Ballkanit duke përfituar nga mos përdorimi i politikës së vërtetë në Ballkan por ca më shumë në Shqipëri nga Imparatoria Turke e cila me politikën e saj që vazhdonte shihte varrin e saj me syt' e vat dhe në vënt që t'a mirësonte ç'ështjen rëmihte e thellonte më shumë varrin e saj duke mos dashur të qasen Zhon Tyrqërit në lidhëjen, në marrëveshijen miqësore, në

në njohëjen e të drejtave kombëtare dhe të gjuhës; i mbëlodhi më një fjalë shtetë e Ballkanit duke vrapuar me të çpejtë të çpallën luftënë e Ballkanit për kondra Turqis. Bashkimi i Serbisë, Greqisë, Bulgarisë, dhe Malitë e Zi që fjeshtë për të mbushur qellimet, dëshirat e shumë vjetëvet që ushqenin për Shqipërin e famëshme. e të begatëshme, Etnike dhe gjuridike.

Të katër shtetë përmëndura duke pasur më të madhen frik se këjo lëvizëjë Shqipëtare një ditë do t'i arrij qëllimit e shënjtë duke përbëledhur të katër vilajëtet kryesore të Shqipëris uënë një syndim Qeverimi të famëshmë Shqipëtar ku dotë shkakëtonte humbëjen e interesavet lakëmonjëse që ushqenin me kohë për kondër Atdheut t'oni të dashur; shpejtuani dorë për dorë duke i dhënë një notë Turqisë me anë të së cilës i kërkuan disa njohije rrotull interesavet e famëshmë të tyrojnë Ballkan.

Zhonët e Turqis të gabuar si kurdoherë në vazhdimin e politikës së tyrej në Ballkan, me qënë se kërkimet e lehta të shtetëtevet e përmëndur nukë i pranuan, që atë ditë, më 30 të vjeshtës e parrë 1912 filluan të gjith në përgatitëjen e ushtëris.



Më 3-5 të vjashtës u fillua lufta midis shtetevet të Ballkanit dhe Turqis.

Organizma e fortë e shtetevet lakëmusë të Ballkanit të xgjuar e të gatitur prej shumë vjetësh arrijjtur në shkallë të zotësis duke përpjekur pët një qëllim, me një shpejtësi të pa treguar mbëledhën ushtarët e vet dhe më udhë të hekurt i shpunë nëpër kufirat ku duaj fillonte lufta.

Turqia e lodhur nga luftërat e brëndëshme, e çkatëruar më të gjithë anët, pa farë udhë hekuri dhe me shkak që vendet i kish fort të gjëra e të larga, nuk mundi dot me të çpejt të mbëlith ushtarët, ti shpij në kufi e të forconte fortesat më kohë që të mos rynin dot brënda kufirit duke iu bërë ballë sulmëvet e tyrej të rrepta. Nga ky shkak ushtëritë Ballkanase rynë në kufitë e saj pa luftë. Kur arriti ushteria Turke e pa mobilizuar nukë mundi të mbahej dot gjikundi dhe kështu të katër mbretëritë më 25 ditë luftë i rynë më të gjithë anët ashtu dhe të mjerës Shqipëri.

Shqipëria, e pa arrijtur mirë në shkallë të kuptimit • të bashkimit kombëtar, e pa bashkuar mirë në shpirtërat elementevet fetare dhe duke qënë e lodhur, e këputur



nga luftërat e nga kryengrijtejet e të katër vjetëvet, sado q' u përpoq për vehte të saj s'mundi të qëndrojë e tu bëjë ballë sulmevet e rrëpëta t'armiqevet. Kështu fatkeqësisht u shkel më e madhija pjes e Shqipëris prej ushtëris Sérbe, Malezesve dhe Grekërvet për veç Shkodërs, Ianinës, Vlorës, Gjirokastërës, dhe Durrësit të cilat nuk janë shkelur aokma.

Ushtarët Sérbër të cilët pushtuan Kosovën bujare, Lumën, Dibërnë, Tiranën, dhe më pastaj Leshin, Krujë, Durrësin si dhe të tjera vënde të famëshme të Shqipëris ku vranë më tepër se 25-30 mijë Shqipëtarë burra, gra dhe të vegjëj.

Shqipëtarët e jashtësmë nga Amerika, Misiri dhe Italia • tejë të déshpëruar fort nga shkelia e Atdheut së tyrejë nga ushtëritë e fqinjevet armikë t'anet protestuan rrepësisht sa kaqë herë shtetet e mbëdha të Evropës.

Atë herë Austria, Italia dhe Gjermania bashkërisht ngritën një zë të lartë duke kërkuar shpetimin e Shqipërisë. Ky zë i shkëlquer i fuqivët e mbëdhe mikeshat e Shqipëris sado që i drithmoi miaft qarket dhipllomatike t'Evropës por kush'i digjon n'ate kohë kur me të çpejt Shqipëria. u



pushtua, u doq dhe u shkretua më të gjith anët. Shpëtimi i Shqipëris në këtë kohë bazohet mbi nevojën e një bashkimi të plotë dhe kështu në mos ishim të zotë t'a nubanim më luftë e me kundreshtim, të përpinqeshim makarai me një vepër, me një mënyrë politike e cila sidomdo dota shpëtojë atdhenë t'oni të dashur.

Atëherë, me gjithë përqarjen e popullit Shqipëtar midis elementeve fetare që vazhdonte rrepësisht, filluanë të lëvizën krejt Shqipëtarë por që e pa mundur me që vendet kryesore të Shqipëris ishin pushtuar, fuqit Ballkanase ishin gjérësuar tepër si nga an' e Shqipëris ashtu dhe nga an' e Maqidhonis ku ushtëria Bullgare e futi ushterinë Turke deri në Çatallxhe. Edrenea u rrethua, Seleniku, Manastiri, Shkypri ranë në duar të ushtëris Greke, Bullgare dhe Sérbe. Dinakëria e armiqvet t'anë, si mbas ëndës së tyrej duke njojur tokën Shqipëtare si një vënt Turqie duke çfaqur se janë duke përzënë ushterinë Turke, janë duke nxituar si qën të tërbuar mbi vizet Shqipëtare duke përdorur puçkën, topin dhe bajonetën me qëllim që të dalën deri në Vlorë që të mos mundë më



Shqipëtari të qirtë zënë e vëtë për të kërkuar të ndrejtat kombëtare.

Në këtë kohë kaqë të zezë, të nxirë e të rrezikëshme, nukë është duke dalur fare nonjë udhëheqës dhe të punonte bashkë me popull. Të gjithë e humnë fare menjtimin dhe kështu ca nga udhëheqësit duallë jashtë dhe ca të tjerë u bindë te armiqtë. Si mbas kësaj kohe, të quajturit udhëheqësit e kombit duke mos dashur të çajnë kokë për të shpëtuar nderin e vëndit dhe jetën e popullit si dhe moralin njërežor e kombëtar; rrinë në Stamboll, Greqi dhe Itali duke vështruar së largu.

Një zë i mbshehet por fort i shënjtë ndihet nga gjiri, kufari i Atdheut ku tingëllon në vesh të kujdo Shqipëtari duke ju porositur bashkimin e duke i thírrë në detyrrë të shënjtë të shërbimit por as një fare nukë po merr nisiativën për t' i bëre ballë rrezikut në mos me armë me krijimin e me çpallëjen e shënjavet kombëtare. Në këtë kohë Shqipëria me të vërtetë bonjake, pa një shënjë kombëtare, si një vënt i shkretë e i egër është duke shkelur, pushtuar e fikuç nga më të rrepetit armikër të cilët nukë duanë të lënë më të rrojë i gjallë asnje frymë Shqipëtari. Ndofta më



shumë vënde të Shqipërisë u bëhesh kundreshtim me armë armiqvet por ky kundreshtim i pa një formë kombëtarë u ipse ca më shumë guxim armiqvet të vazhdonin më me rreptësi në sulmet e tyrej që ishin duke bërë.

Në këtë kohë fort të rrezikut e Atdheut, i vetëmi shpëtimtar i kombit, i ndieri, i famëshmi Ismail Qemal Beu, bir i Mahmut Bej Vlorës, niset nga Kostantinopoja si ëngjell, si shënjtë dhe si profit me qëllim që të shpëtojë Atdhënë që gjendet në pikën e fundit të rrezikut.

Ismail Qemali në një kohë trazimtarë sa nukë e mori njeri fare prapa dolli nga Kostandinopoja me qëllim të shënjtë të shpëtimit e Atdheut posa Skënder Beu dha vate në Bukuresh ku bëri një mbëledhëje me të gjithë Shqipëtarët si Luiqi Gura-kuqi e të tjera të cilëvet u çfaqi qëllimin e tij të shënjtë. Nga Bukureshi, i shoqëruar me shumë Shqipëtarë duallë në Durrës ku më të dalë dha urdhër të ngrihet flamuri shënjtë kombëtar. Mbas mbëlodhi dhe parësinë e Qarkut të Durrësit dhe u thotë nevojën e çpallëjes të vëtëqeverrimit në një kohë kur ushteria Sérbe po i qasoj Durrësit, por fatkeqësisht nukë qe e



mundur t' i bindeshin kësaj shënje të gjallë shpëtimtare kombëtare. Mbasi koha nukë pranonte më se Serbia po qaset, Greqia po e shtrëngon Vlorënë me anë të detit e të Himarës si dhe anët e tjera të Jugës ku në Himarë e në Delvinë kish qirtur fuqi ushtëriake dhe po lëftonte rretësisht me Shqipëtarët, u shtëngua të lërë Durrësin dhe të vejë në Vlorë për të vënë qëllimin e shënjtë në vepërim. Mirë po me që Vlora ishte apollokuar nga Greqia e cila po bombardis Vlorën dhe qarket e saj, ish i shtërnguar të shkonte steresë.

Mbasi lajmeroi popullin e Vlorës që t' i bëjnë ballë arnikut deri sa të vijë ay, më parë se të niset dha lajmërimë në Qytatet e liruara duke ju lutur popullit të dërgojnë delegatët e tyre në Vlorë bashkë me letër përfaqësimet e vërtetuara dhe fort i dëshpëruar nga gjëndëja e Durrësit iku dhe arrijti në Vlorë në mëst të natës të 27-11-1912. Ndonse Qemali u prit me një fytyrë të ashpërt prej aristokratëvet si Toptanasit, Virionasit e të tjerë oxhakë të cilët dësheronin për një të atillë nisiativë e ca më shumë prej Thyria Beut i cili e kish marrë atë nisiativë ditë më parë më telegram nisiativë e cila nukë bëri as ma



të vogëlin efekt në popull dhe më në funt me gjithë që shtyjtim ushterinë Turke të vërë në zbatim urdhërin e Esat Janinës për t' a zënë Qemalë por nisiatori i pajo-sur me ndjenja të shënjta i bashkuar me popullin fisnik nukë e la udhën e mbarë.

Shpresa e kombësisë, bashkë me delegatët e qytetevet, u pritnë nga populli i Vlorës i cili dëshéronte t' i shërbente si kurdoherë idealit kombëtar. Vlora djep' i Shqipërisë dhe i idealismës kombëtarë dijti t' a çmojë shumë mirë dñe t' a presë me gëzim të plotë këtë nisiativë të shënjtë duke i pritë nisiatorët me flamur të shënjtë kombëtar duke ju shoqëruar e duke ju dhënë fuqinë e ndihmënë morale e materiale në zbatimin e qëllimit të shënjtë të nisiatorit e të delegatvet shqipëtarë.

Çpallij e vetë Qeverrimit Kombëtar

Shpresa e Kombasisë Ismail Qëmali, më 47 Delegatë t' ardhur nga vizet e tjera Shqipëtare, për të veuë në veprin qëllimin e shënjtë kombëtar, me nxitim u mbëlodhë më 15 allaturka, më 28 allfranga të vjeshtës III 1912/1328 ditën e bardhë të Mërkurënë ora më $11 \frac{1}{2}$ allaturka, më $5 \frac{1}{2}$ pas-



dreke allafrënga ku u çpall *vete Qëverrimi* Shqipëtar duke vartur flamur' i shënjtë i cili kish 445 vjet në robëri i shkelur prej armikut barbar. Çpallie e *vetë qeverimit*, varja e flamurit të shënjtë si dhe formimi i qeverris kombëtarë qënë shpresat më të sinjgjerta e më të shënjtë për shpëtimin e Shqipërisë. Një shumicë e madhe prej popullit fisnik Shipëtar u betua përpa flamurit e shënjtë deke thënë me zë të lartë (të qofshim falë o shënja e bukur, nevej bijt e Pellazgevet do të të mburojmë duke çpërkatur faqen e dheut me gjak që të të mbamë kryelartë për jetë).

I tërë populli mbushur plot gëzim dhe kënaqësi duallë jashtë duke festuarë e duke bërritur (rroftë Shqipëria më vete, rroftë flamuri i shënjtë, rroftë trijnëria dhe bashkimi).

Këtë ditë të shënjtë, shpëtimtarë, të bekuar, të lavduruar dhe të shënjtë e priti populli me gëzim dhe kur të shoç për një herë u varë flamurët kombëtarë më ç' do anë të qytetit si dhe natyrisht më tërë zyrat e Qeverris. Të mbëdhij e të vegjël, burra dhe gra ftyrë çkëlqyer formojnë bashkimin e shënjtë duke lavduruar arrijtëjen e kësaj dite, të cilën e kish dëshë-



ruar dhe kish sakrifikuar për të e cila shkakëtoi dërrëmuarjen e zinxhirevet të fortë të tiranis Turke që i kish penguar ma se 4 shekujë më parë.

U ngre flamuri i shënjtë kombëtar shënja, e kombit fisnik i cili kish mbetur në zë po thua që kur se vdiq Skënderbeu më 17 Nëntor 1467. Natyra e skëtërrme e Shqipërisë u ndërrua e u zbukurua. Malet bujarë dhe fushat pjellore të Kosovës, të Myzeqesë dhe të Janinës lëshuanë lule të bukura. Mirë po fatkeqësisht në një kohë miaft të rrezikëshme kur armiqtë janë futur në Shqipërinë bujare. S' ishin më ata burra triu, ata ushtarë të Skënderbeut që kishin çuditur botën me trimërin' e qëndrimin e tyrej; s' ishin më ata burra që digjeshin në kulla të barutit përtë mos rënë në duar të Shqehet përsë gjalli. S' kishte më as një Ali Pashë që të i shtinte drithmën Moresë, as një Kara Mammut o Hodo Bej që t' i hynte Çetinës.

Veçmë për mrekulli, atëcas kur duken punët më të rrëzikëshme për Shqipërinë çohet or' e saj për t'a shpëtuar.

Në një kohë kur zëmërat e çdo atdhetari ishin heshtuar e pushuar prij cipës e robënisë e të rrëzikut në një mënyrë që nuk



t' ipse më shpresë për të, në një kohë kur cipa e skllavërisë ishte tue shtrirë tmerisht mbi kry të kombit shqipëtar arrijti dit' or'e shpëtimit.

Në një kohë kur pandehej se ishte mbaruar Shqipëria, se ishte shuar Shqipëtaria, e s' kishte mbetur më zëmër, s' kishte mbetur më shpirt, ishte fikur kreit shpresa; po shpërndahet një shkëndi shpresa në zëmërat e shqipëtarëvet, një rë e lumtur e bardhë vjen duk' e çarë ato të shkreta rë mizore e të zeza që kish mbuluar qie-llin t' onë e po shkëlqen brigjet e Adriatikut. Ay ish Ismail Qemali, Profit i lirisë arbërore që vjen i bashkuar me apostojt e vetë, kish pruë sihariqin e shpëtimit dhe sigurimin e vërtetë t' atdheut.

A thtua me të vërtet një grusht plak i thinjër, i fortë prej atdhetarisë i cili me gjithe ato mundime arrijti në mest të natës në Vlorë, i shtyjtur prej njij atdhetarie të ushqyër në gjithë jetën e tij me mundime të mbëdha, i forcuar dhe prej besimit të plotë të popullit që kishte mundur me e përfituar me sjellhjen e mëndies të pa shoqe për t' arthmin e Atdheut të dashur.

Ay plak i shënjtë që kish prurë në dorë shpëtimin e sigurimin e jetës së kombit



shqipëtar i cili më vonë u kundrështua prej atyrej që nukë besonin e se nukë u ish mbushur mëndia dhe nukë u ish ndriçuar zëmëra si duhet për mirësin' e lartë e të shënjtë. Por ay si shtyllë e hekurtë, si guximtar i gjithëmonëshm me një ide të lartë njerëzore ftoi gjithë Shqipërinë në besë t' atdheut, çau rrugë e duk' e mos gjetur shesh kombëtar të lirë në Durrë ku dësheronte me u ngulur arrijti në Vlorën kreshnike natën e 27 Nentor ku u prit me krahë hapët.

Kongresi kombëtar çoi nëpër duar të plakut të math flamurin kombëtar madhështor i cili që i përunjur prej robërisë, atë Zhgabë krye lartë që armiqtë nukë e kishin lënë të fluturonte lirisht në airin e qëruar t' Atdheut.

Dita 28 Vjeshtë e III heth poshtë zinë e robërisë së gjithë asaj perinde të gjatë duk' e i thënë botës së qytetëruar se ish vendosur të rrojë në liri o të vdesë mëndë.

Pas çpalljes e vetë qeverimit dhe ngrijtëjes e flamurit

Në castin e çpalljes, të formimit e qeverris Shqipëtare nënë mbrojtjen e tërë fu-



qive të Mbëdha; kryetar i qeverrisë provizore të Shqipërisë shkëlqesa e tij, shpëtimtar i kombësiës Shqipëtare Ismail Qemal Beu qirti zërin e shkëlqyer duke lajmëruar tërë visetë e liruar të Shqipërisë të cilët këtë çpallje të dobishme e prinë me gëzim dhe ngritin më çdo vënt flamurin e shënjtë; n' atë çast u dërgoi një notë tërë Shtetëvet e mbëdhij e të vegjij dhe ju bëri të njobue çpalljen, formimin e qeverris Shqipëtare e bazuar mbi dëshirat e shënja fjeshtë Shqipëtare të popullit fisnik që rron me më të shënjin ideal duke ju çtuar këto fjalë "jemi Shqipëtarë dhe e duamë Shqipërinë për vehte se Shqipëria është për Shqipëtarët. Për të rruar Shqipëria më vehte, populli Shqipëtar i bashkuar mërr ne së si ç'do sakrificë dhe therrori „.

Lajmërimi i kryetarit të qeverrisë që ju bëri gjithë visevetë Shqipëtare si dhe në Janinë e në Shkodër e tej, natyrisht për vëç vizevetë e pushtuara prej armiqvet që në këtë mënyrë " u formua dhe u çpall vetë qeverrimi i Shqipërisë, u ngrit flamuri dhe po valon shënja e jonë e lartë dhe e shënjtë kombëtare kundruall Adriatikut,



Shqipëria u bë më vehte dhe rruarëja e saj si shtet më vehte u sigurua „.

Idealistët Shqipëtarë të dëshruar dhe të përpjekur me kohë për këtë vepër të shenjtë patriotike e vunë me të çpejtë në veprim sa më parë e cila u dha të kupëtожnë ushtërisë e tërbuar armik që ishin duke sulur me një hovë të math se Shqipëria nukë është vënt i Turqisë dhe ka të ndrejt të rrojë më vehte për të cilën populli saj ka sakrifikuar dhe ka vendosur akoma të derdhë gjakun e shenjtë.

Fatkeqësisht as Janina as dhe shkodëra nukë mundë dot të shoqëroheshin duk' e marrë pjesë në këtë vepër patriotie me që atje ishte duk' e vazhduar lufta akoma me formë otomane. Me gjith që idealistet Shqipëtare u përpojnë që të themelonin e të çpallnin formën kombëtare në të dy qytet kryesore dhe Historik të Shqipëris por si Esati i Janinës komandan Turk me ndienja Greke ashtu dhe Ali Riza pashai i Shkodërs fjesht Turkoman kundreshtuanë. Vazhdimi i luftës si në Janinë dhe në Shkodër makari me formë otomanë i solli Shqipëris një të mirë e cila i ndaloi për një kohë të gjatë sulmet e armiqvet të lindëjes dhe të perëndim veriut. Në Gjiro-

kastër u bënë pakë fjalë se thoshnë disa që Shqipëria të jetë nënë sundimin e Turqis. Në Pagon me gjithë që shumica e popullit ishte e hidhruar me propagandë Greke dhe kundreshtuanë por më fuqinë e të ndierit atdhetar Vëhbi Pogonit u çpall dhe atje *vet qeverrimi* Shqipëtar tue i dhënë bësën dhe fjalën e nderit qeverris së re kombetare që do të bashkë punojnë duke derdhur dhe pikën e fundit të gjakut,

Për fundimi i bisëdimëvet të mbledhës kombëtare e cila formoi qeverrinë e përkohëshme, zgjodhi për krye Ministër dhe

- 1) M. punëravetë jashtësme Ismail Qemal benë,
- 2) Mehmet Pashë Kallkandeleni M. i luftës,
- 3) Poga M. i drejtësisë, Mëfyt⁴/Libohova M. P. të brëndëshme,⁵ Gurakuqi M. i arrësimit⁶ Abdi Toptani M. i financavet,⁷ Pandeli Çali M. i bujqësis,⁸ Mithat Frashëri M. i Punëravet botore dhe⁹ Lef Nosi M. i Postës.

Kyj kabinet mbron të drejtat kombëtare te Shqipëriës duke pritur për fundimin e luftës dhe të liruarit e vizevet Shqipëtare të pushtuar prej ushtësis e armiqëvet dhe duke ndërmjetësuar më ç' do mënyrë cakëtimin e kufivët Shqipëtare të cilat do t' i shënojë Konferenca Dhipllomatike Evropiane në Llondër.



Kyj kabinet do të përpinqet të mbajë qëtësinë e Shqipëris, t' i përgjigjet si ç' do punë politike të jashtësme dhe të brëndëshme si mbas nevojës e kokës deri sa të vijë L. M. e tij mbreti i Shqipëris i cili mbas si të xgjidhet nga an' e Rigatavet dhe të pëlqehetë plotësisht nga tërë populli shqipëtar; ka për të marrë në dorë frënë e Shqipërisë.

Mbëledhija kombëtare dhe mënyra e bisëdimit

Mbëledhija e parë e kuvënditë të përgjithëshmë, mbasi tham më lart u mbëloth më 28 të Vjeshtës së III 1912 i përbër prej Delegatëvet e të gjitha vizave Shqipëtare në qytetin e Vlorës ku u hap në orën 4 pasdreke në shtëpinë e Xhemil beut.

Nisiator i veprës së shënjtë kombëtare, shpëtimtar' i kombësis, shkëlqesa e tij Ismail Qemal beu, si nisiator i parë i mbëledhëjes mori fjalën duke ju treguar Delegatëvet qëllimin e kuvendit, d. m. th. që të përpiken së bashku të marrën masat e nevojshme për të shpëtuar Shqipërin e dashur nga rreziku i math q'është e shkelur dhe e qarkuar.



Si e kërkon rregulla e zakoni, filluanë më parë në kqyrëjen e vërtetimin të kartëratëvet e Delegatëvet të cilët janë këtë më poshtë.

Nga Berati Ilias Virioni, Haredin Cakrani, Xhelal Skrapari, Dudë Karbunara, Taq Tutulani dhe Sami Virioni..

Nga Dibëra Myfti Vebiu, Nga Durrësi Abas, Mustafa, Jaja, dhe Domo Nikolla, Kacecorri nga ana e Arqipeshkopit të Durresit për të gjithë Shqipetarët Katolikë.

Nga Elbasani Shefqet Daiu, Lefnozi, Qemal, dhe Midhat Frashëri.

Nga Gjirokastëra Azis, Veli, Elmas dhe nga Ipek Rexhep, Bedri, Sali Xhuka dhe Midhat Frashëri. Këta janë edhe Delegatët e Gjakovës, Plavës dhe të Gusinës.

Nga Kruja Abdi Toptani, Mustafa, Asimi dhe nga Lushnja Qemal; Ferit Vokopola e Nebi Sefa.

Nga Ohri e Struga Zyhdhi, Dr. Myrtëzai, Nuri Sojli dhe nga Shijaku Xhemal, Imer dhe Ibrahim, nga Tirana Abdi, Murat Toptani.

Nga Vlora Smail Qemali, Zihni, Arstidhi Qazim Kokosh, Jan minga dhe Eqrem Syrjai.

Nga Kolonia e Shqipëtarëvet të Bukureshtit Dhimitrë Zografi, Dhimitri Mborja, Dhimitër Berati dhe Dhimitër Llua.



Pas vërtetimit e kartëravet, Sali Xhuka mori fjalën duke thënë që Korça sot ndodhet e qarkuar nga ushtarët e armikut dhe nukë munt të dërgojë Delegat. Më qënë se atdhetarizëma e Korçës është e njohur e që ndodhen në mest t'oni Zotërinjtë Korçarë të njohur në shërbimet patriotike kërkijnë që të pëlqehen prej mbëledhëjes si përfaqësonjës të Korçës Pandaliçali, Thanas Floqi dhe Spiro Lloji. Mbëledhëja më plotësim të zëravet i pëlqyën dhe e poltisnë këtë vendim,

Mustafa Asimi kërkoji dhe për Shkodernë që ndodhet në shtërngim e në luftim më keq se Korça, të pëlqeshet si përfaqësonjës Luixhi Gurakuqi i çili ka qënë dhe në të tjera imbelëdheje kombëtare përfaqësonjës i asaj krahine e që është edhe një nga nisiatorët e kësaj mbëledhëje. Kuvëndi prapë më plotësim zërash e pëlqeu Luixhi Gurakuqin përfaqësonjës të Shkodërs.

Nga Përmeti erdhi telegram në të cilin thuhet se Delegat' i tij Veli Këlcyrë nukë ka arrijtur akoma në Vlorë, të zërë vendin e tij Syrëja Vlora e Midhat Frashëri. Erdhi një tjatër telegram nga Hamdi, Mustafa Barotçiu në të cilin thonë se po vijnë ghe ata si Delegatë të Ohritë e të Strugës.



Mori fjalën Rexhep Beu duke kërkuar të xhgijdhet si kryetar' i kuvëndit shkëlqesa e tij Ismail Qemali, si shkronjes i parë Luixhi Gurakuqi dhe si shkronjës'i dyjtë Shefqt Dain. Delegatët e pëlqyen këtë menjtim dhe i emëruanë duke përpjekur duartë. U hap pastaj fjala mbi dhënëjen e zëravet e të votavet dhe mbas shumë bisidimesh u vendos që çdo Prefekturë të ketë vetëm një zë pa vënë re nëmurit e Delegatëvet. Mustafa Asimi kërkoi që të tregohet mirë situata dhe gjëndëja e sotme e Shqipërisë përpara mendimit i' Evropës. Mori fjalën kryetari me një folëje të nxëhtë, të lidhur e t'arrësyshmë duke thënë : Shqipëtarët janë besnikër kurdoherë te mbretëria. Otomane por nukë e kanë harruar kurrë as gjuhën as kombësinë e tyrej e provat më të mira janë përpjekëjat e kryengrijtëjet që bënë kurdoherë e sidomos ca më mirë në këto të katër vjetë e fundit duke ruajtur e duke mbrojtur të ndrejtat kombëtare e zakonet e tyrej. Qeverria Otomane nukë e vështroj kurrë enteresën e tyrej e nuk deshi kurrë t'u a shpërblejë me të mirë Shqipëritëvet shërbimet e mbedha q'i bënë në kohërat e fundit. Qeverria Otomane nukë mori të gjitha masat e nevojshme për të



paqësuar e kënaqur Shqipëtatët duke qasur në marrëveshëje me kombin t'onë. Në këtë e sipër krici lufta me të katër mbretërit e Ballkanit të cilat kërkonin përmirësimë e të ndrejta për vëllezërit e tyrej një komp e një besë.

Më vonë e harruanë qellimin e parë. Pasi lufta u vajti mbarë, u muarrë vesh për coptimin e ndarëjen e mbretërisë e pra dhë të Shqipërisë. Shqipëtarët të cilët kishin marrë pjesë në luftë më fortë se si ushtarë, si të zotët e vendit për të shpëtuar vehten e tyrej. Kur e panë se ushteria e Turqisë u munt e mbretëria nuk munt të qëndronte vrapiuanë të marrën masat q'i kërkon koha. Me këtë qellim u nisa nga Stambolli e pas si që u muarçëvesh me Shqipëtarët e Bukureshit u nisa e vajta në Vjenë, u muarrë vesh me njëra tjatërnë qeverritë e mbëdhë që kanë interesë më shumë në punën e Ballkanit. Pas si që nukë mbetej më asnjë shpresë për të shpëtuar Shqipërinë më armë, e vetëmija udhë e shpëtimit ishte ndarëja e Shqipërisë nga Turqia. Këtë mendim e këtë qellim vura përpala syvet e cila u pranua më sympathi nga të gjithë Qeverritë e mbëdhë e si domos nga Austria e Italia. Vetëm Rusia munt të mbahet pakë



si e ftohët nga shkaku i Sllavëvet. Po edhe ajo nukë mohon Shqipërinë e kombin Shqipëtar. Për të mbaruar këtë qëllim ftova të gjithë Shqipëtarët në Vlorë e sot jam i gëzuar që thirrma nukë më vatë kot po nga të gjithë anët e Shqipëris u dërguanë Delegatë që të mendoheshin e të përkujdepsemi së bashku për Shqipërinë e për Atdynë, lypset të marrëm masat më të nevojshme për Shqipërinë, të bëhet Shqipëria më vehte nënë një qeverri të përkohëshme. Të xgjidhet një pleqësi për ndihmë e kontrollin të qeverrisë, të dërgohet një komision në Evropë për të mbrojtur çashtejen Shqipëtare përpara mbretërit të mbëdha.

Të gjithë Delegatët me një zë të plotë e të lartë e pëlqyenë fjalën e kryetarit dhe vendosnë që :

“ Shqipëria të bëhet
që sot më vehte, e
lirë e e mos varme, nënë
një qeverri të përkohëshme „.

Gjëndëja, këtë vëndim e priti me një padurim të plotë e me të përpjekura të pëllëmbëvet. Mbëledhëja u la për të nesërmën e Delegatët duallë jashtë — sikundër që



e thanë më përpara-bashkë me popull të përshëndetën Flamurin q'u ngrijt në orën $5\frac{1}{2}$ pasdreke Allafrënga. Kryetari qeverrisë së përkohëshme u xgjoth shpetimtar'i kom-bësis çkëlqesia e tij Ismail Qemal beu e Nënëkryetar Dom Nikolla Kacorri.

Mbëledhëja II më 30 vjeshtë. III 1912

Mbëledhëja u hap në orënë $3\frac{1}{2}$ pasdreke. Si Delegatë të rij, erdhë Mehmet Pashe Dhëralla, Isa Bullatini, Ajdin Draga, dhe Dërvish Ipek u nga Kosova. Si dhe Sami Virioni nga Berati, Dervish Elbasani dhe Mahmut Kaziu nga Peqini. Me telegram emërohet si delegat'i Përmetit Ismail Qemali si dhe nga grëmshi e nga Tomorrica. Si u këndua dhe u pëlqye prosoverbal i mbëledhejes së përparëshme, Gurakuqi kërkoi që të mos nënëshkruhet ditë për ditë po të lihen të gjitha për në funt. Në këtë mënyrë si delegatët e rij që erdhë si dhe ata që dotë vijnë përpara se të mbarohet kuvëndi dotë shënojë emërinë në këto shkresa të përkujtimshme, të gjithë Delegatët e pëlqyen dhe e pranuanë mejtimin e Gurakuqit.

Z. Azis kërkoi që zoti Mexhi të njihte si Delegat i Tepelenës dhe Lefnothi kërkoi

njohéjen e Z. Sherif si Delegat i Dibërs. Mbëledhëja i pëlqeu me plotësim zérash.

Z. Dervish pyeti Kryetarin e Qeverris së përkohëshme se sa do të jetë nëmur' i Ministrave? Kryetari tha se hë-për-hë munt të emërohenë vetëm këta: 1, Ministër i punëravet jashtësme, 2, M. P. Brëndëshmë, 3, M. i ushtërisë e i sigurimit botor, 4, M. i kurcimit, 5 M. i Drejtësisë, 6 M. i Arrësimit. U vendos që xgjedhëja e Ministrave të lihet në dorë të kryetarit e qeverrisë dhe kështu Ministria të mos mundë të rrëzohet deri sa të mos mbëlidhet nonjë kuvënt tjetër i përgjithëshmë për të themduar qeverrinë e re. Gurakuqi kërkoi të vihet në bisedim çashëtëja e xgjedhëjes së pleqësisë e Numuri i kshilltarëvet.

Mbi këtë gjë kryetari i qeverisë proponei që nëmur i pjestarëvet të pleqësisë të jetë prej 12 vetash, pastaj duke qënë se ay si kryetar i qeverisë së përkohëshmë nukë munt të mbetet dhe si kryetar i kuvendit; Kështu kërkoi të xgjidhet një tjetër si kryetar i kuvendit. Gurakuqi proponei për kryetar Myfti Vehbinë dhe Midhat Frashëri kërkoi që xhjedhëja e kryetarit dhe e nënë kryetarit të bëhet më zëra. Me plotësimin e zéravet u xgjodhënë



Myfti Vebiu si kryetar dhe Lofnothi si në-nëkryetar.

U hap fjala mbi nëmurin e pjestarëvet të pleqësis ku 'ca Delegatë thanë që të pëlqehet fjala e kryetarit për N. 12 dhe ca të tjerë thanë që kryetarët të jenë tetëmbëdhjetë dhe një pjesë e tretë e Delegatëvet thanë të mbeten si pleqësi të gjithë Delegatët.

U vendos që të vihet në votim nëmuri i pjestarëvet të pleqësis dhe ju dha urdheri shkronjësir të këndonjë ëmëret e Delegatëvet për votimin e hapët.

Shkronjësi Z. Gurakuqi vuri re që po votohet pas Delegatëvet e jo pas Kazavet, gjë e cila ashtë kondër vendimit të përparëshmë. Me gjithë atë nuk'u digjua dhe votimi vajti përpara. Për të gjithë votuanë 4 vëtë, për No. 18, votuanë 27 Delegatë, për No. 12, votuan 16 vëtë. Mbeti pra që nëmuri i pjestarëvet të jerë 18.

Kryetari kuvëndit tha që nesër mbële-dhëja të hapet në orën 1 pasdreke dhe Gurakuqi proponoi që radha e punëvet të jetë këjo: Formimi i Ministrisë, xgjedhëja e pleqësisë dhe e Delegatëvet për në Evropë.



Mbëledhëja e III. më 1-XII-912

Mbëledhëja u hap në orën 2 pasdrekë nënë kryesinë e Myfti Vebiut. Gurakuqi këndoi proseveralin e mbëledhëjes të përparëshme që u pëlqye, pastaj lutti Delegatët të flasën me radhë, pse ndryshë shkronjësit nukë munt të bëjnë detyrën e tyrej. Kërkoi dhe 2 shkronjës të tjerë për ndihmë ku u xgjodhë Mustafa Kruja dhe D. Berati.

Kryetar'i Qeverrisë mori fjalën mbi proseveralin e vuri re se votimi mbi nëmurin e pjasëtatëvet të pleqësisë u bë kundër rregullës me që ishte vendosur që zërat të hiqen për çdo kaza pa vënë re nëmurin e Delegatëvet. Midhat Frashëri tha se pasi votimi u ba pa ndonjë kundërshtim domethënë se u rrëzua vet vëtin vendim i përparëshmë. Gurakuqi u përgjeq se ay si Delegat u kundreshtua duke thënë se votimi u ba kundër rregullës. Kryetar'i Qeverrisë çtoi se pasi që nukë u pëlqye No. 12 për pjesëtarët e pleqësisë, munt të thuhet se lindi një kundreshtim në mest të Qeverrisë e të kuvëndit.

Shumë Delegatë muarrë fjalënë duke bisëduar miaft mbi këtë çështje dhe më në funt si nga anë e qeverrisë ashtu dhe nga



kuvëndi u pëlqye mëndim'i Gurakuqit i cili tha se nukë munt të flitej për kundrështim a mos besini ndaj Qeverrisë. Pasi që ndryshimi nukë gjau mbi programën e qeverrisë po mbi një çështëje pa rëndësi themelore.

Kryetar'i qeverrisë Ismail Qemali kërkoi që formimi i Ministrisë të mbetej deri sa të vinin e dhe Delegatët e tjerë si dhe Ajdin Draga kërkoi që edhe e pleqësisë të mbetej për pastaj.

U vendos që xgjedhëjet të mos bëhenë deri sa të mos vijnë Delegatët e Janinës, të Gjirokastërs, të Çamërisë dhe të Tepelenës. U vëndos që njërezit që dotë dërgohenë si komision në Evropë, t'i xgjedhë Ministria dhe kështu bisëdimi mbi këtë çështëje u la për ditë tjatër.

Mbëledhëja e IV. më 3-XII-912

Mbëledhëja u hap, këndohet një telegram nga Kavaja ku thuhet se Kavajasit kanë xgjedhur për Delegat Abdi Toptanë si dhe nga Tepelena ku çfaqën se sheh Maksudi dhe Sami beu janë të sëmurë e s'mundën të vijnë në kuvënt, si Delegat në vent të tyrej shënohetë Myfit Libohova, Fehmi



kryetar' i klubit Shqipëtar të Janinës, Kristo Mëksi dhe Aristith Rruci. Sot erdhë Delegatët e Gjirokastërs emëret e të cilëvet janë këta, Myfit L. P. Poga Jan Papadhopulli, Hysen Gjirokastëra dhe Veli Këlcyrë.

Myfit L. kërkon shënimin e Delegatëvet të Çamërisë prej kuvëndit me që telegrafi me atë krahinë nuk punon. Ky proponim u pranua me një herë dhe ashtu xgjodhi kuvëndi si Delegatë Veli Rreshadien, Vesel Iakupin, nga Margëllëçi, Aziz Tahirin nga Ajdonati dhe Raxhep Demi nga Filati. Kryetar'i mbëledhëjës proponon Qërim Bejnë si Delegat'i Ipekuti. Duke kënduarë letrën e Jahia Durrësit i cili kish vatë me leje në shtëpi ku shkruan se lë si ndëkëmbës Abdi bejnë. Bisëdohet çështëja se ka të nhrejtë a po jo Delegati që të lërë ndëkëmbës. Vendoset se këtë të ndrejtë munt t'a ketë Delegati atë herë kur shkruanë ashish sojë ndë letratë e emëriimit të Delegatit.

Kryetar'i Qeverrisë së përkohëshme ngrihet dhe tregon konditata që duhet të mbush Ministria që të kënaqë Evropën dhe Stambollë më tjatër anë. Prandaj duhet të jenë emërat e tyrej të njobur si ndë Shqipëri



ashtu dhe jashtë Shqipërisë. Pas kësaj kryetari Qeverirsë qirti përpara një listë si projekti në të cilën ishin të shënuar Medmet Pashë Tetova, Myfit L., Azis. Virioni, Vehbi, Abdi Toptani dhe Midhat Frashëri.

Dudë Karbunara ngrihet kundër faktit që ndëkëtë listë s'gjendet as një i krishterë. Në këtë mënyrë flasën dhe Pandeli Çali, D. Berati dhe Qemal Elbasani. Lista nuk votohet dhe mbetet që të mbarohet këjo punë të nesërmen.

Mbëledhëja e V. më 4-XII-912

Mbëledhëja u hap, nga 63 kongresistër mungojnë 6 vëtë. Lajmërohet se Delvina xgjodhi si Delegat Mehmet Ali Pashën pokyj me shkak të pashëndetësisë nukë erdhi. Kuvëndi pranon birin e tij Avni. Kryetari këndon urdhërin e ditës 1) të xgjëdhurit e Ministravet, 2) të xgjedhurit e pleqesisë.

Krytar'i Qeverrisë shtron përpara kuvëndit një mënyrë të re për xgjedhëjen e Ministravet duke thënë " fuqinë që e kam unë në këtë çështëje ja lë kuvëndit, kuvëndi e të xgjedhë 8 vëtë a 7 siç kishim thënë që të jenë 4 të krishterë e 4 myslimanë,

i lutot kuvëndit t'a pranojë këtë mënyrë, të mos merret me fjalë shumë po t'a mbarojë këtë çështëje sa më parë. Disa Delegatë flasën kundër këtij proponimi dhe kërkojnë prapë që këjo barrë t'imbetet krye Ministrit. Me gjithë që më të shumët e folësvet ngrihen kundër kësaj mënyre por më së fundi mbetet që t'i xgħedh kuvëndi Ministrat.

Votuan 5 vëtë; Gurakuqi fitoi 54, Myfit Libohova 52, Mehmet Pashë Tetova 42, Abdi Toptani 34, Midhat Frasher 35, Pandeli Čali 22, P. Poga dhe K. Meksi nga 21, Lefnozi 20, Sami Virioni 15, Myfti Vebiu e Dudë Karbonara nga 14, Murat Toptani 13, Eqrem Vlora 10, Jan Papadhopulli 8, Ilias Virioni 7 dhe i fundit D. Zografi fitoj 6 vota.

Nga këta, proklamohen të xgħejdher 5 vëtë. Të parët që kanë një nēmur votash më tē madhe e më shumë se gjysma d. m. th. ata që kanë pēr mbi 28 vota. Fitojnë pra ndë këtë votim Myfit L., Gurakuqi, Mehemet Pašhaj, Abdi Toptani dhe Midhat Frasher. Të 12 emerat që vazhdojnë pas këtyrej, duke mos pasur nēmурin e votavet tē mijafha viren përséri nē votim.

Nē votimin e dyjtë zərat u ndanë këslrtu:



P. Poga fitoi 40, Pandeli Çali 39, Lef Nosi 37, K. Meksi 19, Dudë Karbunara 16, Eqrem Kyrrjai 2, Myfti Vebiu dhe D. Zograti nga një votë. Quhen të xgjedhur trëtë parët që fituan më shumë se gjysmën e votavet 28. Përpara se të fitohet votimi pér të xgjedhur kshillonjësit, D. Berati i lutet kuvëndin që të mbarohet këjo xgjedhëje më një votim d. th. të quhen të xgjedhur ata që dotë kenë vota më shumë. Proponim i tij pranohet dhe sa kaq nis vëtimi. Zërat u ndanë në këtë mënyrë: Ilias Vrioni 55, Sami Vrioni 54, Dudë Karbunara 48, Mustafa A. Kruja 42, Murat Toptani 42, Eqrem Syrjai 40, Myfti Vebiu e K. Meksi nga 39, D. Berati 38, D. Zograti dhe Bedri Ipeku nga 35, Sali Gjuka 35, Veli Këlcyra dhe Hairedin Cakrani nga 22, Xhelal Skrapari dhe Shefqet Daiu nga 30, Dervish Elbasani 29 dhe fundi Ajdin Draga fitoi 27 vota.

Midis atyrej që s'muarrë dot aqë zëra që duheshin që të xgjidhen, vetëm ata që panë më shumë se 70 vota janë; Veli Gjirrokastëra dhe Zenel Peja nga 24, Rexhep Peja, Isa Bullatini dhe Azis Gjirokastëra nga 23, Zihni Abazi 21, Jan Minga 20, Qemal Elbasani 19, Aristidh Rruci dhe Floqi nga

14, Qazim Kokoshi dhe Jan Papadhopulli nga 13, Qerim Ipiku dhe Riza Jakova nga 11. 11 Delegatë të tjerë fituanë që nga 11 zëra e poshtë.

Mbëledhëja VI, 6-XII-912

Mbëledhija hapet në orën dy, nënë kryesinë e Myfti Vebiut. shkronjësi Shefqet Daiu hapi fjalën duke i kërkuar mbëledhjes t' i xgjedhë ata njëres, që dotë mbrojnë çështjen Shqipëtare në qarket politike t' Evropës,

Përgjigjet kryetar' i Qeverrisë duke thënë se këjo punë ka mbetur ndë barrë të Qeverris e cila punon pa reshtur përmë i dhënë një funt të dobishm e të çkëlqyer. Vendoset që Qeverria të ketë liri të plotë në këtë çështje. Kryetar' i Qeverrisë merr fjalën më pastaj duke thënë se Qeverria e përkohëshme ka ndër mënt të japë një faleje të përgjithëshme për të dënuarët që gjenden në përburgje të Shqipërisë pasi të mirret vesh me auktoritetët e gjithë krahinave Shqipëtare. Kongresi e pëlqen këtë mendim dhe i lutet kryetarit t' a zbatojë.

Mustafa Asimi Kruja pyet "si do të



mbushet sërish nëmuri i pleqëve atë herë kur pleqësia do të prishet me nonjë farë mënyre? përgjigjet shkronjësi D. Berati duke thënë se në vënde të hapura të kshillës duhet të vihen ata që dotë ishin atëherë kur të mos gjëndesh fare ay q' u xgjoth prej kongresit, d. m. th. ay që vjen pas atij q' u xgjoth me vota më të pakta nga të tjerët.

Vendoset ky proponim më terësinë e zëravet. Fjala mbyllët duke vendosur që me qënë se qeverria tash zuri një veprim të rregullshmë, kongresi të mbajë edhe dy ditë.

Mbëledhëja VII, 7-XII-912

Mbëledhëja u hap si nïbas zakonit. Lajmërohet t' ardhurit e Delegatëvet të Ohrit Hamdi Beu dhe Dervish Hima, nga Starova Hajdari dhe Mustafai si dhe nga Mati Ahmet Miftari, Riza Beu dhe Kurt Agai. Nga këta Zotërij s' kanë ardhur akoma në mbëledhëje Dervish Hima dhe Hajdar Bloshmi

Meksi hapi fjalën duke i kërkuar kryetarit e mbëledhëjes, kongresi dhe për së dyjti t' a çquajë barrën dhe emërin e

Delegatëvet; quhem i Delegatë, Këshillonjës apo Senatorë? formojnë këta 18 veta një senato-konseile d' etat a tjatër gjë? kështu thotë Sami Vrioni. Murat Toptani flet gjithë në këtë mënyrë. Kryetar' i qeverrisë së përkohëshme u pëgjigjet gjithë këtyrej duke u thënë se këto sende i do Meksi të vendosen sot kanë marrë funt që ditën e xgħedħej së pleqësisë. Q' atēh ēra u tha se kējo pleqësi por si "mandatareja", ndëkembesia e kuvendit dotë bashkpunojnë me qeverrin së përtashme, do t' a kontrollojë dhe t' a kshillojë kur te jetë nevoja. Në këtë mënyrë flasen dhe Gurakuqi, Kacori dhe Shafiq Daiu. Mustafa Kruja çel një çeshħej s'cila rrieth prej së parës. Kanë tē drejtës thotë Z. ētij atē here kurr s'u pēlqen ndo një sent nē punë tē Ministrisë t'i kérkojë llogari dhe po tē mos digjohen t'ia marrin atij Ministri fuqinë?

Kryetari i qeverrisë flet kundër ketij mendimi dhe duke thënë se këto fjalë si kur dëftojnë se kuvendi s'ka besim tē plotë te qeverria, vë "çeshħejen e besimit", ka apo jo kuvendi besim tē plotë nē veprimet e Qeverrisë? tē gjithë pér një gojë pērgjigjen pooo...!

Venaoset pra se pleqësia sot pér sot



s'munt të punojë pas një program hollë-sirash, se pse një program i tillë s'munt' të bëhet, s'munt të dimë ç'na siell dita e nesërme. Vendoset se pleqësia s'ka të drejtë të rrezojë një Ministër. K. Meksi, i pa kë-naqur me këto vendime s'munt të punojë pa programë dhe i kërkon kuvëndit t'i pranojnë dorëheqëjen.

Kryetar'i Qeverrisë, i lutet Meksit, t'a marrë prapë dorëheqëjen dhe kuvëudit që të mos t'i a pranojë kërkimin e tij.

Këtu imbaron mbeledhëja Kombëtare detyrën e shenjtë dhe të rëndë që ju përket.

Mbi vazhdimin e juftësë Ballkanike dhe veprimet e Qeverrisë Shqipëtare.

M'anë tjetër Turqia pas 25 ditë luftë u munt më të gjithë anët nga ushtria e shtetevet të Ballkanit dhe kështu u shtrëngua të körkojë paqenë. Në Çatallxha u bënë fjalimet duke nënëshkruarë të pushohej lufta. Mirë po greqia nukë e firmoi protokollin tuke qënë e shtyjtur nga dashirat e ushqyera të shokëvet e tij me të cilët ish lidhur por ca më shumë për të siguruar enderesat e vet kish qëllimin të qëndronte Armike për të ndaluat Turqinë që të mos



silltë dot ushtarë nga det'i bardhë; se pote bij ushteri munt të bëhej e zonja të çpalltë luftë. Pas këtij fjalimi që thamë u xgjodhë Delegatë prej Turqisë dhe prej të katër mbretërivet të cilët shkuanë në Llondër ku inbahej konferenca e paqes.

Delegatët e Shqipërisë të dërguarë prej Qeverrisë Provizore Shqipëtare, Z.Z. Rasih Dinua nga Çamërija, Mehmet Konica, Noga nga Shkodra kishin arrijtur dhe ata në Llondër të cilët bënин marrëveshëje me kryetarin e Qeverrisë provizore për heraku mernin programet e kërkimevet q'i paraqitnin në konferencë. Marrëveshëja që bëhej midis kryetarit e Qeverrisë dhe Delegacisë Shqipëtare në Llondër si dhe çpalëjet që bënte kryetar i qeverrisë në qarket politike siguruanë fitimin e Shqipërisë si dhe bujën e Shqipëtarit n'Evropë.

Venizellu, krye Ministër i Greqisë duke mos i bërë ballë dotë kundreshtimevet e arrësyshme dhe të famëshme të Delegacisë t'onë, plasi nga nakari dhe me të çpejtë dërgon tropidot të prishën kabllon që me këtë mënyrë të priten marrëdhënëjet e të famëshmit kryetarit të qeverrisë t'onë që bënte me Evropën. Tropidotë Greke shumë ditë Vuani së kërkuar i telin në det përbrënda.



stazanit dhe së bombardisuri më gjylë Vlorën sa më në funt i arrijtin qëllimit duke prerë kabllon. Porë mbasi u mërguanë vaporrët e Greqisë nga Limani vrapuanë Nëpunësit kompetentë Shqipëtarë dhe e godinë prapë. Fillon prapë kryetar'i Qeverrisë së shkruari n'Evropë si dhe Dalegacisë t'onë në Llondër duke ju latur fuqivet e mbëdhë të ruajnë enteresat e kombit Shqipëtar i cili ka mundur të rrojë më vehte në Balkan duke përbajtur gjuhën më të vjetër d'he zakonet më të mira të tij.

Greqia Barbare, më e para armike e kombit t' onë duke parë se Shqipetari me këtë udhë që ka zënë munt të rrojë një shtet i fortë, përpinqet me çdo mënyrë djallëzie për t' i thurtur rrugën e fatit të Shqipërisë. Tropidot e saj si qën të tërbuar futen prap në Liman të Vlorës dhe pas mundimevet e bëra në 4 ditë e sipër, me ndihmë të disa trathëtorëvet mundi t' a prishë lkreit telin dhe kulën e kabllos. Shpie një tufë ushtarë dhe në Sazan dhe e bën apllok Shqipërinë duke ruajtur e ndaluarë terë marrëdhënëjet Shqipëtare.

Apllokimi i Vlorës më tërë anët shkakëtoi një hidhërim, një dëshpërim të math në zëmërat e Shqipëtarëvet të cilët mbënë



në mest të armiqëvet, pa nonjë udhë të hapët që të lajmëron dashamirët. Tash qeverria provizore merret vetëm me rregullimin e brëndëshmë e me sigurimin' e qetësisë si dhe të ndihmojë Janinën me ngrënëje e më së fundi të forcohet duk'e i bërë ballë luftës që po bënët me Grekërit në Brekjet e në Delvinë. Fuqia Greke nënë kryesinë e Spiro Milos kish dalur ndë Himarë që më 21 të Vjeshtës e III ditën e festës të Barjamit fuqi e cila duke pasur ndihmën më të madhe nga popull, i padijtur e trathëtor të katundevet e Bregut të detit pushtuanë brinjat' e malit të asaj krahinë.

Burratë trima të Lumit e Vlorës si dhe të kurveleshit atë minutë u ngrenë ca me armë e ca pa armë, ju sulë malit e lartë të Bogonicës. fillon lufta më të gjithë anët, por fuqitë më të shumta ishin në qafë të mërtes, në qafë të Gurrës, në Çikë dhe në Llogora.

Shqipëtarët luftëtarë sa do që e qëndruanë dhe e shtyjtin ca më tejë fuqinë armike por armiqëtë t' armatosur mirë me armët e Greqisë ngulë këmbët në fortezat natyrale t' atij Vëndi. Komisioni i formuar në Vlorë kish dërguar si kumandant Eqrem



Syrijanë i cili bëri qëndër Vranishtin kundër luftës e Gurrës e të Çikës, Kuçin kundër qafës e mëretës dhe Dukatin kundër Llogorasë.

Vendoset që t' u bëhet sulm dhe të çkatërrohet kreit Bregu i detit, apën një fjalë, një parrullë dhe shënohet një ditë, një orë për t' a vënë në veprim qëllimin. Ora e shënuar pritej prej popullit padurim por pa mos ardhur ajo orë, mb' anë tjetër shpëtimtar i kombësisë kish ardhur, kish çpalltur dhe kish ngrijt tur flamurin kombëtar në Vlorë. Kryetar'i qeverrisë provizore atë ças mbëlodhi Ministrinë, parësin e vëndit dhe komisionin e luftës i cili ish formuar më pare ku i pyeti mbi gjukimin' e sulmit.

Kuvënduanë gjërë e gjatë dhe më të shumnat e mejtimevet çfajnë dëshirënë e plotë mi nevojën e sulmit. Me që Greqia ka pushtuarë të gjithë detin e Shqipërisë dhe për vec që do të bombardojë rrepësisht po të shohë se Shqipëtarët pushtojnë, djegën Himarën por Shqipëria e pa lindur mirë moralisht ka për t'i sjellur një dëm të plotë.

Prandaj u lajmërohet nga ana e qeverrisë qëndravet e luftës duke porositur të



qëndrojnë në pozitat që janë duke i bërë ballë armikut me armë dhë me shënjë kombëtare.

Vendim' i njoftuar në çetate luftëtarë bëri aqë një përshtypëje të keqë sa arrijti gati në mos bindije me dëshirë të vazhdonin programin' e parë. Porë populli luftëtar, i bindur në veprimet e Ismail Qëmalit i cili u lajmëronte çpallëjën e vetqeverrimit, qenë të shtrënguarë t' a vënë në veprim. Populli i cili kish një besim të plotë të krystar'i qeverrisë ku n' ato kohëra nëmërohej si Profit; me gjëzim, të kënaqur u bashkuarë me fuqinë e qeverrisë. Pse se populli Shqipëtar i aratisur më çdo anë të Shqipërisë, duke parë që Turqia me një herë u munt, mjerisht duke parë që armiqëtë nga tërë anët i rynë Shqipërisë, të mahnitur e të hidhruarë fort mejtonin se si puna dotë bahet.

Në mëst të kaqë mendimevet e trubullimevet, në mëst të shumë pa kënaqësive morale dhe materiale që ndiejnë, shohën se arriu udhëheqës i kombit në Vlorë dhe merr për sipër fatin' e popullit e të shtetit Shqipëtar duke çpallur vëtë qëverrimin i cili përndau rëtë e zeza dhe në vënt të tyraj çelët, fëks një dritë e shkëlqyer. Shqi-



pëtarët, pa si tham drita e çkëlqyer u ngrohu zëmërat e ftohëta, u forcoi shpresat e ndienjat e tyrej dhe për një herë filluanë t'i hedhën duartë qeverrisë Shqipëtare nga e cila kthyen gjithë mendimin e pandehmën për të shpëtuar kombin'e vet

Si një i sëmurë që merr sigurim përrrojtije dhe fillon të emiliset së rish ashtu dhe populli i Vlorës, Beratit, Tepelenës e Kurveleshit plot zëmërat më shpresa shkojnë palë palë në luftën që përmënt më lart. Më shkak që lufta e Gurrës dhe e Çikës kishin më shumë rëndësi nga të tjera, gjëndesh dita ditën në Vranisht një fuqi e riservuar prej 4-5 qint njërs, dhe në qëndrat e tjera thua po kështu. E tërë këjo fuqi mbahej me ngrënëje jo nga qeverrije por nga popull'i qëndravet të cilët me një dashuri dhe me një zëmër bardhësi patriotike i ndanin vëtdashësit dera me derë.

Shqipëtaret të mbëledhur nënë syndimin e qeverrisë kombëtare filluanë bashkarisht të punojnë duk'e i dhënë besimin Qeverris'e e dalur prej gjirit, shkefit tyrej. Por duhet të përmëndet se nji Qeverri provizore e tillë e kishte barrën shum të rëndë dhe ndërgjegjejen morale e materiale shumë të madhe.

Më një anë përpinqet t'i bëjë ballë luftës jugore, më anë tjatër të ndihmojë Janinën por rrezihu i tretë kundreshtim i ushtërisë Turke e cila kish pushtuar më parë Myzeqenë e Beretin.

25 mijë ushtarë Tyrqër të prishur nga lufta e veriut që bënë me Sërbinë, të xbatchur, të xhveshur dhe të urët, mbasi e ropnë dhe e shkretuanë gjithë Myzeqenë vënt i cili kish për të siguruar jetën ekonomike të shtetit t'onë, ju reshtënë Vlorës me qëllim të sigurojnë ushqimin e tyrej si dhe të shtien në rrezik Qeverrinë kombëtare t'onën.

Mbasi ushtëria Turke kupëtoi se është e pa mundur ryrëja në Vlorë, më të shumët shkuanë në Janinë, ca më të paktët nga ata që mbenë në Berat u përhapnë në anëra të Myzeqesë e në Vlorë. Një rrezik tjetër i Qeverrisë ish ajo që vëndi i ngushtë, populli i shumtë, Myzeqea pjesë e pushtuar dhe më të gjithë anët e apllokuar, qysh duaj t'i benej ballë ushqimi?

Shkodëra dhe Janina po leftojnë rrepësisht, Sërbia po i qaset Vlorës duke për ndëjekur ushtarët Tyrqër të cilët po përpinqen të qirtën ngatërimi si ujku që dotë jetë faqia e dheut mjegull për t'i arrijt



qellimit, Greqia mb' anë tjetër po hidhet si qën'i forte i lidhur me zinxhirë, Sërbia thotë do hyj unë në Vlorë e mb' anë tjetër Greqia i kundreshton duke thënë deri në Shkumbin është imija.

Vulneti i qëndruarë dhe dëshira e popullit por ca më shumë xhpresa e kombësisë u bën ballë rrezikevet më ç'do farë mënyre. Natë e ditë nuk bën gjumë por nga sulmet e armiqëvet nukë trëmbet as pak duke kumbisur në fuqinë e vërtetë besnike të popullit Shqipëtar.

Pa mos shkruarë të themi si për një shënim çudie: Populli Shqipëtar, i trëmbur nga rreziket e tmeruara që kishin qarkuar shtetin t'onë të ri, nga frika e topavet vijnë një pas tjetërit, i math, i vogel, më nxitim te kryetari pa mos mejtar se është mesnate ose i pushtuar me punë. Ismail Qemali i priste më gëzim duke ju kshilluarë të jenë gati për të shpëtuarë Shqipërinë sa dhe dylmerët e bagëtive i thoshin kryetarit "jemi me tyj dhe e presëm shpëtimin t'onë nga tinë,,.

Kryetar'i Qeverisë priste çdo sërë njeriu që t'i vinte, i dijtur i pa ditur, nat, e ditë kurdohera e gjenin të ngrijtur dhe pa mos murzitur fare i përgjigjej pas pyetëjes që

t'i bënej. Nuk'u tregua i math e i rëndë, nuk'u tregua fytyrë ashpër si aristokrat o feodal por gjithënë tregohej si në sjellëje ashtu dhe në punë si një demokrat e si një patriot nacional i vertetë. Tërë dimërin nukë e lanë nonjë natë të flij më shumë se dy orë gjumë. Kish gjarë shumë herë që flij pa xhveshur, që e ngrinin nga gjumi.

Dua të them, të mos që Ismail Qemali në këtë kohë kur Shqipëria është e qarkuar prej shumë rrezikevet; doj të ishtë e pa mundur që tjetër njeri të bëhej udhë heqës i kombit dhe t'ia arrinte qellimit si Ismail Qemali i cili me kshillimet dhe sjellëjet e tij në një popull fare të pa organizuar të fitojë një dashuri, një sympathi dhe me këtë mënyrë të formojë një fuqi të çeliktë e cila i vu dre të fortë Shqipërisë.

Përparimi dhe forcimi i Qeverrisë së re Shqipëtarë e cila po ju bën ballë tërë rrezikëvet, aplokimëvet dhe sulmevet e rrepëta; hoqi vrejtëjen Greqisë sa u shtrëngua të mbëlidhet Ministria nënë kryesinë e Venizellos ku mbas shumë bisedimevet rrotull çështëjes Shqipëtarë vendosnë të bejnë një sulmi të përgjithëshmë me qëllim



që t'a bindën dhe t'a pushtojnë shtetin e vogël Shqipëtar i cili pas përparimit që ka filluar do t'i arrijë njëi ditë që t'a sëmurë dhe mbasë t'a vdesë fare Greqinë. Më një anë prej toke dhe mb' anë tjatër prej deti u sul ushtëria Greke e cila gjer aty lashti ka qënë nënë sundim të Ali Pashait dhe më pastaj nënë pallën e prehëtë të Shqipëtarëvet. Mir po sulmet edhe gjaku i tyrej që derdhë u vate kot duke mos muudur dot të marrën prej Shqipëtarëvet as një pëllëmbë vënt. Bombardoi nga liman'i Vlorës rreptësisht qytetin. Popullsia e qytetit fort'i drithmuar arrijti të kryetar 'i Qeverisë i cili dolli përpara rrëmetit duk'ë u thënë "mos kini frikë, kini kurajo, armiku nukë ka se çtë na bëjë, ju siguroj 89 për qint ashtë fitim'i ynë, fundi do përpinqemi me trimërinë që trashëgojmë duke vdekur nëne hien' e lartë të flamurit kombëtar,,. Dërgohen nga an'e Qeverisë 3 vetë me flamur të bardhë të cilët venë në Vaporët e armikut në Liman duke ju thënë "ç'jane këto gjyle që hidhen, ç'ke që nga cënon shtetin Shqipëtar? Juve keni luftë me Turkun e jo me shtetin Shqipëtar të as një anëshm ku mbretëron liria dhe flamuri kombëtar,,.



Vazhdim i kësaj lufte për qark kufivet e Shqipërisë se vogël shkakëtoi ikëjen e Shqipëtarëvet nga Janina ku me gjithë që qenë të shtrënguar nga mungim' i ushqimit por ranë në dyshim të fëmijëvet. Më parë u aratisnë nga Pista ca Boshjot dhe pastaj Sheh'i Horënovës me Tepelenas, Gjirokastritë dhe më të bisht e prapa Vlonjatë duke i lënë të hapur armikut shekullor portën e Toskërisë. Qeveria provizore dërgoi në Janinë një pas tjatërit dy komisione, për të kshilluar Shqipëtarët por mjezisht kshillimi vate kot se dhe një pakicë prej tyrej kish mbetur të cilët duke mos duruar dot vrejtëjen e dobërt të oficerëve Tyrqër filluan të shkojnë pas gjurmëvet e të parëvet.

Në këtë kohë Sërbia po qaset në midis kufis Lushnjë-Fier dhe ushtarët Turqër në Myzeqe po shumohen. Kohë miaft e trubulluar dhe e mejtuar në të cilën fillojnë propagandistët të trubullajnë akoma mëndjen e popullit me qëllim të prishën bashkimin'e shenjtë.

Më një anë rreziket, mb'anë tjetër propagandat e thëna, të bëra prej disa bëlerëvet trubulluanë aqë shumë mendijen e popullit besnik sa ca nga ata vanë të



Kryetar'i qeverrisë dhe i thanë "mos n'a merr me qafë, mos na le të prishemi, na nuk mundëmë dot t'i prapsëmë tërë këto rrezike po lena të ipëmi me të mirë ..".

Ismail Qemali, i cili kish formuar iden'e vetë u tha "unë jam Shqiptar dhe nukë epem në duar të armiqvet, kush të det të rrijë me mua jo po fundi-këtu u zëmërua për të parën herë dhe tha më një helm të math, unë me besnikët e mi do vete fundi më një mal a më një gërxhë ku do të hap flamurin të valojë ..".

Ismail Qemali për të mbajtur fuqinë e vet kombëtarë me besnikëri deri në funt filloj duke ju bërë popullit lehtësira të ndryshme duke mos'i shtrënguarë në nxjerrëjen e havajetevet, cavej u a falte fare, punërat zyrtare i shikonte pas zakonit, lutëjet i pranonte pa pulle, punëravet fetare iu bënte më të madhen ndër e lehtësi, të prishurvet shqipëtarë u ndihmonte, fali vergjin'e luftës, bëri xhelepiu 3 grosh kokën. Kujdo njerut i fliste fjalë me përgëthela, të vogëlin si i vogëh, të madhit si math, trimit si trim, të frikëshmit i ipër kurajo, të dijturit i kuvëndonte fjalë filosofike, më pleqtë bënte gaxhi mbi përfundimin e ëndërravet e të shpatullavet të



cilat i kish në vënt të lajmëvet telegrafike që ishin të prera prej njëj kohe të plotë.

Populli shkonte në mol me qellim se mos shohën no një vapor, por fatkeqësisht as një gjemi nuk luante të cilat ishin lidhur për shtylla të molit dhe deti Adriatik kish rënë në zi duke qirtur tërënje Valë të zeza.

Qeverria kombëtare e cila nuk merr as më të vogëlin lajmë rrotull bisëdimevet dhe opinionit dhipllomatik për sa i përket çësh-tëjes shqipëtare, disa herë më anë të anievët, mbështetazi dërgonte njërsë në Itali më shkresa mbi nevojat e kohës.

Në kohera të fundit, reziku më i math që ajo që po mbarohet buka fare, por besnikëria e popullit ishaq'e çuditëshnë sa linin fëmijën e vet pa bukë dhe luftëtarët nukë mërgoheshin nga ballina e luftës. Vazhdonte një qetësi e madhe sa s'digjohej të vidhej a të vritej njeri.

Lufta Ballkanike, në Jenar kish qëndruar, pushuar në mest të Bullgarisë, Sërbisë dhe Malitz'i e Turqisë. Greqia s'kish bërë paqë dhë po leftonte akoma. Konferenca e Londrës vazhdonte në bisëdime e cila kish çfaqur se çështja e Shqipëris dhe e Nisivet do të çkoqitej prej fuqivët e mbëdhë dhe



çështëjet e tjera të Ballkanit të çkoqiten midis qeverrivet e Ballkanit.

Për çashtëjen e Shqipëris kishin firmuar qeverritë e Ballkanit duke ja lënë në dorë konferencës që t' i cakëtojë kufit. Qeverritë e Ballkanit umbelodhë dhe biseduan gjer' e gjatë në mest të tyrej por me shkak që ishin të tërë lakonjës nuk' u ndrejnë dot dhe ashtu u përndanë për të përsërijtur luftën sërish. Nisëa e luftës përsë dyjti herë ish një vdekje e dyjtë për Shqipërinë, se gjer n' atë kohë as Shkodëra as Janina si dhe disa vize të tjera nuke kishin rënë akoma.

Vëndim i njohejes së Shqipëris.

Konferanca e Llondërs, mbas shumë bisëdimëvet mbi interesën e kombit Shqipëtar ku mbasi muarre firmat e të katër Shtetevet e Ballkanit si dhe të Turqis vendosnë më 20 (12) 1912 njohejën e Shqipëris duke theni "Shteti Shqipëtar njihet, bëhet më vete i cili do rrojë në mest të Sinisisë e Ballkani, Kundreshtimi i rreptë i trikupëtimit mbeti pa rëndesi e i pa themel kundër deshiravet, kërkimevet e trilidhëjes e cila mori në sy ç' pallëjen e



luftës të përgjithëshme në një ditë e sipër në qoftë se nukë u dëgjohet fjala për mirësinë dhe njchëjen e Shtetit t' onë.

Më vonë, prap ajo Konferencë, më 17 prill 1913 vendosi në pikat e përgjithëshme kufirin e veriut. Më 11 gusht 1913 vendosi kufirin e jugës në vijat e përgjithëshme. Dy komisione qenë dërguar në Shqipëri njëri për kufin' e veriut në vija të çkoqitura dhe tjatëri për të jugës. Kyj i fundit mbasi do thuhet më poshtë, e mbaroi detyrëu por mjerisht komision' i kufivet të veriut i cili shkoi në vënt qysh më 1912-14 nukë mundi m' e mbaruar veç se një pjesë shum të vogël të kufirit edhe nga shkaku i luftës së përgjithëshme i la punët vartur. Kyj vendim ndofta krejt i pa ndrejtë këputi nga gjiri i Shqipëris Kosovën dhe Çamërinë, dy pjesa më të mbëdha me ndienja fjesht Shqipëtarë. Shqipëtari i pa gatitur dhe i pa organizuar, mbas nevojës e kohës u shtrëngua t'a pranojë përkohësisht këtë vendim të të pa ndrejtë i cili i këputi po thua nga gjiri i mëmës të saj ma se gjysmën e trupit të Atdheut duke i falënderuarë kujdesimin e fuqive të mbëdha.

Shpresat e plota ishin se Konferenc' e



Llondrës kish më i dhënë Shqipërisë gjithë kufitë etnike, kufitë që i ka falur zoti dëri ku flitet gjuha e ambël e zogjvet të Shqypes por çashtëja siguroi të kundërtën pse se kundreshtaret e Shqipërisë në atë konferencë përkrahnin tëpër fqinjët t'anë që ishin ma të fuqishm nga nevej dhe miqt e Shqipërisë me gjithë që ngulë këmbë ashpërisht por fuqia e tyrej nuk është arrijti deri sa t'i epen Shqipërisë kufitë etnike për veç njohëja e garantueme e mvehtësisë të kombit Shqipëtar.

Në këtë vendim të pa shpirtë të Llondrës i u dhanë vënde Malit të Zi përvetësuar vëndevet që i ishin dhënë në kongres të Berlinit më 1878 veçanërisht i u dhanë Sërbisë, dhe Greqisë vënde fjeshtë shqipëtarë të cilat kanë një vënt të gjerë e një popullsi sa ma e shumta e Shqipërisë të sotme që garantoi konferenc' e Llondrës. — Sikurse dihet shumë mirë prej gjithë Shqipëtarëvet, kufiri etnik — kufiri i vjetër — i Shqipërisë fillon prej gjinit të Spicës (nëveri të Tivarit), kthëhet drejt në nord-estit duk' e marrë brënda Tuzin, Hotin, Grudën, Triepshin, Podgoricën, dhe duk' e ndjekun kufirin e Malit të zi që ka pasun përpala motit 1912 përmbleth Pejën.



Gjakovën, Mitrovicën (pjesën lindore) Prishtinë, Gjinlanin, Ferizovikun, Kaçanikun, një pjesë të kazasë të Shkupit, Tetovën, Gostivar, Kërçovën, Dibrën, për më arrijtun të mal i thatë ndërmjet liqënevet t' Ohrisë e të Prespës. Që nga këjo pikë kufini ndjek vijën e 1913 deri të maja e malit gramos e vazhdon prej sudit për më dalë afér gjinit te Prevezës. Të gjitha vizet që gjendenë në perëndim të këtij kufini përbajnë Shqipërinë etnikë e Historike.

Brënda në këto kufi që cakëtohen më sipër jetojnë ma se 2.000.000 Shqypëtarë nga të cilët ma pak se gjysma janë ndër kufitë e shënuara në konferencë të Londrës që tham ma sipër dhe të tjërët janë në ato vize që u lanë po në këtë konferencë Malit e zi, Serbisë e Greqise.

Munt të thuhet pa u larguar së vërtetës se në vizet e lëshueme shtetevet që u përmëndë ma sipër, popullsia shqipëtare përban n' ato vende një shumicë 80 % mbi elementet slavë e grekër. Në disa nga këto vize, për shëmbëll në kazatë e Pejës, Gjakovës e Pizrendit në nord e në krahinën e Çamërisë në Sud, elementat sllavë e grek formojnë një pakicë fort të vogël.

Ay që nukë i ka pasë njojur ma sëpari



të drejtat é kombit shqipëtar ka pasë kënë kuvëndi i Berlinit. Arrësyetë e kësaj mos njohëje shkoqiten me faktin që Shqipëria nukë ka pasë kurrë mbrojtës ashtu siç kanë pasë kombë të tjera të Ballkanit. Shkoqiten edhe me situatën gjeografike të Shqipërisë që ka pasë tërhequn gjithë monë lakëmitë e fqinjëvet t'anë.

Traktat i Berlinit i ka këputur Shqipërisë Tivarin, Hotin, Grudën, Triepshin, Kuçin, Podgoriztën, Plavën, e Gusiënë për Malin e Zi edhe një pjesë nga ana e poshtërmë ndërmjet Gjinit të Prevezës e Lumit të Kalamasë për Greqinë.

Mbi këtë pa drejtësi shqipëtarët formuanë lidhëjen patriotike të Pizrendit që iu kundrështuan më armë lëshimit të Plavës, Gusiës Hotit e Grundës. Fuqitë e mbëdhaja i dhanë atëherë Malit të Zi si shpërblim të këtyrej visëvet limanin e Ulqinit edhe ky shpërblim mundi të vihet në veprim vetëm me një demostrate navale.

Nga ana e poshtërmë lidhëja qëndroi gjithë ashtu gjallësish. Komisioni ndërkombëtar që kish vatur asnjë kohe në Prevezë për me i dhanë Greqisë ato vise shqipëtare hasi në qëndrimin e popullsisë shqipëtare e duall e shkoi prapë për gjurmë



pa kënë i zoti me e mbarruem mision' e vetë. Më raportin e këtij komisioni, fuqitë e mbëdha ishin shtrënguar t'a njohën karakterin shqipëtar të asaj krahinë që deshnë t'ia apën Greqisë dhe e zbritnë asi kohe kufirin e Shqipërisë deri te Lum' i Nartës së Madhe.

Me arrësyё fort të drejtë anht thirrur e konsideruar traktat i Berlinit, traktat i vrorimit të Shqipëriës. Më gjithë këto, mjerimet q'i ka dhanun traktat i Berlinit Shqipërisë munt t'i quajmë fort të lehta po t'i vësh në peshë me ato mjerime e e katastofe të pa mshirëshmq që i ka bamun, që po i bën konferenc' e Llondrës të cilës fatkeqësisht nuk i mjaftoi via e Kalamasë si ku si të cilën shqipëtarët, siç u tha ma nalt e kishin prishur e çuarë në Nartë por i dha Greqisë gjithë atë krahinë prej gjirit të Provezës e deri në Këp Stilos. Kejo krahinë e cila shtrihet deri në 30-40 kilometra thellë, ka pasur para lufte Ballkanike një popullsi të përgjithëshmë prej ma se 65 mijë frymë nga e cila 42 mijë shqipëtarë muhamedane, 14 mijë shqipëtarë orthodhoksë e 9 mijë grékër.

Në Nord e në Est i ka falur Malit të Zi e Sërbisë, siç u tha ma parë krajen, anën



e Malit e Bajrakët e Hotit e të Grudës Plavës, Guciën, Gjakovën, Mitrovicën, Prishtinën, Gjylanin, Feqizovikun, Kaçanikun, Shkupin, Pizrendin, Tëtovën, Gostivarın, Kerçovën, Dibrën, Strugën, dhe Ohrin.

Në këto visé të cilat gjëndenë në të dy vilajetet Kosovës e Monastirit popullsia shqipëtare forman një shumicë 80 % mbi elementin Slav ku shqipëtarët e Kosovës të famëshme kanë derdhur kurdohere gjak për të mbrojtur lirinë, e mvehtësinë e zakonet e tyrej e veçanërisht më 1910, 1911, 1912 kanë bamun kryengrijtëje gjakësore për të fituem lirin e tyrej; më 1912, 20 mijë shqipëtarë prej Kosove bënë një luftë të rrepët kondra ushtërisë Turke dhe pushtuanë qytetin e Shkupit duk' e shtrënguar türqinë që t' u siguronte koncesione.

Qeverria e turqvet të rij e cila me gjithë që nukë ishte në një gradë deri sa të mbante e stabilonte një politike të qartë, që gati t' u njohë Shqipëtarëvet të ndrejtat e tyrej të kërkueme për të formuar një administratë autonome e cila siç ashtë thënë dhe ca ma parë do të mbelithët të katërvilajetet e famëshm, Kosovën, Shkodrën dhe Janinën si dhe një pjese të vilajetit të Monastirit.



Shtetet e Ballkanit të cilët duk' e kupëtuar dobësin e Turqisë të mundur prej Shqipëtarëvet e duk' e pasur frikë se po formohej një shtet vetëqeverrimtar Shqipëtar në ato vënde q' i lakëmonin prej disa kohë, shpëjtuanë dhe i shpallë luftë Turqisë dhe nga ky shkak Shqipëtarët nukë mundë të siguronin ndonjë fitim nga koncesionet e fituara me gjak e me armë të shkëlqyera në dorë.

Me gjithë këto katastrofe e copëtime q' i bënë shqipërisë, prapë nukë u ngopnë armiqtë t'anë dhe ashtu greqia po përpinqet të bindë qarket politike t' i apën akoma Epirin e veriut duke u shtruar si argument se në këtë krahinë ka një popullsi 120 mijë grekër e 80 mijë shqipëtarë kurse popullsia greke në këtë krihinë nukë ashtë ma se 20 mijë frymë dhe këta rrinë në fushë të Dërrropullit e të vurkut të Delvinës si bujq të pa tokë, të pa shtëpi që punojnë dherërat shqipëtare. Dhiplomacia greke shton akoma duk' e thënë se gjithë Ortodoksët e kësaj krahinë janë grekër pa u marrë parasysh kombësia e tyrej. Këjo dava e kotë e ka pasë shtyjtur zati kur do herë priftërinë greke t' a bëjë fenë një vegël në dobi të greqisë.



Lidhëja e Pirzrëndit i pati marrë e këputur Turqisë lejen dnk' e hapur një shkollë shqipe në Korçë dhe priftëria greke mallëkonte ata prindër Ortodoksë që dërgonin fëmijën në ketë shkollë.

Nga ana tjatër Qeverria Turke duk'e shtrënguar gjithë ashtu prindërit Muhamedanë të mos dërgojnë femijët në shkollën shqip; munt të themi çiltazi se kishin së bashku me priftërinë greke një bashkëpunim të plotë ndërmjet tyrej për dëm të shqipëtarëvet.

Pse vallë konferenca e pa shpirt njërzimi nukë merr para sysht sakrificat e shqipëtarëvet? pse nukë shef çka thënë Z. Jaray në librën e tij; shqipëria e pa njohur:

“ Prej 1908 deri më 1913 shqipëria ka pasur pjesën ma të parë në çashtëje të Orientit: më 1908 shqipëria e bëri Qeverrinë Turke të mundet e të bjerë; qysh prej 1909 shqipëria ka kënë kazma e themelit të Qeverrisë Turke; në gushtin e motit 1912 triunf i lumtur i Shqipëtarëvet që rynë në Shkup ka shënuar mbarimin e zotnimit të portës e naltë në Maqedhoni; kur, më 1912 besatarët Ballkanikë kanë ryrë në Turqi, kanë ryrë në një Turqi anarqike, dua të them në një Maqidhopi



ku auktoriëte, prej disa muajvet, faktos, kanë kënë bamun të pa kënë e diku edhe të dbuar fare nga an' e Shqipëtarevet; shkurt, çashtëja e shqipërisë ashtë problema ma e rand që mbetet për t'u zgjidhur pasi u shtynë Turqit në Stamboll e në Anadoll „.

Por, mjerisht nukë gjukohet ma e ndrejta dhë ashtu shqipëria nukë munt të fitojë as një sent prej mundimevet dhë sakrificavet të tyre. Konferenca e Llondrës në vënt që t' u njohë të ndrejtat dhë t' i vërë një melhem shërimi plagëvet e hapura e të mërijtura nga kongres i Berlinit duk' e i u dhënë të ndrejtën e bukur që dëshëronin, përkundrazi u këput vënde, krahina ma të bucura dhë u a fali fqinjëvet t' anë.

Rrotull rënëjes e Janinës

Armijtë t' anë, duke pasur frikë se Janina po të mos bjerë, doj t' i mbetej Shqipërisë; i ndihmuani me ç' o mënyrë Greqisë që t' a pushtojë. Janina e forcuar me shumë forteza si Bezhanë, kundrështon rrepësisht. Topat' e armikut zunë e po gjëmojnë në për vizet jugore, në për anë të



detit të Shqipërisë nga të cilat kishin mbetur dhe pak pa shkelur. Më anë tjetër Mal i Zi po e rreh Taraboshin duke bombardisur. Kral Nikolla u bërtet ushtërivet të tij "ja do marrëm Shkodrën ja vdekje", Sërbia e përkrah Malin e Zi, të cilët po vriten e po priten për të marrë Shkodernë.

Të gjitha këto gjajnë në muajnë e Janarit. Rumania po kërkon Silistrën nga Bullgaria. Përfundim' i bisëdimëvet në Petresburk ja dha Rumanis.

Konferenca ambasadorjale në Llondër bisëdon fatin e Dibrës e të Gjakovës si dhe mbi kufit e tjera të Veriut.

Anët' e detit të Shqipërisë janë të rrethuara prej ushtëris greke e cila më një anë bombardon dhe më tjetër anë apllokon e shtrëngon ca më shumë. Çmimi i ngrëniet në Vlorë merr një vleftë pas kohës shumë të madhe.

Lumtërisht misëri sado që shitej më një vleftë të madhe por më që gjëndej në dorë të qeverrisë ishte kursyer. Më 17-II-1913 garënda bombardiset dhe bie në duar të grekërvet, Mecova gjithë në këtë kohë bie. Lufta po na copëton, po i këput krahët Shqipëris.

Venizellua, mbasi u nis lufta për së dyjti

herë vjen në Greqi, merret vesh duke ju dëftuar dhe rrëzikun që hiqte Janina. U tha "Janina po të mos bjerë rrëzikonet Greqia dhe përfiton Shqipëria". Me nxitim vjen në Prevezë ku piqet me Konstandinë dhe mbasi i tregoi punërat, e shtrëngoi të marrë Janinën. Mbasi shtrënguan mjaftë luftën në të cilën panë shumë dëme grekërit dhe nuk po e shtiënë dot Janinën, fort të dëshpëruar zunë me ca mënyra dhelpërie. Esat Pashë Janina mbasi e pa që Turqia iku dhe po të mos bij Janina duaj t' i mbetej Shqipëris; me qënë që Janina për Turqinë shkoi; atëhere për se të vritej? Trathëtor' i Shipërisë nukë duaj farej t' i dëgjon ëmërin përparimit të At-dheut të tij Shqipërisë.

Zhon turqit e pa besë qenë të gëzuar shumë që t' i lënë Janinën Greqisë e cila ka për të shkelë gjithë Toskërinë. Shqipëria e as një anëshme përveç që gjëndet midis shum rrëzikeve dhe s' munt t' i bënte dot ndihmë materiale Janinës, por nuk i ipse dhe dorë për t' i ndihmuar asaj lufte e cila vazhdonte akoma në formë otomane.

Janina kryeqytet i Shqipërisë më 4 Mars 1913 ra në duar të grekëret.

Grekërit kishin vdekur tersej, nashti që



muarr Janinën ndiq u ngjallë pak. Filloj së pushtuari katundë dhe qytete të Toscërisë. Konica dhe Leskoviku bien më 12 Mars 913. Grekërit tashti pa mos parë farej nonjë kunddrështim pushtojnë Filitin, Paramithinë, Përmetin, Pargën, Teplenën, Këlcyrën, Delvinën, Gjirokartrë, Pogonin, si dhe Himarën më parë e tej. Shqipëtarët e këtyre vizeve duke mos pasur më në dorë vegël kundrështimi, nevojërisht qenë të shtrënguér t'i binden, t'i unjen bajonetës së ushtërisë barbare. Zia e madhe e mbuloi Torkerinë e cila pati fatin t'i unjet barbarit.

Tani në këtë kohë fillojnë vojtëjet, mjerimet e shqipëtarëvet duke vrarë tërë ata që kuvëndoja gjuhën shqip. Me mijera shqipëtarë zihen, lidhen dhe mërgohen në burgje të Ianinës, t'Athinës, të Korfuzit si dhe në Gjirit e në Selenik por më të shumët i vrasën, i therën dhe i ç'nderojnë nëpër udhëra. Shtëpit e shqipëtarëvet pushtohen duke qirtur fëmijerat shqipëtarë jasht, pa ngrënëje dhe pa veshëje.

Me të rënë të Ianinës, qeverria Shqipëtarë ndien dy rrezike: ardhëja e ushtërisë së armikut si dhe ajo e Turqisë. Dërgohen ushtarë kombëtarë në qafën'e Ylnecit të



cilët shtrënguan ushterin e prishur të Turqis të mos vijë në Vlorë.

Qeverria shqipëtare lajmëroj Gjiroka sternë dhe Tepelenën që të përmbajnë shënjat shqipëtare. Me gjith që Qeverria shqipërare nukë kish fuqinë e duhur materjale për t'i kundrëshuar ushtëris Greke pot situata e kohës e ndalonte nga frika e ushtëris Turke në Berat si dhe nga fuqia Sérbe e çila kish ardhur në kufi të Fierit, pas ca ditëvet ushtëria Greke arriti deri në Tepelenë e në fshatin Kuç dhe qëndroj.

Dorë për dorë pushoj lufta e anës jugore.

Ardhëja e Prins Ferdinandit në Vlorë.

Në një kohë kur populli shqipëtar rronte në mjerime dhe në fatkeqësira nga pikë pamija e ushqimit e shkakëtuar nga apllokimi që vozhdonte prej shume muajsh, arriti të shohë më 29 të Marsit 1913 një vapor i cili arriti në Liman. Ca të gëzuar po më shumë të friksuar vrapijanë mol. Me një herë dolli nga vaporri dhë arrrjeti në sqelë më i madhi mik i Shqipërisë Prins Ferdinandi Francois Bourbon-Orlëanit i cili u shqente dëshirën e veçantë të bëhej Princ në Shqipëri. Mbasi shëtitit



qytetin si dhe që më parë natyrisht vizitoi Kryetarin e qeverisë shqiptare ; shkuanë në vaporr së bashku me kryetarin e qeverisë. Isa Bullatini, trimi i fortë me ndienja patriotike të vërteta kish mbrojtur kurdo herë interesën e kombit, shqipëtar ; rrinte gati në mol bashkë me popullsinë shqipëtare.

Mbasi kryetari qëndroi miaftë, si Isa Beu ashtu dhe popullsia tjetër ranë në dyshim se mos kryetari ju linte vëndin. Por sa kryetari dolji nga vaporri dhe arrijti në mol, Isai i tha kryetarit duke qeshur “ burr i jetës thamë se na ike, po qënke vërtet i besës „ dhe e përqafoi.

Më të nesëret, kryetar'i qeverisë mbasi mori leje nga populli dhe mbasi la zëvëndës Myfit Libohovën, i shoqëruar me Isa Bullatinë shkoi bashkë me Princin e përmëndur n'Evropë me qëllim dhe më porosí për të prishurit e apollokos që kish rrethuar shtetin t'onë si dhe për sigurimin e enteresavet të Shqipëris.

Në këtë kohë, kufitë e veriut të Shqipërisë në bazë të pikavet e përgjithëshme kishin marrë funt. Kish mbetur vetëm kufir'i jugës për të cilën do flasëm më poshtë.



Rrotull rënjes e Shkodrës.

Lufta e Shkodrës, mbasi kemi thënë më lartë vazhdonte në formë Otomane në Kumandën e Hasan Riza Pashait i cili ish një fjeshtë Turk. Kumandant' i përmëndur mbasi e pa që ra krejt në humbëje entëresi i Turqisë me prishjen e ordhisë së saj në veri të Shqipëris, dijti të çmojë shumë mirë rolin dhe ndryshimin politik të kohës. Mbëlodhi parësin' e vëndit si dhe oficerat e ushtëris dhe i porosit mbi nevojën e çpallëjes e të formimit e shenjavet kombëtare Shqipëtarë dhe ashtu së bashku me Shqipëtarët t'u bënte ballë armiqëvet për të sigruuar enteresin e Shqipërisë. Këtë dhipllomasi kaqë të drejtë e të shënjtë e cila lë pika të çkëlqyera në Historin' e njej kumandanti të tillë; makari t'a kish përdorur dhe qeverria Turke në fillimin e luftës së Ballkanit si mbas porësisë që ju bë prej Qamil Pashait, si dhe Esat Pashë Janina që ish një Shqipëtar. Pa mos vënë në vepërim qëllimet e shënja të Hasan Rizait, arrijti kuçedra në Shkodër Esat Toptani i cili mbasi e thirri Hasan Rizanë për darkë më të dalë e vrau me të pa besi. Esat Toptani si një kumandant'i Turqis që



ishte si dhe një i par'i vëndit, mbasi mori kumandën e ushtëris në dorë, leftoi ca kohë deri sa beri marrëvesheje me shqëhtë, të cilët mbasi i siguruan entëresën vetjake, u a dorëzoi Shkodrën më 23 Prill 1913 pa mos trasferuar luftën e atij qarku në mënyrë dhe në shënja kombëtare.

Austria me një herë çoi ushtarët në ku-fi dhe u jep një ultimatom shqehet në të cilën kërkon lishimin e Shkodrës. Malizi, i trëmbur nga këjo ndërhyrëjë del me një herë nga Shkodra duke dorëzuar atë qytet fuqisë Enternacionale. Kryetar i syndimit shenohet amiral Burnëy.

Esat Toptani me ca topa dhe me një tufë ushtarë arrijti në Tiranë si pa gjë të keqë.

Prishëja' e apllokos.

Apllokua që kish qarknar Shqipërinë dhe që i ipej dita ditës ca më shumë shtrëngim nga armiqtë po më shumë nga Greqia e cila kish zapëtuar detin e Shqipërisë; më qithë që ra Janina dhe Shkodra por akoma nukë po hapet. Me vatëjen • Kryetarit të Qeverrisë në Itali, ndërmjetësoi për hapëjen e apllokos se ndryshe tha popull shqiptar ka për të vdekur urish.



Mbasi lufta Jugore morri funt, Fuqitë e mbëdha vendosnë dhe lajmëruanë Greqinë për prishëjen e apllokos e cila u vu në veprim më 1 Maj 1913. Italia më një herë dërgoi dy vaporrë me bukë të pjekur e cila u nda në popull. Kapëdanët e vaporëvet si dhe lajmet zyrtare rrotull prishëjes e apllokos sa do që u përhapnë më një herë si me thënë më telegraf pa tel, por populli akoma nukë duaj të besonte pse se dhe shumë herë më parë ishin gënjiyer për këtë punë. Më të nesërmet, ardhë dy vaporrë me miell ca më shumë siguruan hapëjen e apllokos. Njërzia filloi të lëvrijë i qeshur e i çkelqyér. Ju duk kujdo njeriut sikur lenë sérish. Në pakë ditë u mbush qyteti më çdo sent plaçkë tregëtie. Italia dhe Austria dërguanë dy herë ndihma ngrënëjesh të cilat u ndanë në popullin e vobektë.

Vlora që nuk kish fare gjësendi nga sendet e nevojshme, më 10 dit e sipër u plotësua si më ngrënëje ashtu më veshëje e tej.

Dogana, si dhe degat e tjera të Qeverisë filluanë të punojnë duke përfituar shuma të mbëdha.



Bollo Poste.

Për veç Doganës dhe Llodërsë e të tjera dega të Qeverrisë që mbushnë arkën e shtetit me napolona por zuri dhe pasta të mbëledhë ca më shumë. Posta bëri një sërë pulla Poste si një vulë të cilat më vonë i ndryshuan tjetër lloji. Nga shkaku se këto pulla nëmëroheshin me një vlerë e me një nevojë të duhur, grahu gjithë bota duke blerë nga 2-3 qint napolona njëriu. Arka e shtetit mbëlodhi një lloji paraje të tuperme shumë.

Ministrat e Qeverrisë të cilët nukë kishin rrogë të cakëtuar, filluanë të marrin nga një rrogë. Shumë pulla Tyrqisht që kishin mbetur në Postë, mbasi ju vunë një vulë me Zhgabë, i shesën në vënt të antikavet të cilat prunë miaft t'ardhura.

Djallëzitë Esadiste

Më të ikur të kryetarit, si dhe më të hapurit e apllokos, filluan mos marrëveshjet midis shqipëtarëvet. Myfit Libohova i cili ishte zv. i kryesisë së Qeverrisë, në vepërimet e anëshme që bënte hidhroi popullin dhe ryri një grindije midis minis-



travet e pupullit. Myfiti më vonë proklamoi Shtetin e Rrethimit dhe kështu solli qetësi.

Kur në një kohë që nga të gjith' anët rrudhë shqipëtarët në Vlorë për të vizituar dhe për të ndihmuar Shtetin e ri ku u plotësua kreit së përdoruri gjuha kombëtare në të gjitha zyrat e qeverrisë ; vetëm Esat Toptani nnkë bedhoi as pak të vijë dhe t'i ndihmojë qeverris e re duke i dhënë tërë fuqin e vet.

Esati, më gjithë që nukë ndihmoi qeverrinë kombëtare por ndënji kondër duke çfaqur dëshirën mbi formimin e njëj tjatër qeverrie. Mbası kërkoi votë besimi nga populli për të njohur si Princ i Shqipëris ku në përgjigjëje mori shumë protestim nga populli, u shtrëngua hëpërhë të heqë dorë. Thuria Beu aherë nga Evropa shkon në Tiranë dhe kuvëndoja një gjat e gjërë më të. Shumë partira bahan dhe shumë ministra e kshillëtarë apën dorëheqëje dhe bëjnë një propagandë të ligë.

Atëherë, populli besnik, i trëmbur nga nonjë trazim thirrë Ismail Qemalë më të çpejtë i cili arriti në Vlorë. Mbası mori frënë e qeverrisë në dorë dhe siguroi qetësinë, hapi shkolla fillore dhe normale,



mori masa të duhura në botimin a gazetës n'ëmën "përlindëja e Shqipërisë", e cilët tregon për herën e parë udhën' e përpajimit.

Esat Pasha për herë të parë, çfaqi dëshirën në përkrahëje të qevetrisë kryetari i së cilës i dërgoi një avullore në Durrës dhe ardhı në Vlorë ku mori punë si Ministër i brendëshmër dhe më pastaj si gjeneral i përgjithëshmë i Shqipërisë. Mbasi i pranoi me gëzim duke i u dhënë fjalën e besës që dotë punëjë me besnikëri, nukë kishin shkuar shumë ditë, merr leje dhe shkoi n'Evropë duke qënë i bashkuar dhe me Syrja bejnë. Myfit Libohova, Ministr' i jashtmë mbeti zëvëndës në këmbë të Esatit.

Duke vënë për shkak se kryetar' i qeverrisë jep urdhër pa mos e pyetur, Myfit Libohova dha dorëheqëjen. Populli shkon te Myfiti dhe i pyesën shkakun e zemërimit që mori. Mbasi nukë kish nonjë arrësyë, u shtrëngua të marrë prapë dorëheqëjen dhe filloi në punë me pa kënaqësi i cili u tregua sheshazi një kundrështar i bashkamit dhe një antar i Esatit.

Esati si një Ministër i Shqipërisë, mbasi shëtiti shumë shtëte dhe kryeqytete si në



Romë dhe Wien ku bëri marrëveshëje; u kthye prapë në Vlorë.

Mbasi bisëdoi mboshehtazi me Myfytin, Mehmet pashën si dhe me axhentat Greke dhe me kushulla shkoi në Tiranë ku gjeti Midhat Frashërin, Dervish benë, Fazlli pashën dhe Faik Konicën e të tjerë. Këta, bënë bisëdime për kondër qeverrisë dhe pasandaj erdhi Esati në Vlorë.

Çlirim i Vizevet nga Sërbia

Austria, i ep një ultimatom prapë Sërbisë në të cilin i thotë të hiqet sa më parë nga vizet Shqipëtarë të cakëtuara nga Konferenca. Serbia deshi t' i kundreshohej, bëhet-s' bënet, u shtrëngua t' i lirrojë vizet e veriut por, jo kreit akoma.

Ushteria Turke në Myzere.

Mbasi kemi thënë më sipër, Xhavit Pasha më ushterin Turke kish pushtuar Beratin, Fierin e gjithë Myzeqenë dhe po i sundon duke ju marrë vergji, të dhjetë e të tjera ndihmëra e nevoja që kish të cilat ja plotësonte populli Shqiptar. Në kohë të fundit i çpallë një luftë ushtërisë



Sërbe që ish në kufi të Fier-Lushnje ku u vranë nga të dy anët.

I ndieri Niazi Resnja, ikën nga ushteria Turke dhe vjen në Vlorë më qëllim për të vatur në Stamboll. Nga të këqiat që ju kish bërë shqipëtarëvet, u vra në mol të Vlorës. Por ushteria Turka kërkoi vrasësit nga Qeverria Shqipëtare. Për t'i bërë ballë grindëjes, shumë shqipëtarë zunë Vojosën dhe ju kundreshtuanë.

Mbasi ushtërisë Turke ju ra një sëmundëje e keqë, iknë me anë të Semanit tërë ushteria e luftës së Veriut nënë kumandë të Xhavitit e Ali Rizait të dyjtë.

Sulmet dhe barbarizmat greke.

Greqia, mbasi e pa që si me aploko ashtu dhe me prapagandë nukë pati së çfarë t'i bente popullit shqiptar, lishoi një trum ushtarë në Vranisht nga fuqia e Kucit. Kundreshtimet e rrepëta që ju bënë nga popullsia e këtij katundi si dhe nga katundët e tjera që u mbelodhë në Urë të Vaut, shtrëngoi ushterinë greke të hiqet me të mirë mbas 24 orësh.

Mbasandaj lajmëron popullsinë e katunëvet të Mesaplikut që t'i binden do e



mosdo. Por mbasi mori përgjigjëje të përkundërtë, filloi të shtrëngojë popullsinë e vizevet që ka pushtuarë si kadri gjolekën, sadullah Tepelenën të cilët çfaqnë uë Qarket Politike duke pranuar sundimin e Greqisë. Botoi shumë libra shqip për t'u dhënë prapagandë shqipëtarëvet duke i kshilluar mbi njësinë e gjuhës e të zakonit. Deshi më pas të pushtonte Bolenën për mbasi trimat e rrepët kombtarë Bolenasit ju kundreshtuanë me luftë ku i vranë shumë ushtarë; u shtëngua të hiqet më të prapë.

Rrezik i Korçës dhe i Gjirokastërsë.

Përpjekjet e Greqisë, arrijtin të trubullojnë menjtimin e Qarkevet politike ku lajmërohet për rrezikun e Korçës. Korça me gjithë që ishte akoma e pushtuar nga greqia por si popull' i Korçës me shumë therori ashtu dhe të gjithë qytetet e tjera protestuanë rreptësisht duke thëne se Korça djep'i Shqipërisë dhe fjeshtë shqipëtarë kurrë nukë do ndahet nga gjiri i Shqipërisë.

Mb'anë tjetër vjën mandata e rrezikut të Girokastërsë me Gjithë qarket e saj.

Për t'i u bërë ballë këtyrej rrezikeve,



për veç protestimevet e tërë popullit shqipëtar por mb'anë tjatër dhe qeverria dërgoi një komision në Evropë në të cilin qenë Myfit Libohova M. i F, Poga M. i D. dhe nga an'e popullit Eqrem syriai, Reuf Fico dhe Thoma P. Më gjithë që Komision'i përmëndur mori fjalë të saktë për sigurimin'e ketyrej vizeve por pa mos u kthyer mirë Komisioni në shqipëri vjen prapë lajmi i rrezikut të vizevet jugore. Hidhrim'i math ndihet në zëmërat e shqipëtarëvet.

Nukë vonuanë gjithë shqipëtorët e brëndësm dhe të jashtësm por ca më shumë Korçarët protestuanë rrëptësisht qarket e politikës po ca më shumë Edvar Grey-t që është kryetar'i konfetencës së Llondrës. Shqipëtarët e Rumenisë, të Misirit, të Rsisë, të Bullgarisë dhe të Amërikës, si nga qytetet dhe nga Katundet, si dhe nga ç'do vënt që ndodheshin Korçarë ipen protestime sa Edvar Grey-t ju bënë pirk duke thënë Korça është palca e shqipëtarizmës, duhet domosdo si Korça ashtu dhe Gjirokastëra t'i mbeten Shqipëris.

Këto të fundit gjanë në muaj të qershorit.



Çpallëj e njëj Qeverrie tiater Shqipëri e Mesme.

Esat Toptani, mbasi plotësoj marrëveshëjet e tij dinake, kish shkuarë me leje në Tiranë më shkak të festimit e Barjamit. Mbasi shkuanë shumë dit pritej të jkthehej në Vlorë, por për kundrazi kësaj dëshire ep një tel në të cilën tregon çfaqazi sjellëjen për kundrazi Qeverrisë. Ky lajmërim si breshëri në mot të qëruar, si shiu në mot të kthjellët çuditi gjithë shqipëtarët ku u kupëtua fort mirë se ay përpiqet të lozë më fatin e Shqipërisë. Kërkimet e tij janë :

1. Të mbëlidhet një kshillë a mbëledhje kombëtare.
2. Esati vëtë më kryetarin'e qeverrisë së bashku të xgjedhën një kabinet a Ministri të re.
3. Ministrat të mos rrinë në Vlorë po të venë në Durrës.

Në këtë kohë Esati ka bërë më vehtë një parti të plotë si dhe popullin e Durrësit më qarket e saj. Ka të gjithë Pashallarët dhe Bejlerët aristokrasër si Myfitin, Azis pashën më të gjithë Virionasit, Syrianë, Bektash Cakramin e të tjerë të cilët janë



në programë të kundërtë me Qeverinë me qëllim të sjellës përçarëje dhe grindëje midis popullit që të çkatërrojnë bashkimin e shënjtë në një kohë kur'e lypte nevoja e shpëtimit të Shqipëris, fercimin e atij bashkimi nënë një Qeverri si ajo e Vlorës e cila kish treguarë vepra të gjalla patriotike.

Më e para dhe më e madhija klikë e tmeruar e organizuar, prej armiqëve dhe prej njerësve me mejtim antipatriotik e cila për të parën herë nxin faqen e Historisë kombëtare. Vënëja në vepërim të kësaj klike e të kësaj programe antipatriotike hidhroi tepër shqipëtarët kombëtar dhe gëzoi armiqëtë e Shqipëris si Zografon e Greqisë ashtu dhe Sérbinë e Italinë.

Populli i Vlorës, Berotit, Lushnjë, Skrapar dhe i Elbasanit duk' kupëtuar mirëdëmin q'i ka për të prurë Atdheut çپallëj e kësaj klike, protestuanë rreptësishtë. duk' e i u thënë si Esatit e të gjitha vizëve shqipëtare ashtu dhe Evropës. "Poshtë klika e Durrësit e e Tiranës, poshtë Esati dhe partizanët e tij të cilët nukë përfaqësojnë as pakë popullin shqipëtar dhe idenë kombëtare.,,

Bektash Cakrani, si një kundreshtar i



rreptë i qëverris duke ndërruar karakterin e tij kombëtar, filloi të bëjë metinge në Mallakastër e të luftoje më fuqin' e qeverisë.

Mbasi e kshilloi Qeverria që të hëqë dorë dhe kyj për knndrazi kërkon rënëjen e Ministrisë; Qereria i dërgon një fuqi në Cakranë dhe mb'anë tjatër e kshilloi akoma me anë të Veli Këlcyrés. Por ay duk' e pandehur se ka Mallakastrën më vete, vazhdoi kuudrështimet më luftë. Një patriot i mirë mjërisht për ca egoizma personale gaboi. Ashtu mallakastriotë patriótër nuk' e shoqëruan, fuqia e Qeverrisë ryri në Cakran ku i vunë zjarrin tregut.

Këtë kohë Etati lajmëren Qeverrinë duk' e thenë se hoqa dorë nga kërkimet tash për tash. Mirë po kush' e beson, Ujkut në i bie qimia lëkurën e ka më vënt. Bektaši me Dervish benë mbëledhën fuqi n' Elbasan më qëllim të vijnë mbi Qeverrinë. Qeverria dërgon një fuqi të madhe në Lushnjë dhe ju kundreshton në anë të Shkumbinit. Partizanët e Esatit filluanë me propagandë dhe me të holla të kthejnë fuqi, ca më shumë të bëjmë Elbasanin më vete. Por Aqif Pasha, besniku ma i math i përlindëjes kombëtare ju kundrështon.



Pas situatës e sotme, këjo klikë gjën më shumë ndihmën dhe përkrahëjen e duhur nga fqinjët t'anë. Dhe populli u përçë, ca donin Greqinë se është e vogël dhe shpëtojmë çpejt, ca kërkonin Austrinë se është e mirë dhe ca të tjerë donin Italinë se është afër. Por fuqia kombëtare dhe idea nationale përpinqet me tëre fuqin' e vet, me therori e me sakrificë duke u bazuar që Shqipëria te rrojë më vete.

Sërbia ndihmon Esatin, Sulmon në Shqipëri.

Më shumë nga Greqia në jugë filloi dhe ajo në Veri duke vrarë, vartur, duke ju prerë rrugën që të mos venë në Trek Shqipëtrët të blejnë drithë. Shqipëtarët duke mos'i duruar dot këto ligjësi vendosnë të bëjnë luftë dhe të vdesën ma mirë burrisht. Në luftimet e rrepëta që bën muarrë Dibrën e madhe, Strugën dhe Ohrin dhe po i afrohen Resnjës e Manastirit. Sërbia mbëleth ushtarë të tjerë dhe me trathëti të disa partizanëvet Esadistë e morri prapë Dibrën e tej, duke vazhduarë së rish në thëreje të fëmijeve Shqipëtarë ca nga të cilët u shtrënguanë të lënë vatrat e tyrej duke ardhë n' Elbasan.



Më nje herë Austria e famëshme më politikën e naltë të saj si kurdoherë i dha ultimatom Sërbisë duk'ë i kërkuar lishimin e vizeve Shqipëtare.

Prapë vendim i Konferencës

Me gjithë që në Shqipëri janë duk' e gjarë klika dhe mosmarrëveshje të brëndeshme si dhe ndërhyrje të jashtësme nga fqinjët t'anë, por mbasi kemi thënë më parë pozita më shumë rëndësi që ka Shqipëria në Ballkan, i shtrëngon fuqitë e mbëdha të cilët më 11 Gusht 1913 ju dhanë funt kufivet e Jugës në pikat e përgjithëshme. Por mjerisht, e lanë punën trubulluar dhe plagët të hapëta.

Vendimi i tyrej: Sazani me gjithë vizet e anës së detit deri në Stillo me gjithë malet e anës, i mbenë Shqipëris si dhë Korça me gjithë kazan' e vjetër. Vija e kufisë të jet Korça — Stillo dhe gjithë vëndi tjatër të kqyret me anë të njëj komisioni i cili ka për të shënuar kufin mbi pikat e veçanta duk'e u bazuar në atnografi e gjeografi d. m. th. q' do vënt që flat shqipe, që ka shënjat etnike të kombit e vetë t' i mbetet Shqipëris të cilët do



kenë për themel gjuhën e gravet dhe të fëmijëvet. Me shkak që vizet jugore gjenden nën pushtimin Arbitrar të Greqisë e cila do përpinqet të ngatérrojë gjuhën si dhe shënjat etnike, është frikë në pikat e veçanta të kufirit Gjirokastër, Delvinë, Konicë, Përmet, Leskovik dhe Kolonjë.

Vendosnë akoma që Shqipëria të rronjë indipendente, të ketë një Princ Evropian, të jetë dhinastia trashëgimtare, për dhjetë vjet do jetë një komision për të kontrolluar gjithë punërat e shtetit, Princi i cili do shënohet nga fuqitë e mbëdha dhe do pëlqehet nga shqipëtarët, do vejë në Shqipëri pas 6 muajet që nga dit' e fundit të konferencës, të dërgonën për organizatorë hollandezë, komision i jugës të nisë punë pas një muaji e të ketë mbaruar pas tre muaj, t' i komunikohet Greqisë që pas njëi muai të hiqet prej vizevet shqipëtare.

Këto vendosi konferenca për së fundi herë dhe u përndar.

Në këto kohëra, Hota dhe Gruda të cilat n'denuau që t'i mbeten Malit Zi; trimërisht burra dhe gra lëftojnë sa Mal' i Zi s' që i Zoti t'i pushtojë dhe ashtu mbenë të bashkuar me mëmën e tyrej të dashur.



Komision i kufivet Jugore.

Komision'i kufivet të Jugës më 6 të vjetës shtës Irë 1913 ardhı në Brindis dhe s'andejmi n'Athinë Selonik, Manastir dhe u sos në Korçë ku panë shumë gjérëra të bëra prej disa Grekomanëve të cilët, gra dha burra më armë në dorë të veshur me rroba në mënyrë Greke duke dashur të tregojnë Korçën si me gjuhë ashtu me shënja etnike të Greqisë. Ca me dashëje e ca të frikuar nga bajoneta Greke muarr pjesë në këtë seremoni antipatriotike. Be tohen njeri me tjatërin se do derdhënë gjak në qoftë se Korça nuk'i mbetet Greqisë, por fatbardhësisht këto seremoni ishin si vesa përparrë diellit ndaj patriotizmës e Korçarëvet.

Komisioni u ndoth në Korçë më 18 të vjeshtës e Irë dhe që andej vate n'Ersek ku gjau dhe atje si në Korçë. Sado që klika Greke nukë la mënyrë pa përdorur me anë të disa Grekomanëvet por Komisioni i sheh gjithë këto pa udhësi që është duke bërë Greku. Vanë në Leskoviq, prapë këto.

Ndalimet e bëra në këtë mënyrë, tregonin se përfundim'i punës duaj xgjatej miaft.



Me gjithë atë vazhduanë duke vatur në Kolonjë të madhe, Në fshatin Porovë u duall Grekërit t'armatosur përpëra dhe po i ndalojnë duke ju thënë: nevez jemi Grekër, duam këto vënde t'i mbeten Greqisë. Komisioni pa prishur farej fytyrën u fut në fshat ku gjenë një shtëpi në të cilën ishin mbyllur pleq, plaka, djem dhe çupa, gra e burra që s'dinin gjuhë tjeter jër veç Shqip. Të mjerët i shtrëngojnë duke ju mbësuar Greqisht. Më të nesëret gjenë një tok cilimiqër të cilëvet ju kishin mbësuarë të flasën nga pak Greqisht. Komisioni i provoi duk'e dërdhur të holla përpëra vetiut të cilët mbasi u trazuan njëri mbas tjetërit për të mbëledhur kush më shumë të hollat, harruanë ç'ju kishin porësitur dhe filluanë të kuvëndoja Shqip.

Delegat' i Francës u hidhrau por, ay i Austrisë i cili dij shqip dhe ish mik'i së drejtës vepron te siç duhej. Kyj jmik'i së ndrejtës, i famëshmi Behliçi pa mos mbaruarë puna fatkeqësisht vdiq, por dhe në minutën e fundit të shpirtit godit një rapor për punë të kufisë Jugore dhe e dërgon n'Austri. Behliçi dij Shqip dhe kudo që vinte Komisioni kyj gjëndej i parë duk'e folur Shqip e duk'e ju thënë: flisni



Shqip, mos trëmbi se kini mua, rroftë Shqipëria e tej. Shqipëtarët i duaj shumë për të cilët sakrifikonte më të mbëdhatë mundime e shërbime. Mbas vdekëjes e Behliçit, Greqia gjeti shesh të gjerë të trazoië opinionin e Komisionit. Austria u protestua. Delegat'i Anglisë me anë të Qeverrisë së tij gjeti një mënyrë në përfundimin e çpejtë të kufirit duk'e bërë një proponim Inglitera e cila shënonte vijën e kufisë Jugore. Si u pranua kyj proponim nisen Delegatët dhe venë në Florancë, n'akademinë Xheografike ku i dhanë funtpunës më 17 shënëndre 1913 dhe u përndanë.

Kufitë janë këto : Që nga Korça në mest uravet, delt' n'anë të Adriatikut, në Stillëku përmblodhë këto qytete të Toskërisë. Korçë, Kolonjë, Leskoviq, Përmet, Gjirokastër, Delvinë dhe Sarëndë.

Sëdo që Konferenca i dha një notë Greqisë për t'i a dorëzuar vizet Jugorë Shqipërisë por Inglitera më pastaj kërkon një muaj afat që të hiqet Greku nga Vizet dnk'shënuar dhe ca pikë për nisitë që t'i përgjigjet Aleancës. Aleanca për vijën e kufivet i u përgjeq shpejt por në shënimin e pikavet për nisitë kërkoi kohë dhe



kështu vonoi puna për të zbrazurit e vizevet nga Greqia e cila gjeti kohë të gjat' e të gjërë mbi përfundimin e masavet dinake, dhelpërit' e organizuara të filluara që nga shumë kohë n'Epir.

Banga ndërkombëtare

Qeverria e përkohëshme, mbas shumë bisedimevet q'u bënë në kabinet vendosi prurëjen e njëj bangë Austro-ital. në Shqipëri. Kontratua q'u bë më 19 të Vjeshtës e II 1913 u firmua prej Qeverrisë me kondita të dobishme dhe ashtu u çel banga në Vlerë. Shumë njërës nga ata që s'dinë mirë çështejn, të bashkuar me ata që s' kishin besim te Qeverria kundrështuan rreptësisht. Aqë u mbadhua çështja sa i epet një memorandum Qeverrisë me 15 nene-shkrime me anë të se cilit i heqën vrejtëjen Qeverrisë. Kabineti çfaqi se këjo bange është prure me kondita të dobishme.

Kontrollorët

Si mbas vendimit e konferencës për të cilën kemi dhenë çkoqitëje të duhura më lart; përfaqësonjësit e të 6 fuqivet e mbë-



dha, më 21 të Vjeshtës e II 1913 arrijtin ne Vlorë. Më parë erdhì i Iingliterës dhe më pastaj të tjérët të cilët u prinë me nderime të mbëdha. Të parën mbëledheje e bënë në Bashki më 29 të këtij muaji. Që nga kejo ditë filluanë të mbëlidhen rregullisht duke kqyrur punërat e shkuara dhe të ardhura të Shqipërisë. Si kush do ng'ata mori një degë dhe po e vështrojnë së largut vazhdimin e vepërimevet si dhe të llogarivet e Qeverrisë.

Po të kishin nevojë për nonjë pyeteje shkruanin te kryetari, ose bënин marrëveshëje verbale.

Një shumicë shqipëtarë, me flamurë në dorë shkuanë në shtëpira të tyrej për t' i u thënë mirseardhëjen. Kontrallor i Francës tha: Evropa ju njahu me vehte, por duhet të jini aqë të zotë duke i vënë karrucës kuaj të fortë, te dijtur e të stërvitur që t' a heqën rrugës e ndrejtë. Së po u shtëmënk karruca nga udha, do të thyhet kreit.

Kontrollorët zgjodhë Z. Myfit Libohovën si kontrollor' i Shqipërisë.



Hollandezët

Mbasi kemi thënë më lart, organizatorët e gjindarmërisë nga Hollanda Z. Z. Tomson, Deveri arrijtën ne Vlorë dhe sa më parë filluanë në punën që kishin marrë për sipër. Për ca ditë erdhë dhe të tjerë hollandezë.

Gjindarmeria, pakë shnmë që e rregulluar më parë ku Qeverria i kish veshur, mbathur dhe stërvitur si këmbësinë ashtu dhe kalorinë më një shkallë sa të gjëzonte zëmëra kur shkonin trumat si ushtëri gjermane. Si ç' do trumë kish emërin e atij qyteti që duaj t'a mirr në dorëzim. Me ardhëje të hollandezëvet natyrisht për veç që u pa një diferencë e madhe në gjindarmëri por akoma përparoi dhe populli nga kshillimet dhe ligjëratat atnore që bënin pa farë kurcimi.

Bashkim' i Shkodrësë

Mbas ardhëjes e kontrollorëvet në Shqipëri, komisioni ndërkombëtar që ishte në Shkodrë dha leje që dhe Shkodra të bashkohet me Shqipërinë duke emëruar nëpunës n' atë vënt dhe duke marrë pjesë në organizim.



Shkodrianët, Patriotët dhe Idealistët të vërtetë të cilët ishin marrë vesh dhe më parë me Qeverrinë Kombëtare të Vlorës ku Kryetar'i së cilës kish dërguarë dy herë njërs me qëllim të lidhë e të plotësojë marreveshejet; formuanë Qeverrimin dhe bashkimin me Shqipërinë.

Shkodra me qarket e saj vunë Kryeprefekt të ndierin i cili ish dhe Kumandant i ushtëris Angleze që gjëndej atje. Shkodra në këto kohëra përmbarati një qetësi, godi, zhvillim të math sa mbretëron një gëzim, bashkim e vëllazëri e madhe.

Shqipëri e mesme.

I madhi tradhëtor Esat Toptani, mbasi bëri më vete një parti të plotë prej Shqipëtarëvet, duk'e përfituar nga ndryshim i situatës së kohës prej fqinjëvet dashëkeqër t'anët të cilët i dhanë sigurim e kuxim të plotë që të vëré në veprim plllanet e tyrej; bënë mëtinge më ç'de qytet kondër Qeverrisë dhe flamurit kombëtar. Thirri pleqësitë e vendit antipatriotër dhe formoi Qeverinë e thënur Sénato d. Shqipëri e mesme me pleqësi prej partizanëvet e tij e cil-



la do të sundojë Durrësin me qarket e saj d'eri sa të vinte Princ' i Shqipërisë, si kryetar'i pleqësisë është vetë Esati.

Mbasi diqiaroi jashtë dhe brënda Shqipërisë, lajmëron Kontrollorët në Vlorë duk' e iu thënë "u mbëlodhë pleqësia të përbërë prej popullit dhe formuan një Qeverri pleqësore në Shqipërinë e mesme, unë patafatin të jem një kryetar i pleqësisë, Për këto vende që do të rregullojmë, do të japojmë llogari kur të vijë Princi. Ju lutem të me keni në sy e të më ndihmoni.."

Kyj mejtim e veprim i poshtërm nga ujku plak hidhroi gjithë popullin Shqipëtar.

Kontrollorët i u përgjegjnë kështu : Nevenukë munt të njohëm tjatër Qeverri përveç Qeverrisë e Vlorës nga që nukë kemi urdhër!

Frik'e fuqisë që kish në Tiranë Shtrëngoi Qeverrinë Kombëtare të dërgojë fuqi në Lushnjë. Një plagë e tretë në trup të Shqipërisë prej dorës e Esatit ku përsëfundi herë po maqiliset dhe nukë munt të gjëjë shërim. Këjo trathëti e pru Shqipërinë më një shkallë fort të ligë sa të sundohet më shumë Qeverri. Qeverria kombëtare e Vlorës, e Tiranës, Qerëria enter-



nacionale e Shkodrës, mb'anë tjatër vizet Jugore nënë Greqinë dhe vizet e Veriut nënë Sërbinë. Fundi i fjalës Shqipëria sot gjëndet nënë 5 lloj Qeverrish.

Në një kohë kur interes i shenjtë kombëtar kshillon pa tjatër nevojën e bashkimit për t'i arritur përparimit dhe shpëtimit e vëllazërevet t'anë që ç'nderohen nënë armiqtë shekullorë, fatkeqësisht për kundrazi gjajnë grindëje, çfaqen perçarëje midis Shqipëtarevet ku mbetet shpresa e shpëtimit në dyshim. Vallë si do t'i vejë puna dhe gjallërim e shpëtim'i njeit popullit, kurr pa mos cakëtuar kufitë, pa mos njohur dhe formuar mirë Qeverri' e vetë të gjëndet përpara kaqë trubullimevet!

Qeverria kombetare sundon vetëm Vlorën, Beratin dhe Elbasanin; Durrësi me qarket. e saj sundohet prej Esatit.

Nga të tilla grindëje dhe përçarëje fatkeqe u shtrëngua kryetar i Qeverrisë i cili më 23 të vjeshtës e II. 1913 mbëlodhi pleqësin'e katundeve dhe mbajti një fjalë mbi perçarëjet e kohës e mbi kantone e tej: Më në funt foli dhe mbi çashtëjen, e bangës kombëtare se populli ka marrë vesh likështë dhe ish dëshpëruar. Ju tha popullit “thoi kush është i lik, në jam unë i lik m'a thoi në sy t'u për-



gjigjem, m'a thoi në sy dhe të hiqem e të mërgohem nga puna.,,

Ca kundrështarë i thanë: Pse apën dorë heqëjen Ministrat njëri pas tjatërit? Kryetari i u përgjeq: Burri se ç'kuvëndon me gruanë nukë i tregon dot jashtë. Po në ka njeri nga ata që janë hequr nga puna, të dal'e të thotë përpëra popullit se cili ashtë kundreshtim i tyrej!

Me të vërtetë Qemali kish shumë të ndrejtë se kundreshtimet q'i bëheshin nukë ishin fare gjë tjetër për veç çështëj'e kryesisë e të fronit të cilët ishin lidhur me armiqtë që të sjellën ngatërrime në Shqipëri.

Kështu nukë dolli njeri nga kundiështarët që t' i përgjigjej: Më në funt vendosnë që të shkruajnë të vijë mbreti sa më parë në Shqipëri. Mbajti parësinë e katundevet në qëndër më shumë se një javë dhe nukë mundi të çfaqë përfundimin e qëllimit.

Nga ministrat Mehmet Pashai mbasi mori hua 200 napolona nga arka, shkoi në Durrës, dita ditës, një nga një shqipëtarët venë në Durrës, Bashkim'i shqipëtarëvet sa vjen e përcahet.



Mbret' i Shqipërisë

Konferenca e Llondrës, qarket politike shumë gjatë bisëduan për të shënuar mbretin e Shqipërisë, por akoma nukë munt të mbetishnë në një fjalë. Shumë princër çfajnë dëshirën, të gjitha mbretëritë donin të dërgoni princër të tyrej por Gjermanisë e fortë i shkoi ca më tepër fjala dhe ashtu Anglia, Franca dhe Italia fare të pa kënaqura u shtrënguanë të vënë firmat e tyrej mbas insistimit Gjerman.

Ky vëndim u lajmërua zyrtarish në Shqipëri ku u prit me gëzim të math emërim i të madhit Vilhelm D. Vjed nga fëmija e madhe e Gjermanisë. Shqipëtari natyrisht e priti me gëzim duke pëlqyer më ç' do vënt të Shqipërisë.

Vid Vilhelmi burrë i ri, trim, zbret ndrejt për ndrejt prej brezit të Vilhelmit të Oranisë, i madhi njeri i urtë; stërnip i Frederik Vilhelmit të III edhe i mbretëreshës Luisa, mbesë i të madhit Perandor Vilhelm i cili është dhe kumbaraja e tij, Shtëpia e tij prindore n'a ka dëftuar një sërë burrash të shënuar.

Mbretëresha e Shqipërisë, shoqëja e tij Sofia, grua e re, e mënçmë fort, i kanë



lindur dy foshnjë të hiëshmë, një bijë Maria Leonora, edhe jo prej shumë kohë, një djalë Karl Viktor. E gjyshija e saj prej fisit Rumune, ka dhe një fytyrë e cila të dëftën se është prej njëi vendi jugor.

Klika e Beqirit

Zhon tyrqërit, me gjithë që u ndanë dhë u mërguanë miaft lark nga Shqipëria por nukë duan të heqën dorë duk' e dëshëruar dhë ata ca më shumë nga fqinjët t'anë e duk' e radhitur prapagandistët njëri pas tjatërit. Zenel Ipek, Zia Gjakova nisen nga Stambolli dhë arrijnë në Shkodër, të cilët të përkrahur nga Esati guxojnë të bëjnë prapaganda në popull për kondër shënjavet kombëtare.

Më pastaj erdhë në Durrës, Tiranë, Shijak dhë Kavajë ku gjenë dhe te tjere shokë të cilët hapijn sheshazi duk' e përpjekur kondër mvehtësisë dhe mbretit e Shqipëris.

Një e tillë prapagandë për të prurë në Shqipëri një mbret Muhamadan munt t'a shtjëre Shqipërinë në një rrëzik të math me që vendim' i fuqiver të mbëdha ish një bazë të njëi Princit Evropian, se ndryshe Shqipëria nuk' duaj kish gjikundi



kumbismë n' Evropë dhe përveç asaj duaj shih ma të mbëdhatë kundreshtime nga të gjith' anët.

Prandaj sì Qeverria ashtu dhe kontrollorët nuk' i linin të çpenguarë, nuk' u shpëtonin nga syri këto ngjarëje të cilat ishin krejt kondër mejtimit t' Evropës, ishin marrë të gjitha masat e nevojshme per t' a farosur këtë lëvizije në kohë kur krerët e kesaj klike do të kujtonin se e mbaruanë qëllimin e tyrej.

Por edhe trazimtarët e thënë ndiq kuptuanë thellë nga këto masa dhe kujtuanë se e tërë puna do t' u vejë kot duk' e u a lidhur duart' e këmbët me nonjë farë mënyre qeverritare. Kujtuanë se për këtë punë kurrë do të mos gjëjnë rrast ma të mirë se tani kur në Vlorë jan duk' e shkruar Zhandërma të rij gjith' ata që dëshëronin. Nuk' e dijtin mirë se Shqipëtarët që merren me rregullimin e të tillë çështëjet janë nga ata që nukë munt t' i shtyjnë dot n' udhë të shtrëmbër.

Një farë Beqir agai nga Grebenea, Oficer Tyrk i cili qënka dhe ky një nga më të mbëdhijt' e kesaj klike. Ky farë njeriu, më parë paska ardhur në Durrës ku mbasi u kskillua me Esatin ka ardhë në Vlorë.

Si mori pakë sheshin këjo çështëje dhë



u sigurua mirë qënëj' e këti komplloti i cili përpinqet më të gjith' anë të vërë në praktikë qëllimin e vetë, Qeverria bëri përgatitëje të duhura duk' e u marrë vesh me kontrollarët për mbi gjithë këto gjarëje dhe më një kupëtim më 24 Shënendre 1913 ditën e martë ora më 7 mbrëmanet kryetar' i Qeverrisë me shtërngimin e Komisionit ndërkombëtar të kontrollit proklamoi Shtetin e rrethimit si një ngamasat e domosdoshme për t' u bërë ballë punëvet që munt të ngjajnë.

Mb' anë tjatër Major Tomsoni bashk me Kolonel Deverin e muarr në dorë organizimin e sigurimin e vëndit me energji të jashtëzakonëshme duk' e bërë gati masat ushtërore. Kështu kurrë nuk' ishin parë nonjë herë kaqë xhandarë në Sqelë të cilët po ven' e vinë, ndajnë fishekë si dhe bënin përgatitëje të tjera.

Ditën e përmëndui më pasdreke dërgohet një fuqi në mol ku presën me kujdesi. Qeverria dhe kontrollorët kishin marrë me kohë lajmim e mbëshëhur të nisëjes nga Stambolli për në Shqipëri një vapor me 300 veta.

Ora më 4 të natës a. f. kur në mol asnjëri po thua për veç policiës nukë gjën-



dët, zakonërisht u afrua vapori "Marna", i Lloitit. Tomsoni me një fuqi kombëtarë vate në vaporr. Kupëtohet se u ish dhënë urdhën që ditën të dy tropidovet e luftës të cilal ju qasrë për aqë dhe gati t'a ndalonin n'ish se duaj t'ikën

Në vaporr ishin 500 Tyrqër, 200 Shqipëtarë skllevër të zënë në luftën e Ballkanit, në mest të Tyrqvet kish Ianinjot, gjashtë oficerë nga Stambolli, Anaselishti Kalaraja dhe nga Grebenea ku u xbrinë nga vapori dhe u gjenë kobure gjashtare, 14 mijë f. një bangonatë, fishekë bum-bum dhe shumë kartëra të enteresacme. Këta janë shokët e Beqir agait i cili dy ditë më parë kish shkuar në Itali. Mejtim'i këtyrej thuhet se ish të proklamojnë Izet Pashanë mbret në Shqipëri dhe Shqipërinë nënë Sulltanë.

Ditën e mërkurë, vjen Beqir Agai më vaporr në Vlorë kur pelica kish nevojë për të. U formua gjyqi ushtëriak nënë-kryesinë e Dëvërit ku u burgosnë dhe shumë shqipëtar të tjerë nga të cilët shumë u dënuan për vdekëje. U pa e nevojshme dhe thirrëj e kryetarit'se Qeverrisë për të dhënë çkoqitëje në gjyq me që ay si kur paska qënë i ditur më parë në këtë çështëje,



por ay si një kryetar'i Qeverrisë miaftoi puna vetëm me dhënëjen e çkoqitëievët përpëra kontrollorëvet.

Marrëveshëja e Shkodrës.

Si mbas nisiativës e idealizmës e shënjtë patriotike t'ati qyteti të famëshm të cilët nuk'u tundë as pakë nga vazhdimi në bazë të kombësisë duk'e mos mundur t'i bindën dot propagandat antipatriotike midis të dy besimvet, e duk'e mos mundur dot t'i çajnë shkodërianët nga Qeverria e Vlorës kombëtar; më sëfundi herë u bë një mbëledhëje e përgjithëshme e për të bashkuar mendimin e kujdo vëndi. Në këtë mbëledhëje muarrë pjessë tërë krahinat duk'e. dërguar përfaqësonjës të tyrej. Nga Toskëria shënohen prej Qeverrisë së Vlorës Z.Z. Elmas Kanina, Ali Kreshpa dhe Ramis Gjirokastëra të cilët udhëtuanë dy herë.

Fugia Kombëtare për të marrë në dorëzim vizet Jugore

Qeverria Shqipëtare mbasi i stërviti shumë mirë trumat e shuma të Gjendar-mërisë i kish nisur më parë për të marrë në dorëzim viset Jugore nga Greqia. Fugja e përmëndur e armatosur mirë me topa,



mitraloza kishin vatur si kushdo mb' anë të saj në kufi të vizevet Korçë, Tepelenë, Gjirokastër, Himarë e tij. Fuqia q' u nis për në Korçë pa mos ryrë n' Elbasan bie në yshje të fuqisë Esadiste e cila pat zënë vënt më parë dhe i celën luftë fuqisë kombëtare. Sado që fuqia kombëtare i u lutet t' i lënë të shkojnë sa më parë në detyrë të shënjtë por ata nukë dëgjojnë dhe vazhdojnë përpjekëjet e tyrej kondër programit e dëshirës kombëtare.

Prefekt i Elbasanit i famëshmi Aqif Pasha lajmëroi me rëndesi kontrollorët mbi mejtimin e lik t' Esatit i cili shërbën për të huaj dhe për mos marrëjen e vizevet nga Greqia.

Esati u kupëtua mirë dhe nga kontrollorët që vepron kondër mejtimit dhe ide-lit patriotik Shqipëtar si dhe me vepime kondër mejtimit dhe vendimit t' Evropës, u lajmërua prej tyrej të heqë dorë nga të tillë vepra antipatriotike.

Me gjithë që kontrollorët ishin rresponsabl mbi çdo gjë që munt të gjante në Shqipëri por dhe ata nukë punonin të gjithë me ndreq për shpëtimin e Shqipërisë e cila ish dorëzuarë në duar, në mshirë dhe në ndrejtësin' e tyrej.



Më një anë sheshazi ndalime e kundreshitime nga Esati dhe mb' anë tjatër sulmi i ushtërisë Greke në Bolënë — 60 km. lark nga Vlora — të cilët në vënt që t'i lëshojnë vizet, kërkojnë të marrën akoma një kohë kur përfaqësonjësit e fuqivet të mbëdha, gjënden në krye të qeverrisë shqipëtare; pa dyshim t'ep të kupëtosh se kontrollorët vetë ata janë duk's lozur rrolin më të math si mbas interesës dhe ndryshimit politik të mbretërit e tyrej.

Nukë dua të shkoj pa mos treguar trimërinë e famëshme kombëtare të patriotëvet Bolenas q'i u kundreshtuan duk' e i sjellur më të mbëdhatë deme ushtërisë Greke të cilët më pastaj u thyenë kreit.

Enteresa e fuqivet miqësore të Shqipërisë i shtrëngoi bashkërisht fuqit' e mbëdha duk' e i dhëlë një notë të fundit Greqisë në të cilën i thonë të fillojë që nga ballët e Marsit e deri në funt të këtij muai të jenë kreit të zbrazura vizet Jugore të Shqipërisë.

Për të siguruar popullin e vizevet Jugore që do të lirohen ng' armiku, kontrollorët bënë një zëdhënëje mbi 4 gjuhëra të cilat u varrë në çdo qytet ashtu dhe Hollandezët muarrë masat e duhura me çpallëje të veçantë.



Përfaqësonjësit e Shtetevet të mbëdhatë cilët kanë marrë për sipër krijimin e Shtetit Shqipëtar, çfajnë me anë të thirrëjëvet që qo të shkruhen më poshtë Atdhetarisë dhe gjukimit e ndrejtë të njërzisë e vizevet që do të lëshohen nga ushtarët Grekër me shkak që prapagandat e armiqëvet po i ftohën të krishterët e atyrej vizevet duk' e i lënë në dyshim që Ad. e Qev. Shqipëtare do të vazhdojë në një mënyrë ku do të shtypë shumica pakicën.

Të krishterët e atyre vizevet nukë duan të japën besimin e plotë organit Shqipëtar i cili formohet në një mënyrë kombëtar në krye të sëcilit nukë janë as Tyrqërit e Stambollit, as Grekërit e Athinës ku prapagandat e sëcilëvet janë duk' e humbur fatin' e kombit t' onë por e dinë fort mirë që Shqipëria ka në krye një Princ Evropian, i shënuar prej fuqivet e mbëdha.

Me gjith' atë nukë dimë të kenë as pakë një shkak t' arrësyshmë në mos besimin e organit e në vazhdimin e trathëtivët në një kohë kurr për të vendosur, siguruar fatin, jetën, enteresën dhe pasurinë e kujdo nënështetasi kanë vendosur për një periudë vjetesh të gjatë një komision ndërkombëtar të kontrollit në mes të secilës gjëndet.



vetëm një Delegat Shqipëtar. Princi dhe Komisioni kanë për barrë të vendosën një Administratë që t'u përgjigjet të gjitha nevojavet e vendit duk' e mbajtur përpara sysht dëshirat e ndrejta të kombit pas Idës së nazionale të vërtetë Shqipëtare.

THIRRËJE

Komisioni ndërkombëtar i kontrollit që përfaqëson qeverritë e mbëdha të cilat kanë marrë në dorë krijimin e Shtetit Shqipëtar i sillt me këtë thirrëje atdhatarisë dhe gjykimit e ndrejtë të njërezisë së vizevet që dotë lishonen nga ushtëria grek. Komision' i kontrollit e di mirë që janë përhapur andej e këndej disa çpifëje për të hedhur popullin në dyshim kundrejt Qeverrisë e Shqipërisë e për t' i shtirë frikën që në Administratën e saj do të ketë përsëri fuqi shumica kundër pakicës. Këto shpifëje janë përhapur me dashëjë të ligë e me qëllim të keq. Pse dëshir'e e qeverrive të mbëdha ashtë që të krijojë një Shtet autonom e më vehte që të mundë të rrojë e të përparojë e sidomos të jetë i themelosur mbi parimin e njësisë për të gjithë.



Ky qëllim, munt t' arrihet vetëm me bashkëpunimin e të gjith' elementevet panonjë ndryshim në vënt që armiqësit'e brëndëshme e pa besim i njëri për tjatërin dot' a hedhë në rrëzik.

Në krye të këti Sheti të rì, qeverrit'e mbëdhë kanë vënë një Princ i e xgjedhur prej tyrej edhe ato prapë kanë vendosur për një periudë vjetësh të gjatë komisionë ndërkombëtar të kontrollit në mest të së-cilës gjëndet edhe një Delegat Shqipëtar.

Princi edhe komisioni e kanë për barrë të vendosën nj Ad. që t' u përgjigjet të gjitha nevojavet e vendit duk' e mbajtur përpara sysh dëshirat e ndrejta të kombti shqipëtar.

Firma

*Mysit, Nadolny, Petroviçi, Krajeksi, Sany,
Leoni, Petricef.*

THIRRËJE

Duk' e pasur marrë në dorë kumandën e lartë të gjindarmerisë që po dërgohen në vizet e Jugës, n' a duket pun' e mirë të trëgojmë rregullat e nevojshme pas të cilavet dotë sjellëm në vëndet që dotë pushtojmë. . .

1° Të gjithë njérëzit prej çfarëdo bëse



ë prej çfarëdo kombësie që të jenë,
ë oila do që të jetë gjuha që fla-
sën, kanë të ndrejtë të kenë mbroj-
tëjen t' onë.

- 2º Ashtë rreptësisht e ndaluar që t' u
bëhet e liga më e vogël e njërit-
vet të qetë e që t' u preket gjëja
e nderi i tyrej. Ay që dotë punojë
ndryshë, dotë dënohet ashperisht.
- 3º Ata që dotë guxojnë të qëndrojnë
kundër pushtimit të vizevet e kun-
dër masavet ushtërorë që do të na
duket nevoj të marrëm, dotë nëmë-
rohen si kryengrijtës e dotë gjy-
kohen si të tillë.

Këmi shpresë të plotë se të gjith'
ushtarët që dotë jenë nënë urdhërin
t' onë si edhe ata që dotë veprojnë
bashkë me neve, e kanë në zëmër dëshi-
rën që të veprojnë pas këtyre rregullave
për dashurin' e njërzisë e për të mirën
e enteresavet të Shqipërisë.

Firmuar
Kolonel *Deweer*
Kumandari *Tomson*

Këto masa që muarrë - kontrollorët dhe
hollandëzët per rregullimin e mirësimin e
Shtetit Shqipëtar, i bëri të kënaqur



gjëndjen' t' onë shqipëtare. Mbas këtyre masavet të cilat sigurojnë jetën njirëzore dhe kombëtare të shqipëtarit, kontrollorët, më 8 Shkurt 1914, çpalli vendimin' e prishëjes të qarkut e rrëthimit dhë lanë të lirë gjyqin të kqyrë punërat si mbas zakonit.

Qeverrim' i Shqipërisë dorëzohet në kontrollorë

Kryetar' i Qeverrisë së përkohëshme Z. Ismail Qemal, duk' e parë ndryshimet, përcarëjet dhe trubullimet që gjanë si më parë `ashtu dhe në kohëra të fundit dhe duk' e gjukuar se Shqipëria ndodhet e qarkuar midis shumë rrezikeve, mbas si u mendua gjat' e gjërë mbi rresponsabilitetin që munt të sjellën përfundimet e çështëjavet të tmeruara, vendosi që t'i apë funt punës me një mënyrë të pëlqyer.

Dekllari i kryesinë e së nderçmit Komisionit ndërkombëtar të Kontrollit në të cilën i thosh se: Përpara këtyrej trazimevet, kshill' i ministrisë nukë ka tjetër xgidhëje e tjetër shpëtim për veç; ja dërgimin e një Komseri për të sunduarë gjithë Shqipërinë ng' ana e Lar. M. së tij Mbretit D. Vjed, ja po komisia e Kontro-



llit t'a marrë në dorë qeverrimin e Shqipërisë e të mundë përbashkimin'e vëndit dhe për të bërë përgatitëje pët të pritnr pricin e Shqipërisë.

Komisioni ndërkombëtar i Kontrollit, e çmoi tëpër këtë dekllaratë të kryetarit dhe u dhanë fjalë që në qoftë se dot'a marrën në dorë punën e shtetit të ri, do të punojnë mirë, dot' a rregullojnë bukur, do të përpiken që t'a bashkojnë Shqipërinë në një fuqi e në një Qeverri. Po bashkë me këtë thanë Kontrollorët se nukë munt t'a marrëm për sipër këtë barrë të rëndë pamos pyetur Rigatat.

Në dy javë e sipër, shumë ç'këmbime mendimesh u bënë midis Kontrollorëvet dhe fuqive të mbëdha për këtë punë dhe më së fundi dekllaruanë fuqit'e mbëdha se ishin gati t'a vinin plotësisht në dorë fatin' e Shqipëris.

Kryetar' i Qoverrisë, pasi bëri protokollin me Kontrollorët, ay me gjithë kshillën Ministrlale pa vonim e dhanë fuqinë e tyrej q'i u kish dhënë Kongresi 14 muaj më parë duk'e u falur nderit përfaqësonjësvet e fuqive të mbëdha për mundimin e rrogojlimit që do bënин në Shqipëri.

Mb'anë tjatër Kontrollorët i u lavduran



patriotizmës e njërezve që janë në dorë deri më sot frën'e Qeverrisë, që të rrinë dhe këtu tutje të punojnë bashk' n'e ta.

Teksti protokollit forn uarë midis Qeverrisë e Kontrollor vët ashtë:

- 1º Shqipëria të bashkohej e tërë te një Qeverri e të mos mbësë më vehte as nonjë anë, as nonjë vënt i Shqipërisë
- 2º Ushteria Shqipëtare kur të marië vizet Jugore, të mos përpinqet me fuqinë Greke.
- 3º Po të shkelë këmba e L. M. e tij Princit, të nderçmit Kontrollorë të jenë dorëhequr.

Kryetar' i Qeverrisë pasi mbaroi punë me Kontrollorët, udha falënderëje të fuqive mbësha dhe Prefekturës e Vlorës, Beratit dhe Elbasanit duk'e i u falur nderit popullit dhe nëpunësitet për baahkëpunimin që bënë deri më 22 Janar 1914 e duk'e i porositur që fuqin'e tij i u a dha Komisionit e Kontrollit.

Qark'i Ministrisë sa do që mbetë të bashkëpunojnë me të por u quajtën si Drejtore e jò më si Ministër dhe për mbi këta janë Kontrollorët.



Mërgim i Smail Qemalit nga Shqipria, mint të thuhet sheshazi që në vënt të shpresavet q' ushqenin kundrështarët e tij, për kondrazi gjajtin shumë fatkëqesira; zira, pushtime e katastrofe në kurris të popullit e të Shqipërisë për të cilat u bënë shkak ndreq qëndreq kllasi i quajtur intelektuel të cilët për të siguruar shpresat e veta, u dhanë fuqinë kundrështarëvet të tji, Myfitit si dhe Bibë Dodës, Thuria Beut e ca më tepër Esatit tue pandehur se ky i fundit ishtë dora e fortë dhe e hekutë.

Smail Qemali tue parë këtë gjëndëjë anormale dhe tue menjaur se Esati si mashë e Italisë bëri bashkim me kryetarët e Epirrotvet të lilhur me greqinë nga e cila do të vijnë pemë shumë të hidhura e tue parë se me atë mënyrë janë tue kabërxyer edukatën e politikës, ardhur plot në trathëti, u hoqë tue u-lënë ndërgjegjën kombëtare kundrështaravet të tij.

Ligjet e shtetit që kish bërë Qeverria provizore janë; Ligji Qivil (idarei mylqie) d. m. th. mënyra e Qeverrimit; Ligji i të ndamit të pasunivet administrativist (taksim i idari); Ligji zhuri për krime e tej; Ligji shtojca të dhjetave si dhe të xhelepit; Ligji detyravet të gjandarmarisë e



të Hollandezëvet; Ligji të marririt prapë (istirdai) të dheravet e grabitura nga pasuni e shtetit nga të cilat Ligji i parë ashtë Tirqisht dhe të tjerët janë shqip.

Propagandat e aristokratëvet të cilat trubulluan mjaft opinianin e popullit isnin mbi pranimin e Bangës ndërkombëtare, të ligjit Qivil, të vonuarit e thirrjes të mbretit, cashtëj e Beqir Agait, dhe çashtëja e dokovilit të Vlorës mbasi Qemali deshte t'u a ipite një kumpanie Italo-avustriake. Por qellim i mbsheshët i tyrej ishte sepse tue kënë Qemali në krye të punës ata nuk munt të lozin dot si të donin me fatin e Shqipërisë.

Për veç çashtëjet e sipershënuara të cilat u bënë po thua shkaket kryesore të së ndauunit e tij nga kryesia e Qeverrisë ashtë dhe një tiatër çpifëje e cila ashtë pune kantonizimës mbasi Qeverria provizore në Ligjin Qivil nen 43 ku flet përkhillin e përgjithëshm të Prefekturavet si dhe në disa nene të tjera të këtij ligji i ipite të ndrejtë të plotë kujdo krahinë në të marrurit e çdo masë zhvillimi e ekonomie gjë e cila me gjithë që ishte shumë merituar e favorabl për zhvillim e përmirësim të atdheut t'one por -kundreshtarët



e rritnë këtë çeshtëje si dhe çashtëje të tjera deri sa të bindën njerëzinë e pa dijtur, të pa stërvitur në fushën politike.

Edhe kontrollorët, erdhë pothua në vjë mejtin të cilët ishin tue kshilluar Qemalë të mergehej sepse dhe ata të shtytun prej Qeverivjet të tyrej ushqejnë mejtime të ndryshme për çashtëje të Shqipërisë mëbasit ishte përgatitur lufta e përgjithë shme e tue kene Qemali në krye të punës i cili nuk linte flamurë te binte për dheu ; nukë kishin dot guzim për para Qemalit të lëznin në fushë të politikës lëdrat e tyrej dinake për të varfëruar e sh'kllavëruar Shqipërinë e bekuar.

Qeverria e Kontrollorëvet në Shqipëri.

Pas programit e Kontrollorëvet, ja se si u formua mënyra e Qeverrisë së Shtetit Shqipëtar. Z. Z. Delegatët e fuqive të mbëlha u ndanë më 3 administrime : Administrata e brëndëshme, e Financave dhe e Drejtësisë. Në krye të Ad. e Brëndëshme është Z. Petroviçi Del. i Austrisë dhe Z. Nadalny Del. i Gjermanisë. Në krye të Ad. e Drejtësisë Z. Z. Lonë Del. i Italisë dhe Petrajef Del. i Rúsisë. Në



krye të Ad.. e Financavet Z. Z. Krajevski Del. i Francës dhe Llamy Del. i Angllsë i cili është dhe kryetar'i tanishmë i kshillës së Kontrallorëvet.

Në këtë Komision është dhe Fejzi Ali Zot'i Drejtor'i përgjithëshmë i cili merret me gjithë punët'e Brëndëshme dhe është pa pushim në prekëje. në bashkëpunim me Komision's përgjithëshm e veçanërisht me kterët e sëcilësdo prej atyrej 3 ndarëjevet që shënuam më sipër.

Punët' e Brëndëshme ndahen më 5 Drejtora. Drej. e P. të Brëndëshme, e Financave, e Arrësimit, e Drejtësisë dhe e Postës. Në krye të kujdo nga këto Drejtorira gjëndet nga një Drejtor Shqipëtar. Drej. e P. të Brëndëshme gjëndet gjithë në dorë të Dr. e përgjithshm. Drejtor'i Financavet Çakua, i Arrësimit L. Gurakuqi, i drejtësisë Poga dhe i Postës Lefnozi. Drejtor i përgjithëshmë ka dy sekretarë, njëri për Frëngjisht dhe tjetri për Shqip.

Mësori Kontrollorët muarë fuqinë e Qeverrisë kombëtar dhe goditnë degat e Qeverfisë, gjithë ata sëbashku shkuantë në Durrës për të marrë dhe fuqiuë e Esatit. Proponim i disa herëshm i kontrollorëvet për të dhënë fuqinë atyrej, u rrefuzua nga



Esati. Mbasandaj kontrollorët të zëmëruar u ndanë dhe hipuë në Vaporri për t'ardhë në Vlorë. Në një kohë kur duaj udhëtonte Vaporri, Esati i u dërgon një letrë dhe ashtu pasi u kthyen përsëri në Durrës dhe pasi Esati i u lut që të paktën të lërë një zëvëndës i cili të ketë fuqin e tij dhe ata nukë ja pranuan; mbas shumë mendimesh u shtrëngua të apë fuqinë e vetë në duar të Kontrollorëvet. Kontrollorët, zunë dhe atie të goditën Qeverrimin e vendit duk'ë emruar Drej. të përgjithëshim Azis Virioni si dhe të tierë Shqipëtarë nga ata që kishin përkrahur ca më tepër Esatin në kohë kur ay formoi Qeverri më vete. Qeverria e kontrollorëvet pruri ca më shumë qetësi, zunë tërë të liqtë, të burgosurit qirten n'udhëra e punojnë dhe paguhën havajetet rrënjesh.

Delegatët Shqipëtarë për të marrë mbrenë.

Shumë më parë se t'apë fuqin' e vetë në duar të Kontrollorëvet Qeverria Shqiptare e Vlorës kish telegrafuar Prof. e Vlorës, Berat dhe Elbasan për të xgjedhur Delegatët të cilët do të venë t' i paraqitet në kurorën mbretit dhe ashtu sëbashku



do vijnë në Shqipëri. Si dhei në Tiranë e në të tiera vënde ashtu populli me gëzim kish emëruar Delegatë.

Sado që në Tiranë e në Elbasan shumë njerës ishin të hidhruar me propagandën e Esatit për të kërkuar një mbret muhametan por vulnet i pa tundur i popullit me ndienja patriotike t' atyrej vëndevet si dhe ca më tepër masat e mira që mori i Shkëlqyeri Aqif pashai: kështu me dëshirë të popullit mori funt pun e xgjedhëjes të Delegatëvet.

Mbasi kontrollorët muarrë ndreq për ndreq frën' e Shqipërisë në dorë edhe ata ca më shumë e shtrënguanë punën nga frika e nonjëj gjarëje duk' e dhënë urdhërin e çpejtë në vizet Shqipëtare më 23 Janar 1914 për ardhëjen e Delegatëvet.

Situatat e kohës që rrjedhën e ndryshojnë gjithënjë midis fuqivet e mbëdhështërnguanë ca ma parë të shkelë këmb' e L. m. e tij mbretit në Shqipëri në një kohë kur kusiitë, vizet Jugore nukë janë liruar akoma nga Greqia dhe kur vizet veriore nukë janë venë në pikatë veçanta e sidomos ardhëje e mbretit pa një fuqi ushtërore Evropianë e cilë munt t' i bëjë ballë kësaj gjëndëje të tmeruar; shumë pakë



sollë një dyshim. Por si do që të jetë puna ardhëja sa më parë e mbretit udhëheqës në fronin e lartë të Shqipërisë, sëbashku me vulnetin e popullit ka për t' i bërë ballë q'do rreziku që munt të gjajë. Në rrast t' emrimit e Delegatëvet në Vlorë u bënë pakë fjalë se populli shënoi dhe Ismail Qemalë. Por kontrollorët nukë ishin të kënaqur në vajtëjen e Ismail Qemalit me që ata i kishin dhenë fjalë Esatit të quhej si kryetar i Delegacisë.

Mbas shumë bisedimevet midis fuqivet e mbedha kishin vendosur për kryeqytet Durrësin si mbas enderesës së Esatit e të fuqivet armike për të bërë kryeqytet Durrësin që të lazën rrolet e dëshrueme dhe ashtu Delegatët e shënuar më poshtë u mbëlodhë në Durrës.

| | |
|---------------------|-------------|
| 1º Esat Toptani | Kryetar |
| 2º Eqrem Libohova | Gjirokastër |
| 3º Pannondo Koleka | " |
| 4º Dr. Adhamidhi | Korçë |
| 5º Abdi Ypi | " |
| 6º Isuf Abas | Vlorë |
| 7º Ilias Virioni | Berat |
| 8º Lazar Xhumurteka | " |
| 9º Shoqet Elbasani | Elbasan |
| 10º Lefnosi | Elbasan |



| | |
|---------------------|---------|
| 11º Sami Virioni | Durrës |
| 12º Z. | " |
| 13º Noç Çoba | Shkodër |
| 14º Pashko Kakariqi | " |

Delegatët e Shkipërisë, nënë kryesin' e Esat Toptanit udhëtojnë nga Durrësi për në Evropë më 30 Janar 1914, dit' e gëzimit të math të popullit shqipëtar i cili vështron pa durim kundruall Neuviedit duk' e pritur lajmin gazmor prej delegatëvet e tyrej.

Mbreti mbasi vizitoi Italinë dhe Austrinë ish kthyer në Neuvied ku priti përfaqësonjësit e popullit shqipëtar të cilët u sosnë atie më 8 Shkurt 1914 ditën e Shëtunn.

Princi, me fjalë të nxehta e t' urta, të dashura, me një herë e pranoi dëshiriën' e popullit shqipëtar e kështu xgjedhëja e lumtur e Evropës hoqi pas xgjedhëjen e Kombit Shqipëtar i cili me një zëmër e me një ndienjë të dashur që t'a ketë në krye të vetë madhësin'e tij Vilhelmine I.^{re}

Ditë të këtilla, kaqë të shënura në Historin' e Kombit t' onë, nukë janë shumë në jetën e njëi Kombi e veçanërisht sa për Kombin Shqipëtar është e para. Eshtë edhe mbetet një ditë historike nga më të shënuarat në jetën qytetërore ku populli



shqipëtar pëlqen një mbret, vë fatin e vet në duar të sigurta, ryn në radhën e të tjera mbretërice me një udhëheqës nga kurorat princiçore më të famëshme të Gjermanisë i cili lidhet me kurorën e të stërvjetërit Komp Shqipëtar duk' e i u vënë themel njëj japië dhinastisë Shqipëtare; dhinasti e cila e mbështetur në dashurinë e besnikerin' e pa kufishme, dote dije e dote mundët' a ngjallë edhe një herë atë kohë të bardhë që mbajti deri në çastin e fundit të jetës e Skënderbeut.

Fest' e dhënëjes së fronit e të kurorës, u bë në kështjellën e motëshme te femijes Wiëd, ne qytetin Neuwjed ku ka shkëlqyer gjithë monë shtëpia e vjetër gjermane, Historia e të cilës lidhet me Historin' e Shtetit të ri. Kryetar i Delegacionit, pas njgjatjetimeve të zakonëshme mbajti këtë fjalë n' emër të Delegacisë.

LARTESI!

Dërgata, e sëcilës kryetari iam dhe që si i tillë kam nderin e math t'u a prezantoj, ka ardhur këtu që t'u lutet që t'a poltisni froni e kurorën e Shqipërisë së lirë e indipendente; ashtu pra është në gëzim të pa kufi që munt t' a mbarojë



këtë detyrë më të cilën e ngarkoi Shqipëria e Lirë.

LARTESE!

Komp' i ynë i eli tjetër herë ka qënë i shtrënguar të lëftojë rregullisht përlirin' e tij e të shkojë më vonë në përnjë kohë shumë të zezë, nuk' i harroi kurrë. Me gjithë këto, ditët e famëshme të kohës së shkuar dhe mendimet që janë ngulur në mëndjen e tij, ka dijtur t'a përbajë shpirtin koinbëtar edhe gjuhën e prindëvet të vetë. Ndryshimet politike q' u bënë në Ballkan në kohën e fundit, përkujdesia e ndihma e fuqive të mbëdhë t'Evropës, e siguruan fatin' e tij, Shqipëria është posatërisht e lumtur që lartësia e juaj që jeni bir i njei kombi kaqë të famëshm në punën e shkencave e të qytetërimit poltiset që të bëhi mbret i ynë.

Zoti fuqi plotë t'i u ketë nënë krahun'e vetë, ju edhe shtëpinë t'uaj për të mirën e Shqipërisë. Shqipëtarët të gjithë pa ndryshim, gjithëmonë do të jenë t'unjur, besnik të lartësisë s'uaj e të gjithë gati për të ndihmuarë mundimet t'uaja për t'i prurë Shqipërisë jetë përparimtare e të lumtur.

Rroftë madhësia e tij Mbret' i Shqipërisë.

Përgjigjës L. M. e tij Mbretit.

Mbreti u përgjeq Gjermanisht : Çkëlqesi ! Zotërij ! erthtë këtu si të dërguarit e tërë Shqipërisë që të më dhuronin fronin e Atdheut t'uaj i cili pas shumë luftimesh e shumë fështirësirash e fitoi së prami herë lirin'e vetë. Iu pres me gjithë zë ër këtu në Nënvvjad, qyteti ku janë lindur në kështjellën e gjyshëve te mi. M'a kishëndë t'u pres këtu që t'a njihni edhe ju vëndin e origjinës s'ime. Kisha dëshirë të veçantë që të vijë te unë një dërgatë nga Shqipëria e cila të m'a thotë lutejen e popullit e të kërkojë nga mua t'a poltis fronin e atji vëndi. Fuqit'e mbedha të cilat me ndihmën e tyrej mëredashëse e me mbështetëjen e tyrej e siguruancë gjendëjen e Shqipërisë si Shtet Indipendente, më shënuan mua për të parin e vëndit t'uaj e dhe janë i lumtur t'u a them që e poltis fronin e që Princesha e unë do të vijmë pas jush në vëndin t'uaj i cili do të jetë Atdheu ynë i ri. *Këtë vendim nuk'e mora me lehtësi, pata nevojë të mendohem më shumë muaj deri*



sa të tregohem gati për t'a poltisur atë froni. Por fështirësitë e mbëdha e përgjegjësitë që rrjedhën s'andejmi, më bënин të qëndroj në dyshim. Me gjithë këtë, tani pas si mëra një vendim mbi këtë gjë, dua që me gjithë zëmër e me gjithë fuqinë timë të jem i Atdheut t'imi të ri. Kam besim e çpresoj se gjithë shqipëtarët dot'i gjëj njerës me zel e bashkëpunëtorë, të bësës për të themeluar këtë shtet e për të sigruuar zhvillimin, përparimin e tij, të më epni edhe ju provë për një besim i cili të jetë mbaras me besimin për të cilin do t'u aprovë unë e atëhere përpjekëjet, mundimet t'ona, me ndihmën e zotit fuqi plotë, do të dalin faqe bardhë e plot dobi. Me gëzim e mirënjohëje i u qas siguri net që m'epni për besnikërinë tuaj për atë besnikëri e cila gjithëmonë ka qënë e shenjtëruar në Shqipëri dhe e famëshme në tërë botën. Se pse mënt të mbështetem mbi ndihmën që dotë m'apën gjithë shqipëtarët duk'e kryer me mua tok misinë barrën, e bashë ne, na do të arrijmë, shpresoj t'a kërrejmë Shqipërinë në një jetë fatmirë e të luuntur.

Pas si e sosi këtë fjalë mbreti thirri Shqip : Rroftë Shqipëria.

Lajmi gazmor prej Delegacisë s'onë rro-



tull pranimit e fronit të Shqipërisë prej Princi, madhështor e kryelarte Gjerman, në tërë vizet e Shqipërisë u prit me gëzim e me entuziazmë të pa treguar. Duk'ë festuar dit'e Diell më 9-shkurt 1914. Më të tjer anët buçiste zjam'i gëzimit ndier u ë zëvërat e popullit Shqiptar, dhanë urimet e duhura me telegram tekst i të cilit është:

**Madhërisë së tij mbretit e Shqipëterëvet
Wied Wilhelm i parë, Newied.**

Lajm'i gëzuarëshm që froni i Shqipërisë u pëlqye prej madhënisë s'uaj e që kurora e të pa vdekurit Skënderbe u bashkua me armën e famësh ne të fëmijës Wied, mbushi plot me gëzim të pa trëguar anë mb'anë të gjithë vizet e Shqipërisë jetike. Populli Shqipëtar, bashkë me përsaqësonjësit e vëndeve të paliruara, i mbëledhur me një frymë e më një ndienjë dashuri përmadhesin t'uaj, i u dërgon urimet më të nxëhta për jetë gjallësinë t'uaj e të madhësis' e saj mbretëreshës' e gjithë së vjetër fëmijës Wied e për lumtësin e popullit Shqipëtar që më një besnikëritë pa tundur, hyn nënë hien t'uaj.

Princi, duk'ë qënur i bashkuar me De-

legazinë Shqipëtare vizituan vjehërin e tij, i cili mbasi u hoqi një drekë, mbajti një fjalë kundruall dhëndërrit e bijës kështu :

Një popull që vuajti nga fati, shpreson nga ju që kini për të rrëfyer udhën'e fatbardhësia. Përipiquni me gjithë fuqinë t'uaj e me dashuri që të mbushni detyrat t'uaj, që të mundni të mirrni mbi vehte përgjegjëjen kundrejt mëmëndheut t'uaj e kundrejt vehtes s'uaj.

Rregji duk'e kthyer sytë nga Delegatët u tha : Iuvej zotërij Delegatë që kini ardhur nga Shqipëria për t'i paraqitur kurorën Mbrëtit t'uaj të ri, ju them :

Na kemi kesim për ardhëjen e Shqipërisë me qenë se është e njojur si një vënt ku besnikëria, priteja dhe trimëria janë veprat më të para. E dini shumë mirë që një kohë përparimi e përmirësimi që fillon për vëndin t'uaj të bukur e kini për t'u ndihur gjithë nouë mbretin t'uaj si besnik bashkëpun tor..

Esat Pashai u përgjeq kështu : Dit'e sotme, është tepër e madhe. Pasi gjëndemi në shtëpinë që që djep i së përndershmes mbretëreshës s'oni, e sigurojmë përsëri se kombi Shqipëtar pa ndryshim ka për t'i qenë besnik duk'e ditur se pasimet e të

për ndershmes shtëpisë s'uaj janë pengë, ajo s'ka për të qënë vetëm mbretëresha por edhe mëm'e popullit të saj. Pejëndia e ruajt bijën e shtëpisë s'uaj të dashuiën mbretëreshën t'onë.„

Pas të kuvënduarit gjat' e gjëjë, Delegatët, pas fjalës q'u tha mbreti, iknë e erdhë në Triestë ku dot'a presën mbretin kur të kthehej nga vizitat e të vinë bashk në Shqipëri.

Të mos shkojmë pa treguar se për vec Delegatëvet e dërguar nga Shqipëria por ishin dhe Delegatët e Shqipëtarëvet t'Italisë, Bullgarisë, të Rúsisë, të Serbisë Rumaniisë dhe t'Amerikës të cilët kishin vatur dhe ata së bashku për t'i paraqitur Princit kurorën. Vetëm shqipëtarët e Greçisë të Misirit si dhe ata të Stambollit nukë lin hin marië pjesë.

7 Mars 1914 Gëzim, gëzim.

Dit' e Shëtune më 22 Shkurt, 7 Mars, 1914, Dit'e shënjtë dhe e gëzimit, dit'e bardhë, e nderuar dhe e shënuar e cila n'a solli një gëzim aq të math sa mundt të thuhet se është e para dit që siell shpëtimin dhe nderin e jetës Kombëtare. Ditë



që siguroi, lulëzoi, xbardhi jetën e Shqipërisë e cila i pru Mbrenë, e Mbretëreshën dhe i nguli në fron'ë lartë të Skënderbeut. Gëzim'i kësaj dite që ndihet në zëmrat ë Shqipëtarëvet të kujdo vëndi ashtë aqë tè për sa nukë munt të përfytyrohet as me një fjalë e cila pas 447 vjetëvet ngjalli fron e Shqipërisë me një Mbret trim, të dijtur të lartë, me fuqë dhe kraharuar hekurt i cili do të gjërsëojë e të madhojë duk' e futur nënë Mbretërin'e Zhgabës tërë vizet Etnike të Shqipërisë.

Madhësia e tij po vjen, populli si mizëria kish pushtuar e mbushur faqen e bregut të Durrësit, burra, gra, të mbëdhij e të vegjij, popull'i kujdo qyteti ndarë më vete, togjo togjë kthyer nga deti po vështrojnë me dëshir e me gëzim ballimin e Vaporrëvet. Të gjithë rrinë më këmbë dhë pas një copëherë të madhe, dëshir'e pa treguar arrijti të imbarohet duk'e parë në funt të limanit, thua më mirë në mes të detit ku sa mbleronte pakë Vaporri. Dal nga dalë futat në liman Vaporri Taurus' i Austro-Ungarisë i cili sillte madhësin'e tyrej. N' atë ças thiri gjith gjëndja me ngashëri e me fortësi të pa treguar duk'e përpjekur pëllëmbët, "Rroftë Mbret'i Shqipërisë."



Tre Vaporrë të tjerë të luftës' i Anglisë "Glansester," i Italisë "Quarto," i Francës "Bruiks," të cilët janë radhosur nga prapa dhe po ecëjn gati për t'arrijtur në Mol. Populli pa prerë fare zërin bërtisnin dhe shikonin sa zërat'e tyrej tingëllonin deri në qìell. Më çdo anë që të vështrojë shihet tërë njerëzinë fytyrë çkëlqyes sa gjëzim i kësaj ore, i kësaj minute kaqë të shënjtë shkaktoi derdhëjen e lotve të gjëzimit nga syt' e kujdo njeriu. Syt'e popullit uuk' u lodhë as pakë së veshtruari tëre një Vaporrin i cil gati, po i u siell të vetëmin udhëheqësin e tyrej.

Qasen të katër Vaporrë në Sqelë dhe n'atë kohë fillojnë së hedhuri topa dy tropido të cilat ishin dërguar më parë nga Italia e nga Austro Ungaria. Më një anë i ushëtim topavet dhe më tjetër anë zërat e popullit rroftë dukej si kur ish një luftë e rreptë në kohë sulmi ku gjëmonte tok'e bekuar, buçiste deti i Shqipërisë.

Z. Z. Kontrollorët, krye Qeverritarët e Durrësit, Drejtor'i përgjithëshm i Durrësit dhe i Vlorës, Myftilerë e të gjithë kryetarët e fevet të ndryshme ishin radhitur të parët.

Sa po u pas vaporit, Esat Toptani i



shoqëruar me Drejtorët e përgjithëshmë e me krye katunarin' e Durrësit shkuan në Taurus ku gjeneral Esati i përshëndoshi lartësit e tyrej me këto fjalë "jam i lumtur t'i u uroj mirë ardhjen. Juve do të bëhi një Skënder bej-i dytë. Tërë Shqipëtarë kanë besim që ju dotë mbadhonin Shqipërinë e që dotë jini atë për ta.

Ora ish 3 e 15 kur madhësit' e tyrej vunë këmbët mbi tokën e bekuar të Shqipërisë. Në mest të nderimevet e ushtërisë dhe të brohorive e të duartrokositjeve të popullit arcijtin lart madhësi e tyre duke pasur prapa Esatin veshur me pëtka zyrtare.

Komision' i kontrollorëvet e prinë përpara në ballë të molit ku kryetar' i tyrej Leoni i urroi mirë ardhëjen duk' e i dhënë në dorë fuqinë e Shtetit. Për së gjat' udhës qenë radhosur përfaqësonjësit e qyteteve të dërguar nga çdo an' e Shqipërisë. Delegatët e Shqipëtarëve të jashtëm dhe çunat e shkollave ishin radhitur një pas tjatërit.

Duar trokitëjet dhe brohoritë po vazhdojnë në të katër anët që nga ballët e molit e deri sa madhëri e tyrej vanë në pallatë.



Madhësia ë tij duk' e shkuar përshën-detonte popullin me dorë në krye si dhe madhësi e saj gjith' ashtu duk' e patur një shami në dorë ngrinte duartë më të dy anët:

Shumë një përshtypje e keqë i u bëri madhësisë e tyrej kur panë Delegatët e Kosovës si dhe të Çamërisë të cilët qanin me lot dhe me ngashëri të madhe. Djemt' e Shkollës të Kavajës veshur me petka të bukura Kombëtarë duk' e kënduar e duke treguar një qëndrim ushtëror bëri një përshtypje të kënaqëshme në madhësit' e tyrej sa që nuk munt të mbanin lot' e gë-zimit. Madhësit' e tyrej duk' e përshëndetur popullin ecëjnë në udhën'e shtruar më Kadife dhe u hidhëshin lule të shumta sa që shkelnin tër një mbi to. Dy pullumbë të lishuar që qëndruan njëri përpara madhësis' e tij Mbretit dhe tjatëri përpara madhësis' e saj Mbretëreshës u bëri një përshtypje gazmore shum të madhe.

Mbrëmanet në shesh të Sqelës i cili ish ndrituar begatërisht, ish mbëledhur tërë populli si dhe duartrokitëjet' e brrohorit' e popullit të cilët prisnin daljen' e mbretit në ballkon.

Përfaqësonjësit e vendevet të robëruara.



ju lutnë madhësis tij për çlirimin' e vizeve të shkelura të gjëndura nënë sundiminë armiqëvet të cilët duhen pa tjetër të futen nënë flamurin' e shënjtë kombëtar.

Manifestat bëneshin të mbëdha më të katër anët e qytetit sa gëzimi që ndihesh këtë radhë qe aq' i math e i lavduruar shënë sa nukë munt të ketë kurrë vjershëtor të zotin në bot që të mundë t' a përfytyrojë tërë atë gëzim të ditës Historike dhe fatmiroshe të Shqipërisë.

Delegatët' e Shqipërisë e lirë bëjnë një darkë dhe ftojnë Delegatet' e vizevet të robëruara ku tërë natënë u bënë shumë ligjérata të këndëshme dhe Historike.

Deligat'i Shqipëtarëvet t' Italisë bëri një thënje të posaçme mbi gjëndëjën e Shqipërise duk' e trënguar shkakun' e mërgimit të tyrej nga Shqipëria. Gjith' ashtu u festua këjo ditë gazmore në gjithë vizet' e Shqipërise pa ndryshim feje duk' u bëre lutje të duhura dhe në qisha e në xhamira.

Sundim' i qeverrisë Mbretënore

Më të nesëret venë Drejtorët' e përgjithëshm te madhësie tij dhe autorizohen të bashkëpunojnë dori sa të formohet kabineti.



Dhjetë ditë pas ardhëjes' e Mbretit u formua kabineti dhe filluanë detyrat më të larta duk' e i u zotuar barrës' e rëndë të rregullimit' e shtetit dhe të popullit.

Kabineti

- 1º Turhan Pasha, Krye Ministër dhe M. i jashtëmë.
- 2º Esat Pasha, M. P. brëndëshme e M. i luftës.
- 3º Prenk Bibë Dodë Pashka, M. P. Botore.
- 4º Myfit Libohova, M. i Drejtësisë.
- 5º Dr. Turtulli M. i arrësimit.
- 6º Dr. Adhamidhi, M. i financavet.
- 7º Azis Virioni M. i bujqësisë.
- 8º Hasan Prishtina, M. i posttelegrafeve.

Myfit Lubohova pasi u vu Ministër dha dörëheqëjen te Komision i Kontrollorevet për punën që kish në mest të tyrej si Delegat' i Shqipërisë.

Madhësi e tij lajmëroi tërë popullin deri më katundet më të vogëla me nga një letër botuar Shqip me anë të së cilavet i thërriste në bashkë punim.

I tërë populli, me një herë gati mori pjesë në bashkë punim me energji, me zel të plotë nënë urdhërin e Mbretit, Filloj



pra maqina e shtetit rregullish të punojë duk' e drejtar e rregulluar enteresat gjallnore të shtetit.

Qetësia, mirësia, dashuria dhe vellezëria e gjith' ashtu t' ardhurat e shtetit nga çdo degë qeverrie e ca më shumë shitja e pullavet të postë, me fytyrën e Skënderbeut e më datë 7 Mars 914, suallë më të vërtetë të parin bashkim dhe lumtërimin e Shqipërisë nënë një Mbret Evropian.

Me ardhëjen e L. Madhësisë tij Mbretit, u sigurua aqë shumë morali, bashkimi i popullit dhe shpëtim' i Shqipërisë sa nukë mbeti më as më i pakti dyshim duk' e qënë të sigurt se sot e kësaj dite nukë dotë mundënëdot feodalët të lozën më fatin e shënjtë të kombit. Shqipëria si një shtet i vogël, më vehte, duk' e pasur në krye një Mbret Gjerman, një mbrojtës, një udhë heqës të dijtur e të shëndoshët filloime zel në shërbimin, mirësimin, lulëzimin e mëmëdheut me një Qeverri kombëtarë e cila në pakë kohë e sipër u dha botës e qytetëruar më të mirat shëmbëlla njërezore e patriotikë.

Populli Shqipëtar shumë vojtës, gati shpëtuar nga xgħedha e tmeruar afro 450 vjeçare si njerës natyrisht të urtë vazh-



dojnë pa reshtur në zhvilliuin kombëtar. Por me gjithë atë nukë po shtëmënëk vrejtëjen trimënore nga ministrat e sotmë të cilëvet u a ka parë, provuar shumë mirë qëllimet, intrigat dhe nakaret e ambicit' e tyrej. Me gjithë që vrejtëja trimënore e popullit bësnik i cili njeh shumë mirë psikologjinë e feodalëvet siell fort një të pakë dyshim, por prapë nukë do këtë as një lloji mënyre që të mundë të shkakëtojë çkatërrimin e bashkimit të shënjtë midis popollit kombëtar vojtës e Mbretit krye lartë të Shqipërisë.

Shqipëria më të vërtet u krijuar dhe u njoh mvehtësia e saj por mbasi kemi thënë ruë parë përfundim' i njohëjes u shkakëtua më së fundi nga përfundimet e marrëveshëjevet dhe të bisëdimevet e rrepta më aqë kundrështime që rrodhë në konferencë midis fuqive të mbëdha. Asht' e dijtur se kundrështimet e entëresave që po vazhdonin me kohë midis njerit dhe tjetërit të fuqive e mbëdha, nuk' i kish lënë të kënaqur vendim i krijimit të Shqipërisë në këtë mënyrë e në këtë formë por fuqia morale e Gjermanisë dhe e Austrisë i kish shtrenguarë të tjerat fuqi të mbëdha t'i binden atij vendimi me qëllim që të prap-



sën dhe të vonojnë shkakëtimin e sulmit Gjerman deri sa të përgatiten për t' i kundreshtuar që të mundën t' i bëjnë hallë.

Politika italiane e cila kish përkrahur me kohë enteresat kombëtarë te Shqipërisë dhe ish treguar mikija me e parë e çash-tëjes t' onë për të bërë një Shqipëri të madhe me qëllim që të mërgojë lakëmitë dhe sulmet e Skllavëvet dhe Grekëret nga buza lindore e Adriatikut; ndryshoi politikën e saj duk' e treguar vehten e saj sinjë më i rrepëti armik' i Shqipërisë.

Italia fort e pa kënaqur nga mos përfitim i disa koncesioneve me rëndësi që deshi të mirr nga Shqipëria, ca më shumë nga formim'i shqipërisënë, formë me një mbret gjerman e më në funt tue mos pasur ajo as popullin as dhe organët e saj të pajosur me kapaçiten e drejtimit të njëj politike e cila të mos dësheronte kurrë prishëjen e Shqipërisë ose që t'a ketë si koloni pse se është gjë e ka mundur; ushtrëngua të bashkohet me udhëheqësit e politikës t'Ingliterës, Francës dhe të Rúsisë të cilët për një dorë dhe për një gojë të bashkuar u përpojnë më çdo mënyrë që të shtijnë në rrezik ente-




resin e Shtetit t'onë për të mos pasë një fuqi në Shqipëri Parandoritë qëndrore.

Armiqt'e Perandorivet qëndrore të lidhur në një qëllim gjenë kumbisjmën e plotë që të mbarojnë qëllimet e veta në Ballkan duke, përfituar nga mos xgjimi plotësisht'i Sdqipëtarit.

Italia, Sërbia dhe Greqia të kumbisur mbi këtë politikë filluanë si me anë të Klerëvet gjiath'ashtu derdhë të holla me anë t'axhentave, të përfaqësonjësvet e dhe të spiunëvet të cilët nukë lanë vënt pa shëtitë, nukë lanë njeri pa trathëtuar deri sa hidhruan, ashpëruanë dhe trubulluanë menjimin e popullit vojtëje: Shqipëtar.

Më gjithë situatën e kundërtë të kohës, prapë Shqipëtarët të bashkuar po punojnë me armoni të plotë të bashkuar me Mbretin e tyrej edhe me organizatorët Hollandezë, të cilët në veprimet e tyrej treguan më të madhen therori në Drejtimin e interesave dhe në themelimin modern të shtetit Shqipëtar.

Korçarët e famëshmë bashkë vulnetarët Hollandezë e më Kapedan Gjilardin kishin ryrë në Korçë me luftë. Greqia me gjithë që e pa shum keq punën nga hovi dhë sulmi i rrëpët i Shqipëtarit por tha t'a



lishoj më mirë Korçën e xgjuar me q'ata nuk bëhen vegël e trahtëtisë si popull'i të tjera vënde të Shqipërisë jugore.

Ardhëj e Princave në Shqipëri.

Dit'e Diell më 29 Mars 914 erdhë princat në Durrës me vaporrin Iakt, u prinë me nderime të mbëdha prej ushtërisë, nxënësavet dhe popullit të cilët ishin të radhitur që nga buza e Molit dëri në Pallatin Mbretënor. Vaporrët e luftës hodhë nga 21 topa dhe populli nuk pushuan së thiruri Rroftë fëmija Mbretënore.

Prinsi trashëngimtar Karrol Viktor Skënderbej, Princesha Maria Eleonora zbrinë në sqelë ku i priste lartësië tyrej. Foshnja me një flamur të vogël në dorë, ishte mb'anë të djathët të Mbretëreshës dhe Princesha me të mëngjér të saj e më të djathët të Mbretit shkuanë për në Pallatë. Princ'i vogël e i dashur nuk i ndante sytë prej popullit po me një vrejtëje madhështore deshtë të thosh që (unë vij në gji t'atij kombi bujar q'i kam për të falur zëniern t'ime),

Princesha nukë pushonte duke ngrijtur duart nga gjëzim'i math sa s'duroi së pyetur t'ëmën (këto gjëzime e këto kënaqësi



që dëftohen prej popullit, për kë janë; për mua a për vëllanë ?

— Për të dy —.

Armië pushimi dhe marrëveshja e Korfuzit.

Në prozhenë që kish bërë, Kabineti i Turhan Pashës, kish cakëtuar rroga dhe në-punësira të shumta sa me gjithë që nuk u bëhej dot ballë me t'ardhurat e pakta të njei Shteti aqë të vogël por ky ar i plotë që epej nënëpunësve shkakëtoj ca më shumë lakëminë dhe zilinë e shumë njërvet t'ardhur më vonë nga vënde të mërguara të cilët pa mos njohur e pa mos provuar person'i tyrej i u dha në dorë punë me shumë rëndësi.

Nukë shkoi shumë vonë kur shumë një-rës të dejtur nga napolonat e Shqipëtarit, me gjithë që nukë shërbën në detyrra por ata dhe shumë të tjerë njëresë të shitur, njëres që nukë njohën as pakë psikologjinë e Shqipëtarit, njëres të pa inëshirë, të pa dijtur e të pa interesuar në lëvizëjet, në gjarëjet e shkakëtuar deri tash në Shqipëri, nukë vonuanë së vepruari propagandat mizore e fatkeqë të klerëvet duk'e lozur rrolet antipatriotik t'organizuara prej armiqve fqinjë të Shqipërisë.



Mos shërbimi i tyrej në detyrrën Patriotike, e veçanërisht mos respektim i sëremonivet fetare e të zakoneve të vendit të cilat janë themelosur, në trup të popullsisë; suallë një çudi të madhe, një ndryshim dhë një përcarëje në banuësat Shqipëtarë.

Këjo shoqëri antipatriotike e lityjtur e ushqyer si kurdoherë më të hollat e fuqivet armike të kombit dhe të thesarit e shtetit Shqipëtar arrijti më vonë të hapë plagë më të madhe kondër Qisha e Xhamivët e cila trubulloi aqë më tepër mëndjen e qetë të popullit dhe ndryshimin e orizondit të kulluar.

Me gjithë që Mbreti dhe populli nacionalist i vertetë përpinqen sa më shumë në mirësimin e çështëjes por fatkeqësisht kazan' i prapagandave që është ngrehur në krye qytet merr valë ashpërisht duk'e parë nüë të mbëdhat ndihëma prej feodalëvet dhe prej armiqvet të cilët gjithë kush mb' anë të tij i vë dru kazanit që të mos mundë Qeverria t'a shuajë.

Mb' anë tjatër populli Shqipetar i Krishterë i vizevet Jugore i verbuar ca më tepër nga prapagandat e klesit Ortodoks i cili më anë të fesë Ortodokse shtyjti në trathëtim Shqipëtarët Ortodoksër ku më



12 Maj 1914 çpallë aftono nin më mbële-dhejen e tyrej që bënë në Gjirokastër.

Dëshir' e Shqipëtareve që të lishojë Greqia vizet jugore si mbas vendimit dhe njoftimit e Konferencës, arrijti në dyshim. Simbas rrolit e Venizellos vetëm Korçën Kolonjën dhe Frashërin i lishoi ca më luftë e ca më të mirë. Nga Gjiro-kastra, Tepelenë, Delvinë, Leskoviku e tej nuke po del. Më gjith' atë po bën të liga miuft në mënyrë Epirote.

Mbreti krye lartë, mbasi e shef se nukë po del Greqia që të respektojë vendimin e të 6 fuqivët, dhe shef se nënë maskë lot rroli ma i math për kundër Shtetit Shqipëtar, vendosi t'i marrë vizet Jugore më luftë duk' e lëns gjithë resposabilitetin Qeverrisë Greke.

Urdhëron mbëledhëjen e ushtërisë dhe fillohet lufta. Delegatët e Qeverrivet të mbëdhë si dhe Qeverritë e tyrej ja njoftojnë Shqipërisë se vizet Jugore të mos merren më luftë duk' e porësitur bërëjen e njëj marrëveshëje.

Politik' e popujvet e mbëdhij dhe të vegjëj e cila po vazhdon pa qëndrim dhe e pa themeluar, trëgohet çiltazi se për vec



që nukë do të na lënë të qetë por akoma dotë shkakëtojnë luftënë mondiale.

M. e Tij Mbreti kish emëruar Tomsonë krye Prefekt në Korçë e në Gjirokastër me gjithë qarket e tyrej.

Çqetësimi, prishëja e armonisë të vizevet e Shqipërisë së mesme, si dhe zjarr i tmeruarë në Shqipëri të Jugës në mënyrë si aftonomi Epirote u shkakëtua nevoja e njëi marrëveshëje midis Epirotëvet dhe Qeverrisë me qëllim që e tillë marrëveshëje t' ishte një nga masat e duhura për realizimin e bashkimit kombëtar nënë Mbretin Gjerman.

Mbret' i Shqipërisë urdhëron pushimin e luftës dhe dërgon në këtë marrëveshëje Tomsonë i cili ish më i forti besnik dhe që di fort mirë çashtëjen e Shqipërisë Jugore. Mehdi Ben si Delegat phe tërë Kontrollorët fillojnë bisëdimet e tyrej në Korfus të cilët më 25 Maj 914 u nisnë prej Vlore për në Sarandë ku u shoqëruanë me Zografon, Dhulin dhe Spiro Milon.

Kërkimet e përfaqësonjesvet t' Epirit ndofta të pa ndrejta po ushqehën ca më shumë nga më të shumët Kontrollorë që kundreshtojnë cashtëjen Shqipëtare më një shkallë sa Spiro Milua ndënjur këmbë



mbi këmbë, para tyrej kundreshton duk' e çpallur mos besimin e Qeverrisë Shqipëtare e cila sundohet me një Mret Evropian si dhe me organizatorë.

Populli Shqipëtar i gjithë vizevet të liruara protesten fuqitë e mbëdha kështu: Populli Shqipëtar i Vlorës e i gjithë vizevet e tjera, duke marrë vesh që kërkonen privilegje për Shqipëtarët e Jugës, proteston të tilla privilegje të cilat i emëron vdekëje për gjallësi të kombit e dëfton që nukë dotë njohë as nonjë herë as nonjë privileq për as nonjë pjesë të popullit. Shqipëtar.

Proteston kundër ç' do ndryshimi të kufive kufivet e Jugës.„

Kolonel Tomsoni, mbasi u muar vesh me Mbretin mbi situacionin e brënpësm e të jashtësm vendosi pranimin përkohësisht të privilegjeve që vijnë më poshtë përvizet që bënë kryengrijtëje të rrjedhura nga përfundim i vendimit të konferencës e Korfuzit dhënur në fuut të Mait.

Privilegjet.

- 1° Këto vize që deklaruan kryengrijtëjë, t' a njohën për Mbret Mbren e Shqi-



përisë dhe flamur'i Shqipërisë të valojë
në ç' do vënt.

2º nëpunësit dhe gjendarmëria të qenë
vëndës prej të Krishtërë dhe Mysli-
manë dhe Qeveriria Shqipëtare s' ka
të ndrejtë të këmbejë nëpunësit, Tëskët
të mos venë në Gegëri dhe Gegët
jo në Toskëri.

3º t' ardhurat e këtyrej vizeve, pasi të
paguhenë harxhet që dotë duhen për
këto vize, të mbeturat dotë dërgohen
në arkë të përgjithëshme.

4º gjuha zyrtare është gjuhë Shqip në
gjukatore dhe në Shkolla. Shkollat
Gërqisht të mbeten siç qenë po të
mbësohet Shqipija si gjuhë zyrtare,
Qishat të mbeten siç kanë qënë në
gjuhë Gërqisht.

Esati, shok' i Venizellos dhe i Zografos
ngul këmbë në mos pranimin e privilegjeve
me qëllim që më nj' anë të vazhdojë lufta
m' Epirotë dhe m' anë tjatër të vëré në
zbatim programin e përgatitur nga Italia.
Mbreti për të shuarë zjarrin e grindëjet, u
shtrëngua fë pranojë perkohësisht vendimin
e Korfuzit duk'e komunikuar kontrollorëvet
në pranimin e vendimit me pakë ndryshime.
Kontrollerët lajmëruanë Zografon i cile



zuri të bëjë naze duk' e parë se ato gati po fillojnë grindëje në Gegëri, u gërua dhe kështu kërkon prej tyrej që marrëveshëja e Korfuzit duhet t' i qitet një mbëledhje Epirote pra të pranahet. Kërkon t' a dijë se çfarë garranti ndërkombëtarë dotë' ketë për zbatimin e atyre marrëveshëjeve.

Pas një muaj u lirua Stazani nga ushteria Greke.

Kryengrijtëja Greke në maskënë Epirote

Idea Grtke e cila nukë ish lodhur së punuari me ç' do mënyrë, së krijuari çësh-tëjen Epirote sa më në funt organ' i saj i përbërë prej Zografos, Karapanos dhe Dhulit e të tjerë Shqipëtarë q'u quajtin më së fundi kryetarët e të vëtëquajturësë Qeverri Epirote, me ushterinë e rregulluarë Greke shkakëtuanë më të mbëdhatë mizori në pushtimin e ma se 300 katudeve të Toskërisë e begatëshme të cilën fatkeqësisht' i plaqkinë, i dojnë, i vrouë dhe i thérië pa çikë mëshirë fëmijët Shqipëtarë.

Ky organ i mallëkuar kish filluërë së vëpruari në vizet Jugore që kur se idea Shqipëtarë po thuaj ishte në gjumë të thellë duk' e hedhur në trupat e të krish-terëve Shqipëtarë shiringat plot me helm



të cilat kishin bindur aqë têpër popullsin' e krishterë sa verbazi të ç' kombëzohen duk' e pandehur veten e tyrej Grekë; shkakëtuanë humbëjen e vellezërve Muhamadanë si dhe të Shqipërisë.

Me gjith' atë të Krishterët Shqipëtarë ishin të dyshuarë e të frikuarë se e tillë marrëzi e trathëti shkakëtonte grindëjen dhe përqarëjen e tyrej me një kombasit e vetë, por organi Grek për t'i arrijtë qëllimit e dobërt q' ushqente prej shekujsh në prishëjen e Shqipërisë, i mbëlodhi si me pahir më 1 Gusht 1913 tërë popullin e Krishterë në qytetet e kujdo krahine dhe i organizoi si mbas qëllimit e vetë.

Frik' e tmeruar e Grekomaniëve që nuk u hiqesh nga mëndija se sigurisht konferanca e Llondrësë ato vize Jugore fjeshtë Shqipëtarë nukë dot' i ndante dot nga gjir' i mëmës së tyrej Shqipërisë, i nguti ca më parë të thërrasën nënë armë të Krishterët. Shqipëtarë si për t' i organizuar që të jenë të gatitur në luftat e pastajme. Por dal nga dale duk' e i u pësëritur atyrej plagët e grindëjvet fatale të kohëravet e kaluara si ëhe duk' e i u sigruar çkattërrimin e fesë së tyrej! popull' i mjerë i cili nukë kish as pakë mejtim kryengrij-



tëje kundër mëmës së tyrej, arrijti në bindëje t' organit Grek me qëllim se ay dotë jet me të vërtetë një mbrojtës më i shënjtë i të ndrejtavet e tyrej.

Organi Grek çfaq sigurimet e plota në popull se dhe si kur Evropa t' a qirtë ushterinë Greke nga vizet Jugore, ata do të bëjnë si kur të dalën nga dëra, mb' anë tjetër do të hynë gati nga dritarija dhe nuk' i kanë për të lënë në duar të Shqipëtarëvet që t' u prishën fenë !.

Ishte proto Vjesht e I 1913 kur Qeverria Greke lajmëroi arganin e saj n' Epir se vizet Jugore i mbenë Shqipërisë si mbas vendimit e qarkëvet politike. Ky lajm i hidhur i helmoi aqë shumë ortodhekset grekomane të gabuar e të shtyjtur në trathëti sa zunë të rrullohen në për mitropolira e në për qishëra duk' e mejtuar rrugën që do të marrën. Organi fetar dhe zyrtar boton për këdo katunt nga 6 kartëra të shkruara Greqisht dhe Frangjisht të cilat mbasi i vulosi prej popullit — ku thoshin ja bashkim me Greqinë ja vdekëje — i dërgoi në të 6 Fuqit' e Mbëdha.

Për vëç këtyrej, u mbëlodhë gjithë popullsia në mest të Vjeshtës e I, në qëndrat e krahinavet dhe mbasi u betuanë



burra e gra në Ungjillin e shënjtë duk' e thënë se do të derdhënë gjak për të mos vatur atje Shqipëtarët, protestuan në fuqi të mbëdha dhe të mbret' i Greqisë nga i cili kërkonin pa turpësisht për mborjtjen e tyrej nga vëllezërit Shqipëtarë.

Të mos shkojmë pa mos përmëndur se vizet Jugore të pushtuara prej ushtësisë Greke, akoma nukë ishin lishuarë, afro 3 muaj shkuanë kohë më protestime po konferenca e Llondrës si dhe Fuqit' e Mbëdha të themi; si mas vendimit që kishin dhenë i shkruan një notë të përbashtë Greqisë më 13 Fruer 1914 që të heqë ushterinë duk' e i dorëzuar gjith' ato vize Ad. Shqipëtare. Por grekërit më popull të gatitur përpiqen të bëjnë kryengrijtije. Qeverrisë Greke nuk' i ipte dorë çfaqazi të vepronë kondër vendimit e konferencës, u çpalli duk' e i porositur të mos nxitonë në kryengrijtëje deri sa ajo të fillojë nga shtemëngëj' e ushtërisë e gjith' ashtu më pastaj do t'a bënin punën si mbas programit e Qeverrisë Greke, ajo Qeverri e cila iu zotua me dhënëjen e të hollavet, të munitionevet dhe t'ushtarëvet.

Më parë se të fillojë shtemëngej' e ushtërisë Greke, tërë popull'i Kisha të bëjnë



një mbëledhje të përgjithëshme në Gjirokaster më 27 Ientr 1914 në të cilën muarrë pjesë Delegatët e tërë qytevet d. m. th. Preveza, Ianina Paramithia, Konica, Leskoviku, Tepelëna, Himara Gjirokastra dhe Delvina e Korça.

Këjo Konferencë e përgjithëshme vendosi çpallëjen e Kryengrijtëjes. Mbas kemi thënë më parë organi Grek shum'pak mejtonte patritizmën e Korçës që nukë bëhet vegël e verbër e trathëtisë dhe âshtu si me thënë për të treguar në botë fillimin e vënëjes në veprim nga lirimi vizeve simbas vendimit e Konferencës dorëzoi Korçën dhe më pastaj Frashërin e Kolonjën.

Si kryetar'i Qeverris Aftonome që polli këjo mbëledhje u xgjoth Kristaq Zografua i cili dha ndihmë 35 mijë lira dhe Ministër i luftës Dhuli q'ish oficer Grek e kështu këta trathëtore muarrë në dorë frën e Qeverimit provizor me qëndër Gjirokasternë. Ark'e këti Qeverrimi ish Athina dhe municionet dërgohon nga Jorgucati ku ish qëndër'e ushtërisë Greke.

Në mest të Shkurtit, më shtrëngimin e ushtërisë Greke u çpall kryengritëja në të gjitha vizet, shum ushtarë gjith' ashtu topa nga këlcyrat e qëndra e ushtërisë u



dërguan të cilat u përndanë në kufitë stratigjike. Kufitë stratigjike janë këto: Në Përmet, Kosinën, Mokricën, Hotovën, Lupçkën gjer në urë të Kadiut. Gjirokastëra, Tepelena e Delvina zunë Kodrënë, Picarin e gjer në Himarë. Leskoviku Arëzën, Barmashin, dhe bashkoheshin n'urë të Kadiut. Fillohet sulmi nga të gjithë zët për të shtirë në rrezik jetën kombëtare si dhe kamjen e jetën njerëzore të Shqipëtarëve Muhamedanë. Fillojnë më parë nga masakratë në Paçomit, Kuqar, Këlcyrë, Peshtan, Kolonjë dhe Frashër e tej ku u sulë ushtëria Greke, rrëinbyen burrat, i qirnë të lidhur jashtë në përrëke dhe i therrë më kama të preheta. U kthenë dhe mbasi mbëlodhë gratë e çupat me çilimiqër ku mbasi mbaruan punën e tyrej me to filluanë së çpuari me thika dëri sa u a qirnë shpirtin me pahir. Plaqkile tere kamjen, dogjinë tërë shtëpit e tyrej.

Mbasi u bë ofensivë e Arrëzës Kurveleshit, Permetit, Leskovikut e tej dhe Epirotë me fuqinë Greke u thyenë duk' e mos i bërë dot ballë sulmit e Shqipëtarëvet, Greqia dërgon akoma një fuqi të plotë më çdo vënt e cila bëri sulm të math më çdo anë më 4 Prill 1914. Por Shqipëtarët si burra



trima pa pasur as një lloj ndihmë dhe të ndodhur gati midis dy zjarrevet i prinë fort mirë ku u dhanë dërrmën dhe dëmin më të math trathëtorëvet dhe armiqvet.

Më 25 Prill Kuçi, më 26 Tepelena u liruanë prej ushtërisë e rregulluarë Greke të cilët iknë mbasi ftuanë Gjendarmerinë Shqipëtare si me thënë për t'i a dorëzuar këto vënde. Fuqia Komëtare pa mos arritur bëri ballë ushtëria Greke me formë të ndryshuar në Kumandë të Spiro Milos me qëllim t'i pushtojnë prapë këto vënde. Fuqia Kombëtare ndofta e pa kujdestuar, Vrapoi më parë së bashku me popull dhe i u kundreshtuan. Krici lufta e rrëpët n'urë të Bénçës e në Luzat ku i vunë përpara duke i dhënë dëme të shumta; gjith' ashtu më 28 Prillë në Kardhiq e më të gjithë vizet. Fortezë e Borshit gjëndej në duar të Shqipëtarëvet në Kumandë të Kapedan Saliut. Grekërit të humbur nga lufta sulën në Hormovë ku 204 burra i mbëlodhë në Xhami dhe i therrë. Shqipëtarët pa pasur ndihmë materjale nga Qeverria arrijtën në Manastir të Cepos. Cepua vënt i forcuar, ra në duar të Shqipëtarëve të cilët në Kardhiq zunë një flamur t'aftonomisë dhe



i u afruanë Gjirokastrëse dhe ng' an' e Delvinës në Rusan.

Lufta vazhdon, një grusht Shqipëtarë të pa Kumandë e pa organizim vetëm të pajosur me ndienja kombëtare i arrijtin qëllimit me trimërinë bujáre, të tmeruar të çkatërrojnë fuqin' e madhe të rregulluar t' armikut.

Telefonet që vijnë nga ball'i luftës kërkojnë ndihmë materjale e cila fatkëqësisht nuk'u dërgohet nga Esati që ka frën'e Qeverrisë Shqipëtare në dorë.

Mbi këtë nevojë formohet në Vlorë një Komision burrash e një prej grash të cilët mbëlodhë miaft ndihmëra. Por këjo ndihmë kuj vallë dot'i epet më parë? më nj'anë ushqim e ndihma luftëtarëvet dhe mb'anë tjater ushqimi dhe ndihma q'ishte duk'i u bërë fëmijëvet Shqipëtarë në Vlorë t'ardhura nga vizet Jugore.

Ishët më 6 Maj 914 ditën e Diell kur fuqia Greke nga Himara sulmon që në Llogora Gurë e dëri në Qafë të Mëretes. Kundreshtim i Shqipëtarëvet t' atyre katundove si dhe ndihma e Bolenasve arrijti ku për një hërë u ndoq armiku mb'anë të Himarës. Qëllim i armikut ish të mirrtë krahët e luttëtarëve të Kurveleshit ku më



të vërtetë të mos pat arrijtur lum'i Vlorës duaj që puna mjaft e rrezikëshme.

Në këtë kohë përfundimet e luftës qenë kreit në fitimin e fuqisë Shqipërisë e cila kish në dorë vendet më të forta, pushtonte gjithë Shqipërinë Jugore. Ballët e fuqisë gjëndej nga Kurveleshi në Tatzat, Borsh, Golemp dhe Labovë; më kra të mesmë në Frashër, ng'an' e Korçës dy orë afër Leskovikut.

Kërkimet për munizione të luftëtarëvet e Korçës, Frashërit, Tepelenës dhe Kurveleshit mbenë pa vënt me që Esati për faqe të botës e të Qeverrisë nxirrte municionet e ushqimet nga krye qyteti si për t'i dërguar në luftë por ay i depozitonte në Tiranë ku më pastaj i përndau në duar t' atyrej q' i kundreshtuanë Qeverrisë.

Fnqia Shqipëtare besnik'i organit Mbretënor gjith' ashtu gazeta Populli i Vlorës i thonë, i shkruajnë çfaqazi dhe mbshëhtazi Mbretit për tërë ato që po punojnë feodalët në Kryesi t' Esatit.

Mirë po kush kuxon me që feodalët të kumbisur dhe të ndihmuarë me ç' do mënyrë nga axhentat e fuqivet armike janë aqë të sigurtë në vëprimet e tyrej sa sheshazi trathëtojnë duk' e humbur nderin



dhe fatin' e popullit pér tē çkatërruar organ' i qeverrimit Mbretënor tē Zhgabës.

Zënëj' e Esatit, Kryengrijtëja Rrebele dhe organ' i Qeverrisë; dit' e zezë, zia çkatërimi dhe varfëria.

Kazan' i math që prej kohësh ishte duk' e valuar në Kryqytet arriiti tē pérhapë valet' e tij dhe Në Shijak e gjekë. Kompllot' i feodalëvet me inflyencë anti-ligjore pér kundra Qeverrisë filluar me kohë arrijti tē shijojnë njërzia pemët e hidhura, tē tmerçme dhe antikombëtarë.

Ishte më 18 Maj 914 kur Madhësi e tij Mbreti merr lajmin e hidhur se në Shijak e në dy katunde tē këtij qyteti behet kryengrijtëje duk' e pasur pushkat në dorë vijnë kondra Qeverrisë në kryeqytet. Madhësi e tij urdhëron dërgimin' e Esatit dhe tē Myfitit në vënt që tē përpiqen t' i ndalojnë. N' atëçast ndryshoi meitim'i tij dhe i thirri tē dy pérpara tē cilët i pyeti (pér se Qeverria nuk' është kujdesuar që më parë kondër kësaj lëvizëje? As dhanë as muarr por tē dy miaft tē trembur nga tmer' i ligjit tē nacionit dhjanë dorëheqëjen. Bashkim' i tyrej nën jë mejtin q' ata si



Ministrat më me rendësi t' asaj Qeverrie doj të mirnin masat' e ndalimit bashkë me Mbrenë; u kuptua çiltazi se ata qenë udhë heqësit më të parë t' asaj lëvizëje.

Mbreti si Luan u ngre në këmbë me fytyrë t' ashperuarë ku vështrim' i tij tregon se duaj të thosh "unë jam Gjerman, Mbret' i kombit bujar dhe jam i zoti t' i u tregoj vëndin trathëtorëve që s' heqën dorë së luajturi me fatin e popullit „.

Atë ças armatoset gjëndija dhe në Kryesi të Kumandanit Hollandes qarkohen vëndet strotigjike. Esati gatiti Otomobilin dhe natet u nis të shkonte por e gjeti rugën të zënë, Në mëngjes i u rrëthua shtëpia. Kundreshton me një fuqi kusarësh, me zhandërmà Tiranas duke mos i u bindur urdhërit e Qeverrisë gati të çelë luftë në kryeqytet. Zhandërmaria Toskë, Hollandezët me fuqinë nationale i qëllojnë rrëptësisht dhe mb'anë tjatër e proponuane t'epet në dorë të Qeverrisë. Esati nuk'u bint dhe filloj lufta dhe mbasi vazhdoi 15 minuta, i u bombadis shtëpia me topa.

Atë herë gati qirt flamurin'e badhë dhe u lutet të dorëzohet n'ushtërinë Italiyne. Lutja nuk'i u dëgjuat dhe e kapnë ushtarët Austriakë. Një oficer Italjan me flamurin



e bardhë në majë të dyfekut bashkë me Esatin dhe me të shoqen e tij me një baule në dorë e shpunë në një avullore Austriake. Italia nguli këmbë sa ja mori Austrisë në dorëzim me pahir. Më të nesëret Esatin e qirnë prapë në tokë më anë të perëndimit e Durrësit dhe shkoi ne kryengrijtës për të përfunduar qëllimet si i pari udhë heqës i tyrej.

Në Kryeqytet u proklamua shtet'i rrethimit, u forcuanë vëndet strategjike me topa, mitraloza dhe forteza të plota. Fuqi e Gjendarmerisë me vulnetarë të cilet ishin dërguar në Shijak, më 22 Maj lëftuanë rreptësisht. Rebelët të përbërë prej popullsisë e katundeve të shoqëruarë prej Gjendarmërisë e Shjakut, Tiranës, Kavajës dhe të qerkeve të turej të cilët lëftonin aqë rreptësisht sa Qeverria shtrëngohet të dërgojë një tjatër fuqi. Më 23 Maj, fuqia nationale e armatosur në Rrashbull lëftoi rreptësisht gjith'atë dite pa ujë dhe mësëfundi si mbenë pa fishekë, u qarkuanë prej rrebelëvet. Nga fuqia nationale, Ceno Sharra, shumë të tjerë ranë dëshmorë edhe ca ng'ata ranë në duarë të tyrej. Fuqia nationale e përbërë prej Toskëvet, Kosovarëvet dhe prej Malësorëvet, me ndihmën e bumbar-



dimit që bëhej nga kryeqyteti, ish fuqia mundëse nga Qeverria. Në Durrës ish qetësi kur madhësi e tij kthehej nga fortezat, gjën në Pallatë Ambasador' e Italisë i cili i tha "vijnë 12 mijë kryengrijtës, ushtërinë do t'a shpiemë në vaporr, u lutem të vindi dhe lartësia e juaj". N'atëçast vjen dhe Ambasador'i Austrisë i cili me habi të madhe i porësiti Madhësisë ato fjalë. Lartësia ra në dyshim nga fjëlët e të dy ambasadorëvet të cilët për të parën herë u gjëndë në një mejtim. Kish një orë kur Tomsoni shkoi në vaporr dhe së bashku me lartësinë erdhë në Pallatë. Të shetunë mbrëma më 23, lufta u pushua dhe për të marrë vesh me kryengrijtësit u dërguanë Kontrollorët të cilët me nxitim sa po kishin ardhur nga Konferenca e Korfuzit. Esati me anë të spiunëve të tij vuajti shumë së shëtituri në për të shkretët katundarë duk'e i proponuarë në Kuran të shënjt e në kryq që të xgjidhnin njérën, i kish egërsuar aqë shumë sa u ish trubulluar mejtimi dhe nukë lodhishnë së kërkuar nga Kontrollorët "duan Babën". Me gjithë propagandat e organizuara prej feodalëvet në një mënyrë si mbas idesë e njëit populli të pa stërvitur dhe më shumë fanatik i rrëpët në fe, por



mos bashkimi që vazhdonte me kohë në mejtimet e Kontrollorëvet për sa i përket çështëjes kombëtare, shkakëtoi mos bindëjën e rrebelëvet.

Në Durrës, shtet'i rrethimit përbahet me diçiplinë të fortë ng'an'e Hollandezëve të cilët me 3 Qershori burgosën 2 Oficerë Italianë me q'ata u zunë në një kohë kur me shënja drite merreshin vesh me rrebelët.

Barron Aliotti, për këtë shkak bën ndërhyrje në Qeverrinë Shqipëtar. Tomsoni i kundrështoi dnk' e i thënë "Shqipëria është një Shtet indipendent dhe unë jam një nga kumandarët e atij Shteti, konferenc' e Llondrës ja preu ç' do marrëdhënëje që kish me Turqinë. Kapitalasionet shkonit e i kërkoni në Turqi se këtu është Shhipéri". Këto fjalë burrërish të Tomsonit e fjesht kombëtar shkakëtuanë që Barroni pa mos mundur t' i apë përgjigjëjë iku krya ulur.

Në këtë kohë, krye Ministër Turhan Pasha kish marrë si M. P. Brendëshm Aqif Pashën si dhe Myfitin ku për pranimin e e të fundit u bëna miaft kundrështime por nga proponim' i Italisë q' u bë aq' i rrëpët, u pranua për kundrazi dëshiravet kombëtare.



Kryengrijtija e vogël e Shijakut e formuarë prej feodalëvet, dal nga dal u gjërësua në Kavajë, Tiranë, Peqin, Dubre dhe Sulovë.

Qeverria me qëllim t' i bindë me të mirë u kish dhënë një afat deri më 14 Qorshor. Mos bindëja e tyrej shkakëtoi marrëjen e masavet. Ahmet Mati, nga Tirana, Bib Doda, nga Kavaja, Azis Vrioni nga Lushnja dhe populli besnik i Elbasanit ng' an' e tyrej sulmuani mbi rrebelët. Përfundim' i luftës që po fillohet më të katër së paba të rrebelëvet është shpres' e madhe të sjellë pemëtë mira duk' e i bindur rrebelët. Lufta filloi por rrebelët sulmojnë rreptësish. Kundrështim' i Qeverrisë bën ma të mbëdhhatë dëme nér rrebelë por'ata si mizëria pa prerë, sulen mbi tela. Trimëria patriotike e famëshe ne Isa Bulatinit me Tomsonë i dhanjë kurrajo të plotë fuqisë nationale sa u thyen rrebelët.

Fatkeqësisht Tomsoni që përpinqet aqë shumë për lirinë kombëtare ra dëshmo. Zia e madhe mbuloi dhënë për humbëjen e të vetëmit besnik udhëheqës.

Madhësi' e tij shkoi në luftë dhe zuri vend' e Tomsonit. Në këtë kohë fitimet e nacionalëvet qenë aq të miafta sa një par-



kicë idealistër thyen kreit rrebelët deri përtej Urën e Durrësit. Këtu ranë shumë dëshmorë si Kamber Elbasani dhe Ajdin Draga. Lufta njati plotësisht 15 orë. Ahmet Mati ju qas Tiranës si dhe Bib Doda Kavajës.

M' anë tjetër Azis Vrioni i zëmëruarë për mos gatitëjen e njëi kolltukut në rrastin e formimit të Ministrisë u dorëzoi rrebelëvet Lushnjën strategjike.

Një grusht trazimtarë, t' armatosur mirë me armët e qeverrisë, të shtyjtur prej feodalevet, me flamurin e Turkut në dorë ; duk' e përsituar nga që fuqia e rregulluar gjëndej në luftën e vizevet të Jugës arrijtin të gjërësojnë pushtimin e tyre duk' e përkrahur nga gjithë fanatikët fetarë të kujdo vendi.

Mbasi rrebelët muarrë në dorëzim pa fare kundrështim Lushnjën nga Azis Vrioni dhe u plotësuanë ashtu dh me fuqinë ekonomike, muarrë guximin e plotë t' i hidhen Elbasanit ku pas njëj lufte të mirë e pushtuanë dhe atë qytet të bukur e plot me ndienja patriotike.

Mbasi i shkretuanë gjith' ato vënde me ç' do mënyrë dhe zhduknë kreit idealin e lulezuar kombëtar me barbarizmat e tyrej,



i u reshtnë Myzeqesë e begatëshme duk' e grabitur pasurin' e të varfërit popull.

Luft' e Myzeqesë pati një rëndësi të madhe, por fatkeqësisht ù trathëtua plotësisht. Komandant i Qeverrisë Besim Koka bëri një pllan në të cilin shënonë që Hysni Toska do të mbaj më krah të djathët duk' e hedhur lumin e Semanit. Bektash Cakrani më krah të mëngjër nga Libofsha do të zinte qafën e Manastirit t' Ardenicës. Të dy topat q' ishin në kumandë të Hollandezëvet duaj të qëllonin Brostarin duk' e mbrojtur krahan e mëngjër të Beklashit.

Në këtë mënyrë filloi lufta më të gjith anët me pushkë e top.

Ky pllan që mejtuarë fort mirë dhë përfundim'i përpjekëjet pa dyshim duaj të silte dobi. Por fatkeqësisht veprimi prapagandave të huaj në fushë të luftës prej të parëvet, e prej kumandarëvet, mos. hedhëj' e Hysniut në lumë nga që lundrat i kishin zënë kryengrijtësit si dhë ajo m'e madhëja që Bektashi nukë desh të dilte nga Libofsha që t'i binte Manastirit; e prunë punën mij aft në dyshim.

Mos pranim i Bektashit këtë urdhër, hapi një dyshim të math më të dy anët sa



fuqia luftëtare thoshin sheshazi se ay është bashkuar me kryengrijtësit.

Më pastaj, Major Ziai me Vlonjat, të bashkuar me Bektashin muarrë Manastirin e Ardenicës. Nje fuqi Vlonjatë e ardhur më vonë, hodhi lumin në Libofshë dhe më të nëserët u nis një top për n'ardenicë.

Fuqia e Fierit, u mundua shumë deri satë bëjë lundra të rea e më darkë mezi u hodhë bashkë me kumandën e përgjithëshme e me një top. Të Mbërkurën më 17 Korrik, Vlonjatë me një top u ngrysnë në Brostar, t'Enjëten në mënjugjes krah'i djathët Hysni Toska do të kabërxente lumin në Kuçi dhe do të qëndronte në Kosovë. Në krah të mënjugjer Bektashi do të merrte gjithë malin e Ardenicës edhe do të zbriste deri në Piza i cili është një orë e gjysmë afër Lushnjës. Ziai, do të zbriste nga Ardenica në Bubllimë dhe do të vinte deri në Bishtqethëm. Topi nga Manastiri do të vinte në Brostar. Kumandant' i përgjithshm u ngroga Brostari e me anë të Kallëmit-Imshit për në Kruatë për të bashkuar me fuqinë qëndrore. Hysniu nuk'e kabërxeu lumin nga Kuçi se i kish prerë udhën një fuqi kryengrijtëse. Azem Bellua ish dërguar në Ba-



bonja për të zënë Ikonom Leshin, por ay ish rrethuar dhe kërkon ndihmë ku i u dërgua Ziai.

Fuqia luftëtare në këtë mënyrë e përndarë, pa mos marrur vesh me njëri tjetrin më një gradë sa kumand' e përgjithëshme nukë dinte se ku ish fuqi e vetë, shkakëtoi çkatërimin e rregullit; gjith' ashtu kush e kush bënte kumandë më vete.

Fuqia e Beratit nukë po vjen, Ziai mërguar, topi në mes të urës, Baktashi s'dihet ku është, Hysniu ngëci. Vlonjatë zunë Bregun më të lartë dhe po lëftojnë ashpërisht me fuqin'e shumtë të rrebelëvot. Kërkojnë ndihmë por përfat të keq Kumanda e përgjithëshme nuk'u dërgon as fishekë as bukë.

Vlora bën gati fuqi tiatër por Feizi Beu që kish vatur në Fier dhe bën Kumandë më kokë të tij i cili shkruan duk'e thënë punavetemirë dhe fuqi tjatër nukë duhet. Nuredin Beu me Hysninë po ballojnë trimërisht duk'e sigruar anën e tyrej, por një fuqi e Bektashit i dolli përpara fortezës e fuqisë së Hysniut ku i flet Duk Rushiti që ish ng'an' e Bektashit me zë të lartë Fetahut që ish ng'an' e Hysniut duk'e thënë "ku je more F'etah! epi se do vriti,,. Për veç kundreshtimi por edhe rënëja e borisë ng'



an'e Bektashit e cila ish e ndaluar, shtrëngoi heqëjen e Hysniut duk'e lënë vëndin rrebelëvet. Më pastaj u prapsën njëri pastjatërit të gjithë ku erdhë në Fier dhe pastaj në Vlorë.

Luft' e Myzeqesë e cila ish një shpres'e dyjtë dhe shumë e madhe për triunfin e organit Qeverritar, mbaroi me fitimin e rrebelavet duk' e rënë deshmor shumë patriotër të ndershm si Tafil Hoshtima datur nga xhimnasio e Janinës, plagosëj e Seit Qemalit e shumë ranë skllevër të cilët me gjithë që i kishin vënë në burgje të rendë por donin t' i varnin se ata ishin anuësit e Flamurit me Zhgabë.

Të dy kryengrijtëjet e mbëdhë, janë duk' e u marrë veshë, kanë pasë, kanë marrë dhënëje me anë të feodalevet të cilët kanë bërë zakon të thëthijnë gjakun e popullit dhe bëjnë sulme të rrepta. Sùlm'i bërë në Tatzat e në qafë të Ckërficës praj Grekërët u shkakëtua pushtim i Tatzatit e i Borshit, të cilat i dogji por Çerçis Topulli me Kurveleshas e me Kapedan Salinë bënë shumë therori derisa i muarrë prapë këto vënne. Nga Korça bëhen lufëtime të shumta, gjith'ashtu dhe më çdo anë të Shqipërisë.



Vazhdim i të dy kryengrijtëjet e poshtërme te lidhura njëra me tiatërnë pernë çpresën e plotë të lirimit e vizevet Jugore.

U dërgua një komision për të marrë vesh me Hafes Alinë ku erdhi gati në marrëveshëje por paraja e shumtë e trathëtisë q'u nda në popull, shkakëtoi mos bindëjen e rrebelevet të cilët po gjërësohen. Fuqia-Grekë po unjet poshtë, Berati nukë po tregon një gjallëri kombëtarë, Bib Doda dhe Ahmet Mati i përndanë fuqitë e tyrej.

Qeverria, atëherë tue parë këtë pozitë, drejtohet në fuqit' e mbëdha duk' e kërkuar të paktën 5 qint ushtarë Ndërkombëtarë të cilët të dërgohen në Shqipëri për të bërë veprimet e Qetësisë e të Policisë si mbas shëmbllës e Shkodërsë.

Si fuqit' e mbedha gjith ashtu dhe Ambassadorët e tyre në kryeqytet nukë vijnë në një mejtim.

Rrebelet i qasen Beratit dhe grekërit po i hyjnë Tepelenës. Shqipëtarët besnikër me gjithë që mbenë në mest të dy zjarretët të tmeruara por po leftojnë trimërisht. Çpallet Qark i rrethimit në Vlorë dhe behen forteza përqark qytetit.

Shënim: Bërej'e fortezavet vërtetojnë nevojën për të cilën Qemali thoshte në kohë të fundit, «mbani Vijosën».



Më 30 Qershor Ismail Qemali shkoi për të parën herë në Durrës dhe pas ca ditëvet u mbëlodhë në Pallatë ku që gati dhe i vëllai Tomsonit që kish ardhur për të marrë trupin' e tij.

Kryengritëjet dhe ngjarëjet që po vahdojnë në Shqipëri t' organizuara prej Italisë Francës dhe Rúsisë me shoqe formuanë shkakun kryesor të fillimit e njëi lufte mondiale e cila u tregua nga lëvizejet ushtëriake të Perandorivet qëndrore. Trashëgimtar' i Austrisë vritet prej Sqehet e Sërbëvet ku u dërgua në varrimin e tij n'Austri Turhan Pasha i cili shëtiti shumë kryeqytete për të bërë marrëveshëje rrotull trazimevet e fundit të Shqipërisë.

Mb'anë tjetër vijmë në luftë të Beratit ku rrebolët shtrëngojnë marrëjen e qytetit. Azis Virioni, kryetar' i Katundarisë Ilias Virioni të bashkuar me parësinë e qytetit vendosnë dorëzimin e qytetit pa luftë duk' e lajmëruar Qeverrin' e vëndit në këtë mënyrë.

Prefekt' i vëndit Z. Behxhet armatosi popullin dhe i kundrështoi rrebelët pa mos dëgjuar fjalën e Belerëvet. Merret Lapardha ja dhe Velabishti me luftë ku ra dëshmor Muharrem Leshi dhe të tjerë.



Një fuqi tjatër rrëbelësh arrijti në Korçë dhe Korçarët lëftuanë rrëptësisht më të dy fuqitë. Devollasit dhe Skraparasit ranë në menjtim të fëmijëvet dhe iknë me mëndëje marrë. Më 6 Ollanar 914 natën e hënë rra prapë Korça në duar t' armikut shekullor. Rrebelët aqë panë sa i dhanë Korçën armikut dhe humnë si vesa përpëra Diellit. Grekërit duke vrar' e duk' e therur arrijtin në Starovë e në Kolonjë dhe më pastaj në Skrapar. Paskallite Timorriciotë u përpoqnë trimërisht. Më 12 Ollanar 914 fuqia Greke dogji me radhë Rohovën, Dorës, Prishtës, Zagérzan, Sevraj, Malint, Muzhenckë, Koprenckë, Lapaj, Gërmenj, Gjergjo, Backë, Staroveckë, Helmës, Melekë, Nikolicë, Nikollar, Potom, Kapinoyë, Krušovë, Turbëhove dhe të tjera vënde deri sa arrijtin te guri prerës.

Berati po lëftton, Skrapallitë që ishin në Berat iknë nga shkaku i fëmijeve të tyrej duk' e lënë vëndin zbrazët. Më 12 Ollanar më darkë Berati rrëthohet; Sheh Qerimi, Saliu e Shuaipi ftojnë rrëbelët në qytet më 13 Ollanar 914. Në këtë ditë pushtohet dhe Fieri nga Shehët e Karbunarës e të Lushnjës.

Në këtë kohë, mb' anë tjatër Greqia po



sulmon. Qeverria merr masa t' asnjeanëshme dhe mbasi lajmëroi fuqit' e mbëdha në këtë mënyrë u shtrëngua të heqë fuqinë që pati në Kurvelesh në Tepelënë. Popull' i këtyrej vizeve i cili po u bën ballë të dy zjarreve me ç' do therrori u dëshpërua fort duk' e i u prishur fuqia morale. Tepelena u la fare pa luftë me që gjëndëja iku pas fuqisë e Qeverrisë; gjith' ashtu dhe Kurveleshi më pakë luftime muarrë fëmijët e tyrej duk' e kaluar në kufi të Vlorës. Tepelena më 12 Ollonar, Kuçi e Kurveleshi ranë prap në duar t' armikut shekrlor i cili i bashkuar më një kombasit të krishterë vranë, therrë sa mundë, plaçkinë tërë kamëjen e bashk kombasvet Myslimanë, gjith' ashtu dogji rrënjësh gjithë katundet, qytetet bujarë t' atyrej vizevet duk' e vënë më në funt në majë të bajonetavet e prehta dhe gjithë foshnjët e mbetur pa njeri.

Si Qeverria ashtu dhe katundaritë s'panë më gjë tjeter të bënin për veç njëi protestimi në fuqi të mbëdha në këtë mënyrë "sulm" i ushtërisë greke kurdoherë nënë maskën Epirote, me bajonetë e me urë të zjarrtë në dorë ka vrarë shumë dhe ka shtrënguar 100 mijë frymë Shqipëtarë të lënë shtëpit' e tyrej në mëst të tymit e të




flakës dhe të mbëlidhen në Vlorë e në qarkun e saj. Kodrat, pyjet, anët e lumit. Vijosa janë mbushur, fatkeqër të vdesën urie, të tmeruar e të dëshpëruar vijnë të kërkojnë n' emër të njërzisë mëshirën e fundit t' Evropës duke lutur/ të ndalojnë këtë barbarizmë e këtë mizori kreit jashtë qytetërimit të shekullit e sotmë „.

Mirë po kush degjon! Groku zuri me radhë duk' e diegur Shtëpëzin, Goron, Picar, Medar, Kolonjë, Kapariel, Golem, Progonat, Lekdush, Gusmar, Nivicë, Luzat, Hormovë, Veliqot, Turan, Memaliaj, Dukai, Fterrë, Çurraj, Borsh, Tatzat, Kuç, Kallarat, si dhe Tepelenën të cilat u bënë shoqë me Leskovikun, Delvinë, Përmet, Gjirkastër, e të tjera. Sulm' i Greqisë përmbi krahinën e Lopsit u kundreshtua. sa kaqë herë trimërisht prej atyrej katundevet ku u bënë therorë shumë patriotë të vërtetë nga katundet e Lopesit.

Formim'i komitetit në Vlorë

Vjen me të çpejt Ismail Qemali në Vlorë dhe pas nisiativës që mori, mbëlidhen në Katundari më 15 Ollonar 914 gjithë populli i vizevet të ndryshme. Mori fjalën ni-



siatori duk'e thënë: Në mos jemi të zotërit për luftë, a nukë jemi as për fjalë? Vlora që ngrijti më parë flamurin e lirisë sot është fort e hidhruarë nga shkaku që sheh me mijera bashk' atdhetarë të mjerë, të djegur e të ndjekur, Shqipëtarët e Shqipëria sot gjënden në një hall e në një rrezik të pa treguar. Këjo mbëlëdheje lypset të gjëjë mënyrën e shpëtimit të Shqipërisë. Ju lutem cili do prej jush të thotë mendimin e tij: më nj'anë Grekërit, mb'anë tjatër rrebelët n'a kanë shtrënguar më një vënt të pak'e të ngushtë. Mijëra njëres ndodhen në mjerime të këqia. Më nj'anë deti dhe mb'anë tjatër armiqitë. Kush është atdhetar të përpinqemi së bashku të kapërxjmë këtë rrezik duk'e i thënë Evropës që ne kemi të ndrejtë të rrojmë dhe të kërkojmë prej tyrej çdo farë ndihme. Çtoi akoma Qemali — kur u bë Shqipëria tham jemi Shqipëtarë. Tani po themi s'jemi e pra Evropa nuk na bën me pahir „.

Sotir Peçi e të tjerë i' u lutnë Qemalit. t'a kthilloj mire, a do të ketë marrëdhënie me Mbretin dhe me Qeverrinë ky Komitet? në do të jetë i pa varur, dotë karakterizohet si një Qeverri e re dhe kryengrijtëse.

Qemali tha-neve skemi qëllim të bëjmë.



një Mbretëri e një Qeverri të re, neve ndihmat i kemi për të mbështetur të njera tjatra —.

Mbasi u folë shumë fjalë të tjera mbi këtë qëllim, u vendos formimi i Komisionit i përbërë prej Delegatëvet e kujdo qyteti të cilët u bënë 32 vetë. Mbeledhëj'e parë u bë më 16 të muajit ku xgjodhë si kryetar S. Qemalë e me vota të mbëshehëta nën kryetar P. Meksin e Namik Selimin. Komiteti me vota të plota vendosi të ndahen 3 Komisione të ndryshmë nga të cilët,

- 1º Një Komision për t'u kujdesuar për ushtarë, vetëdashës, municione e tji.
- 2º Një Komision për ushqimin'e ushtërisë e të vulnetarëvet e t'atyrej fëmijëvet muhaxhirë që burrat e tyerej marrën pjesë në luftë.
- 3º Një Komision politikë për të lypur ndihma materiale për muhaxhirët e morale për shpëtimin e Shqipërisë nga fuqit'e mbëdha.

Komiteti bëri këtë thirrje te madhësia e tij Mbreti. të Kontrollorët dhe pranë fuqivët embëdha. Nukë do të shkojmë patrëguar këtu me pakë fjalë që Ismail Qemali pati një qëllim të fundit të shënjtë



për shpëtimin e Shqipërisë dhe gjithë më atë qëllim formoi komitetin. Por mjerisht populli nukë pati kapasitet t' a çmojë dhe kështu nukë gjeti mbështetëje as brënda as dhe jashtë shqipërisë.

“ THIRRËJË „

Përfaqesonjësit e popullsisë të Vlorës, Beratit, Skraparit, Korçës, Përmetit, Kolonijs, Leskovikut, Gjirokastrës, Delvinës, Kurveleshit, Lushnjes, Himarës dhe Tepelenës të bashkuar në Vlorë votuanë bashkë risht formimin e njëi komitetit për shpëtimin popullor me anë të njëi thirrëje në miresin'e lartë të 6 fuqive të mbëdha mbrojtës dhe sipërane të Shqipëris për të vendosur marrëjen e Qeverrimit Shqipëtar përkohësisht ng'an'e Komisionit të Kontrollit me cilësinë e përfaqësimit të fuqive e mbëdha dhe marrëjen e çdo masë tjetër që do të lypin punët. Komiteti duk'e i bame ditur Qeverriven së nderçmë sa u thanë më naltë dhe me qënë i bësuar se Kabinet'i tanishmë, asnonjë Kabinet tjatër Shqipëtar dot'ish i zoti me shëruar krizën e Shqipërisë më këto kohë i lutet Drejtërisë së naltë për më i dhanë kësaj krizë një xgjidhëje të fortë e të çpejtë rënjesore dhe



pa humbë kohë më ja vu përbarrë Komisionit Kontrollor syndimin e Shqipëris se nga mejtimi t'onë këjo është e yetëmin masë që munt të përmbajë sipëraninë t'onë të ligjëshm mbi fron të sigurojë bashkimin komkëtar e tërësin'e vëndit dhe të librojë prej vdekëjes së domosdoshmë ma se 100 mijë njërs së cilët duk'ë iku nga zjarri e nga hekurë i duk'ë lënë vatrat e begatishë së tyrej q' u doqnë prej njëi fuqie të tërbuar të bashkëkombëtarëvet e tyrej e të guximsuar prej të huajvët kanë kërkuar mbrojtëje në këndin e vetëm qëjét Shqipëtarë në qytetin'e Vlorës e në qarket e saj..”

Shumë dit pas heqëjes e telegramit, i behen kundrështime komitetit nga populli për shkakse nukë zihet ndreq për ndreq Greqia. Komiteti dha prapë një telegram duk'ë çtuar “të bashkëatdhatarëvet e tyrej të shtyjtur e të ndihmuar prej Greqie ..”

Fuqia e përgatitur ng'an'e e komitetit u formua dhe po ruan në Vijosë kundra rrëbelëvet.

Fëmijët e ardhura nga vizet e pushtuara prej të dy fuqivët e mallekuara, t'aratisur, të xbathur, të xhveshur dhe t'urët po kerkojnë njeritjatërni. Kodrat e Vlorës, e të katundevet të mbushura më femijë, gra, djem e cili-



miqër të cilët me gjithë që lumi Vlorës i u tregoi shumë lehtësi e dhëmsuri po vdesën uriesh.

Gjithë këto vojtëje dhe rënimë të shkakëtuara prej feodalevet trathëtorë të së dy kryengrijtëjetëvet, të ndihmuar prej armiqvet të cilët nukë e lanë popullin të qetë t'i bindet sundimit e Qeverrisë shqipëtare në drejtim të njëj mbreti Evropian e të organizatorëvet Hollandezë dhe të vinte or e lumtërisë në popullin Shqipëtar.

Këto mjerime të mbedha, historia po i shkruan me shënje zie :

“ Më 1913-1914 të vitit, Greqia barbare e çfaqur dhe e mshëhur nënë maskën’ Epirote e shkretoi tërë Toskërinë ku s’ la katunt e qytet pa diegur, s’ la pleq’ e plaka, s’ la djem e vasha pa shkuar nënë bajonetën e prehët, nukë pushoi së vrari njërsë të pa fajshëm e më shumë se 100 mijë shpirt t’ arratisur për të shpëtuar nga mizoritë greke, muarrë anët e lumënjetëvet, të pyjetët dhe Evropa e qytetëruar e cila kurdoherë ka dashur të rrëfëhet si mbi ojtës i njërzimit; i pa të gjitha këto mjerime të shkakëtuara prej barbarëvet dhe heshti „Pra, për të mos harruar kurrë gjithë këto



mjerime, m' erdhi në mënt t' i u bëj një porësi gjithë gravet, çupavet Shqiptare që po vuajn ng' armiku të mos lodhen së kënduari Vjershën që vjen më poshtë bijvet dhe bijavet e tyrej që kur se janë në djep të cilët do bëhen fatorët/e Shqipërisë.

Flij o zëmëra ime

Flij të rritesh me të çpejtë

Flij mos qaj me ngashërimë

Të rritesh të bësh përpitetë.

Ti të derthç gjak për Atdhenë,

Me armiqt'e Shqipërisë,

Mos' e le të gjallë greknë

T'i apsh dërmënë Sërbisë.

Të dy armiqt'e Atdheut

Shqipërin'e kanë shkellur

Me gjak'u mbyt faq' e dheut

Mijëra njërsë duk' e therur.

Çdo Shqipëtar nuk' e harron,

Këtë çpagim dot'a marrë

Janinë, Kosovë e tej s'i lishon

Dotà shohën Shqipëtarë.

Ardhéja e Mbretit në Vlorë

I tërë populli ishte gatitur në Skelë kur mashëri'se tyrej më... gusht 914 ditën e Diell ora 11 pa 5 minuta vunë këmbët në mol me qëllim që madhësi, e tyrej të shohën



me syt e vet Vlorën e Toskërisë ku qëndron besnikëria m' e madhe edhe dashuria e frnit Mbretënor. Shumë oratorë të famëshm mbajtin fjalë dhe mbasi e vizituanë Ismail Qemali, oficerët, hollandezët dhe autoritetët shkuanë me radhë përfaqësonejësit e vizevet të shkeluna dhe më në funt disa zonja nga shoqërria „Shpresa Kombëtare“ duk' e i paraqitur Mbretëreshës një buqetë lule të bukura.

Jashtë qyteti kur madhëri' e tyrej janë tue u afruar, Zonja Nimet, bukuroshe shqipëtare ndofta e vogël, i u foli një vjershë aqë të mirë sa nukë mbeti njeri pa dërdhurë lot gëzimi.

Mbasi lartësitë shkuanë deri në qafë të Koçiut ku panë më syt' e tyre gjithë popullin e ardhur nga vizet e shkelura, dhuруan Madhësi' e tij 1000 Napolona flori në Komision dhe Madhësi, e saj 150 në shoqërinë Shpresa Kombëtare për t' ua dhënë muhaxhirëvet Shqipëtarë.

Ora më 7 u kthenë në mol dhe duk' e ngjatjetuar popullin' e rrjeshtuar më të dy anët shkuan për në kryeqytet.



Prap luft' e Beratit.

Rrebelët shkojnë në Gllavë të Tepelenës e cila nëmërohet Malësi e sipërme por Baba'i Teqesë Z. Myhedin me një fuqi nga Zhabokika, Rehova, Plashnik dhe Gllava u kundërshtohen. Vranë 20 rrebelë zunë dhe 92 skllavër të cilët më 31 Ollonar i dorëzuan në Vlorë. Këjo luftë patriotike dha guxim Qeverrisë e cila mbasi u muar vesh më Mallakastriotë hidhet një fuqi kombëtarë dhe më 31 të muait zë Sinjën.

Një fuqi nga Sinja nënë Kumandë të Z. Behxhet sulmoi për në Berat dhe një tjetër fuqi nënë Kumandë të Gjilardit sulmon për në Fier.

Fuqia e Beratit me pakë luftë pushtoi Beratin më 8 Gusht ditën e Shtunë në mëngjes. Rrebelët po qëllojnë rreptësisht nga hund' e fortezës vjetër por përpiekeja me sakrificë të nasionalistëve dëboi fuqinë rrebele duk' e lënë flamurin e Turkut në vënt i cili me të shpejtë u çuarr dhe në vënt të tij u ngul flamur' i shënjtë kombëtar.

Fuqia nasionale pa mos marrë masat e forta që të zinte kondrat, fuqia rrebele e bashkuar me fuqinë fanatike të vëndit u



sulë nga an' e Lapardhasë mbi Berat, fuqia nacionale u gjënt para njëi zjarmi të pa pandehur dhe u shtrëngua të hiqet në Sinjë duk' e lënë qytetin në duar të rrebelëvet më 11 të muait.

Fuqia e Fierit me shumë luftime pushtoi Fierin më 10 Gusht. Në çastin e Pushtimit shkoi një fuqi e plotë dhe zuri vatë e lumit të Dëvollit. Shkaku që shum vëtëdashës u ndanë nga këjo fuqi dhe vanë me Hysni Toskën në Kurjan dhe ca të tjerë u përndanë më kokë të tyrej, shtrëngoi fuqin' e pakë që mbeti të lërë Fierin në dorë të rrebelëvet mbasi bënë luftime të rrepëta. Hysni Toska i cili kish vatur dëri në Kurjan u hoq më të prapë pa luftë. fuqi' e Sinjës mbasi mbenë midis fuqivet rrebele hiqen në Kudhës.

Rrebelet në Vlorë.

Rrebelet dërgojnë njërs për marrë veshje në Vlerë të cilët arrijtin në 22 Gusht. Luft' e përgjithëshe kish filluar që më të ryrë të Gushtit e cila ca më shumë e çkatërrroi çështëjen shqipëtare. Qeverria gjëndej në pikë të fundit nga fuqia Financiare me shkak se prishëja pa kursim prej



Autoritetet e kish shkakëtuar të mbetet Ark'e kryeqytetit e zbrazët.

Me shkakun e fillimit të luftës e përbotëshme as Italia as dhe Austria nukë apën huan' që ishin zotuar. Me nj' anë rrëbelet mb'anë tiatër Epirotë çpallën asnjëanësin' e tyrej në luftën e përgjithëshme. Fatkëqësia më e madhe kur fillin i asaj lufte e zuri Shqipëria e famëshme si një zonjë bujare dhe e begatëshme që i kanë zili bota e tërë si me thënë kur asaj i marrosen dje- mtë, i ikëjnë nuset, i shduket pasuria dhe ajo mbetet martur në mes të katër udhëvet!.

Erdhe tham njërs nga rrëbelet përmarrëveshëje. Mbasiparësia e ndryshme u mbëlodhë në Mifol, shënuanë 5 vjetë dhe bashkë me ta shkuanë më 24 Gusht vanë në Frakull ku mbasi u muarrë vesh dhe nukë u ndreqnë dot, lanë fjalë me Prift Leshin që më 28 të muait të mbëlidhen prapë në Cakran.

Ditën e Enjëte më 27, u bë një mbële-dhëje popullore në Trepëllazë. Perfundim i bisedimit që të vazhdojë lufta e të mos digjohën kërkimet e rrebelëvet. Mbi këtë qëllim lajmërohet i tërë populli që të vijnë



në Vijosë. Fuqia do të ruajë 80 e ca vâ, të Vijosës duk' e mos lënë njeri të bëjë marrëveshëje me rrebelët. Tërë natën rrodhë tere luftarët për veç të krishterët e Vlorës. U vendos të bëhet dhe një mbëledhëje më të nesëret me shkak se pritet të vijë kryekatundi i cili ka vatë n' Itali për t' u marrë vesh me Ismail Qemalin. Më të nesëret bëhet prapë mbëledhëja duk' e qëndur dhe K. Katundi i Ali Beqiri 'që vinin nga Qemali. Shumë bisëdime të hapëta e të mbështehëta bënë dhe më në funt vendoset dërgim' i njei Komisionit për marrëveshëje e si do mos të ndreqen me kondita që rrebelët të mos shkelën në Vlorë dhe ndryshim' i flamurit të mos pranohet. Bënë marrëveshëje por nuk' u ndrejnë dot. Rrebelët kërkuanë ca njërsë me emëra të shënuarë rga Viora që të vinin prapë në Çakran më 30 Gusht.

Bëhet një tjatër mbëledhëje në shtëdi t' Abas Mezinit ku muarre pjesë vetëm Vlonjatë si dhe Eqrem Beu. Përfundim i bisëdimit që (rrebelëvet t' u kundërshtojmë, të vritemi mënder dhe të mos t'a ndryshojmë flamurin kombëtar se do të mbetemi në rrezik. Të mi rrëmi vesh dhe në ua arthtë mirë munt të ndreqemi. Ndryshtë Vijosën



të mos t'a lëmë. Të dërgohen njërës të dijtur e të besës po ata duhet të kenë të ndrejtë të këmbejnë fjalë e jo të japën vëndim dhë nukë do të kenë të ndrejtë të bëjnë paqe pa mos u pyetur populli).

Dërgohen për marrëveshëje në Cakran Elmas Kanina, Ibrahim Avdullahu, Qamil Risilia, Duro Shaska, Ali Beqiri, Alem Memeti dhe Mahmut Myftiu. Mbas bisëdimeve që bënë kthehe Komisioni duk' e lajmëruar popullin q'n bë bashkimi si mbas dëshirës kombëtare. Krici pushka që në Cakran e deri në Vjosë.

Më 31 Gusht në mënges pleqt' e përmëndur muarë Prefekturën në dorë duk' e i a njoftuar Prefektit kashkimin me rrëbelët. Prefekti mbasi lajmëroi Kushullat dhe nëpunësit, u hoq në punë të vetë. Marrëveshejen dhe bashkimin në mënyrë të deklarueme e dëshëronte si populli ashtu dlié Qeverria mbasi fuqia morale e materiale ishin-fikur.

Komisioni edhe nukë kish çpallur gjë akoma rrotull përfundimevet e marrëveshëjevet të bëra midis të dy anëvet por ngjatija dhe xbythëja e marrëveshëjevet e cila shkakëtoi vatëjen e tyrej 3 herë në rrëbelë ndiq dotë qirte deri më në funt. Dihej sigurisht se Komisionet në fjalë nukë dotë.



mundën tē dalēn jashtē kompetencēs e dhēnur prej popullit rriedhur nga pērfundim' i bisēdimēve tē tyrej, nukē sillte kaqē dyshim nē sigurimin e çeshtējeve kryesore tē shēnjave kombētare.

Sigurim' i kētij gjukimi i bazuar nē pērfundimet e bisēdimēvet u pērgēnjēshtrua kur ora mē 4 tē ditēs qē Prefektura u muar nē dorēzim u unj flamuri me zhgabē si nē Prefekturē ashtu nē Katundari duk' e vēnē nē vēnt tē tij flamuri kuq-zi me urdhēr natyrisht tē komisionit.

Shumē njérēs kundrēshtuanē duk' e mos pranuar ndryshimin e flamurit por komisiōni s' ka kohē t' u apē spiegime hollēsisht mē qē ata janē tē nxēnē me pregatitējet e pritējēs tē bashkimtarēvet tē cilēt me minuta janē duk' e ardhur.

Pritēja pa durim arrijti tē mbarehet kur ora mē 6 tē ditēs 1 vjesht Irē arrijnē rrebelēt tē bashkuar me njerēzit e dērguar mē parē pēr pritēje. Koha sa po ish mugulluar, dy minuta mē vonē nga digjim' i zerit tē trumbetave arrijtin tē radhitur njē tufē rrebelē parpara Prefekturēs tē cilēt u prinē mē ndor armēsh nga gjendarmeria e vēndit.

Errēsira e natēs nukē tē lij tē shikoje



mirë atë pamëje të tmeruar kur duk' e valuar në duar të tyrej flamur' i Turqisë qarkuanë Prefekturën.

Një ngjarëje e tmeruar jashtë shpresës, mejtimit dhe llogjikut e gjukimit të njerezisë nxiu atë natë aqë të kthjellët sa nukë shihnim njeri tjeterin, nukë digjoni gjë tjatër në mest të gjith' atij rrëmeti për veç zerit e mëkët të trumbetave. Brënda në 10 minuta u pushtua qyteti prej 1500 njerës të mallëkuar t' armatosur me municione të shuma.

Pas pakë minutavet bisëdim që bëri Komisioni me kryetarët e tyrej të quajturit. Mustafa aga, xhenabi Adili dhe Dervish Elbasani, shkuanë në shtëpi t' Osmën Haxhit.

Populli miaft i dëshpëruar duk' e gjikuar sigurisht trathëtinë e shkakëtarëvet që suallë këtë gjëndëje të rrezikëshme shkuanë pranë tyrej duk' e sjellur punën gati në vrasëje të tyrej. Por u ndaluanë nga gjëndëja e shumtë e të mallëkuarvet që po rrudhej akoma s' ardhuri në qytet.

Më të nesëret të Mërkurën ora më $9\frac{1}{2}$ shihet që sa po valon flamur' i Turqisë jashtë dritares e zyrës qertare. Një shumicë nacionalë kërkuanë ndalimin e të tillë



marrëziravet duk' e autorizuar të ngrijturit e flamurit kombëtar por Mustajai u tha "unë domosdo do punoj pas programit që kam, kush të mos jet i kënaqurë të hiqet mënj' anë.

Pamja, fytyra e qytetit dhe e njerëzis kreit u ndryshua kur shihje të vartur në më të shumat e portëravet kush flamur e Italisë e kush t' Austrisë si dhe njërs me kësula të kuqe në kokë.

Populli i krahinave të Vlorës i mbële-dhur n' urë të Drashovicës qe gati të bëjë sulm mbi rrebelët dhe mbi shdukëjen e të shkakëtarëvet e trathëtisë por u ndaluan me shkak që një gjak i tilli midis vëllait me vëlla pa dyshim duaj të shkaktonte një rrezik më të math duk' e daluar Italia në Vlorë me shpejti.

Ky shkak u çtoi guximin fuqis' e mallëkuar të varën në Prefekturë më 3 të Vjeshtës, ora $12 \frac{1}{2}$ flamur'e Turkut mbasi u zbrit flamuri kuq-zi hombëtar i cili jetoi, Valoi në Vlorë 21 muaj e 5 dite.

Mbasi rrebelet vunë si kryetar të komisionit Osmën, Haxhinë, dogjnë tërë kartërat shqip, dhe shkuanë të shtrënguarë prej konsullatavet Italiano Austriake duk'e lënë sundimin e vëndit në duarë të komisionit.



Mërgim'i Mbretit përkohësisht nga Shqipërla.

Pas rënëjes e Vlorës nënë sundimin e rrezikshme të rrebelëvet, i u reshtnë Durrësit ku mbas luftimeve të rrepta i dërgojnë një ultimatum Qeverrisë me anë të së cilës kërkojnë pa tjatër që shpëtimtar i kombit Mbreti të lërë sa më parë Durrësin. Mbasi si tham më lart gjëndëj'e fuqisë ekonomike ish më një shkallë po thua ca më keq nga gjithë të tjerat. Minister i financave kish vatur n'Itali për të marrë sumën'e mbetur nga huaja q'ish zotuar për të dhënë ku ndënji kohë të gjatë. Më në funt u kthe pa të holla mbasi mori çfaqëjen e saj e cila ka qëllim t'a çkatërrojë shtetin Shqipëtar duk'e dashur të bëhet zot në tokën e begatëshme të Shqipërisë.

Për t'i u dhënë një funt të çpejtë gjarëjet e Shqipëri natyrisht në dëmin e atdheut t'onë vendosën ambasatorët e kontrollorët duk'e çfaqur se në këtë gjëndëje të kritikëshme të Shqipërisë fuqit'e mbëdhës'kanë se ç't'i bëjnë. Kshillojnë Madhësin'e tij të hiqet për ca kohë nga Shqipëria. Madhësi e tij mbëlodhi kskillën Ministrore dhe u tha "nga fështirësia e gjëndëjes nukë sheh tjatër përvëç se - të mërgohet.



për ca kohë. Për të prishurat e ushtërisë nukë gjënden të holla „.

Natyrisht u vendos ikëj'e Mbretit e cila me anë të kontrollëvet i u njoftua rrebelëvet e mallëkuar duk'e i u çtuat se syndim'i Shqipërisë dotë jet në duar të tyrej.

Madhësia e tij mbasi lajmëroi fuqit'e Mbëdha në këtë mënyrë, nga kamj'e tij pagoi rrugat e ushtarëvet, me dëshprin të mathë unji flamuriu kombëtar q'ish vartur në Pallatë dhe më 3 të vjeshtës • I^ë ora më 9 $\frac{1}{2}$ me përdorime të popullit shkuanë për venëdik.

Proklollamimi që publikoi Mreti para se të ikëjë

“Shqipetarë ? Kur Delegatët t'uaj erdhë me m'a paraqitë kurorën e Shqipërisë, un'u përgjegja, me uzdajë thirrëjes të njëj popullit bujar dhe që më lyptë me ju shoqëruar në veprime te ngjallurit të kombit tij.

Unë erdha të ju, i shtymun prej më të flakërueshmit dëshirë, me ju ndihur në këtë punë Atdhetarë. Më keni parë qysh në fillim duk'e ju dhënë kreit për rregullimin e vendit t'uaj me dëshirë që me ju përkujdesë me syndim të mirë e në



ndrejtësi mbaras për të gjithë. Por fat-zezime erdhë me na trubulluar punën t'onë të përbashkëme. Do njërës' të ver buëm prej zmirevet nukë kupetuanë rëndësin' e përdorimevet të rea e s' deshnë me i zënë bosë njëi sundimit të ri. Për funt edhe lufta që krici n'Evropë e ngatëroi edhe më tepër gjëndëjen t' onë. Kamte menduar pra që mos me lënë të pa kryeme veprën së cisës dua me i kushtu të gjithë fuqinë e jetën t' ime; kishte me qënë më mirë që unë të shkoj për një kohë në pérëndim. Por t'a dini se prej së largut, si prej së afërmit un'i kam për të pasë vëç se një mejtim atë që me punuar për përparimin e fisnikut, dhe eroikut mëmëdheut t' ënë. Deri sa unë vonoj, Komisioni Internacional i kontrollit i çuem prej Evropës që ka krijuar Shqipërinë t'onë, ka marrë në dorë sundimin,,.

Fat'i Shqipërisë në duar të rrebelëvet, vjetëjet e popullit, Qeverria rrebele.

Shqipëria e famëshme, vënt i Shqipëtarëvet eroikë dhe trima të cilët kanë mundur të shpëtojnë Mëmëdhenë e dashur e



të vlefëshm, flamurin' e shënjtë kombëtar të tyrej ng' armiqtë shekullorë Rumanët, Shqehtë, Turqit, sot në një kohë më me rëndësi, më delikate dhe më e rrezikëshme i suallë vetë me duar' e tyrej Mëmëdheut e vetë më të mbëdhatë rrezike duk' e vënë në veprim idetë antipatriotike t' armiqvet shekullor të kombit.

Shqipëria e Shqipëtarëvet eroikër e themeluar, e bazuar në prinsipin Kombëtar me një Mbret Evropian dhe me organizatorë të famëshm Hollandezë kish arrijtnr, doj t'arrinte me të çpejtë në një shkallë të duhur të lulëzimit dhe të përparimit Kombëtar për të cilën ka nevojë të domosdoshmë gjallërimi, nderiç ekonomik dhe njërzor Konëbëtar.

Fatkeqësishët një tufë luari nga juga, një Vark shqavunësh nga vëndet më fisnike të Shqipëris'së mesme shkakëtnanë çlatërrimin e këtij organi të shënjtë dhe përparimtar i cili mbi themelë të çolikta të gjakut e tyrej kish siguruar jetën, nderin njërzor e kombëtar; duk'e shërbyer mejtimit trathëtor të feodalëvet gjakpirës të shtyjtur ng'armiqtë.

Oh sa dëshperime ! qush u shduk vallë ajo liri, ai lylëzim nga Mëmëdheu ? sot në këtë ditë fat keqe, më çdo anë të Shqipë-



risë që të vështrosh; më hidhrim të math dotë shoç një Zjarr, një flakë, një tym dhe një trubullim. Do digjosh një vaj e ulërimë, thirrëje, zi, varfëri, e cila e ka qarkuar më të katër anët Shqipërin's dashur.

Të dy fuqitë'e malëkuara të cilat pa drejtësisht çfaqnë mosbesimin e organit fjesht Kombëtar me kryengrijëjt gjakësore e barbare më gjithë që më çkatërrimin i shënjavet kryesore Kombëtare shkakëtuan më të madhin rrezik t'Atdheut t'onë të sigruar por theroritë gjakësorë midis vëllait më vëlla duk'ë përpiekur njëri për babën e tjatëri për papën, njëri për din e tjatëri për kryq, shkakëtuanë vazhdimin e grindëjvet antikombëtarë deri më një kohë mjaf të gjatë.

Kësaj gjëndëje anormale të kritikëshmë nukë munt t'i epet as një lloj përfytyrimi më që të gjitha janë jashtëllogjikut duk'ë parë se humbi ndrejtësia, vriten theren njërs të zgjuar kombëtarë dhe burgosen njërs në katoj, u vihet njërzisë frëra në gojë prej njërs barbarë dhe antillogjikë-kombëtarë.

Pra për të mundur të përjashtohet hidhrim'i zëmërsë nga përfytyrimet e ngjarëjvet të sotme m'erdhi në mënt të për-

shkruaj këtu më poshtë vjershën e V.
Pashës..

Mori Shqipëni e mjera Shqipëni
Kush të ka hudhë me krye në hi?
Ti ke pasë kenë një Zonj' e gjanë
Që burrat e dheut të qujshin nauë
Ke pasë shumë të mira e shumë begati
E vajza të hukura e djem me trimëri
Gja e dhena shum e ara e veshtina,
Me armë të lara me pushk shkreptina.
Me burra trima me gra të dlira,
Ti nér gjith shoqet ke qënë ma e mira.
Kur kriste pushka si shkreptin moti,
Zog' i Shqipëtarit gjith mon' i Zoti.
Ka pas qënë nér lufta e në luftë ka vdek,
E dhuni për prapa kur nuk kish hek.
Kur ka pas lidhë besën burr' i Shqipërisë,
I ka pasë shti dridhmën gjithë Ruinelisë.
Nér lufta të rrepta gjith mon ka ra.
Me faqe të bardhë gjithëmonë asht da.
Ene s'të ka metë as fam as besë,
Vet' e ke prishë me faqe të zezë.
Ju Shqiptar me vëllazën jini tui vra,
E në një qint çeta jini shpërnda.
Ca thonë kena fee ca thonë kena din,
Njani thotë jam Turk tjetëri Llatin.
Do quhet Grek ; Shqë disa të tjërë,
Por jeni vëllazën gjith mor të mjerë.
Priftnit, Hoxhët ju kanë hutu,
Për më ju damun e më ju varfënu.
Vjen njeri i huj e ju rri në votër,
Për më ju turpnu me gru e më motër.



Për sa pare tē shkreta që do tē fitoni,
Besën e tē parëvet tē gjith' e harroni.
Ene bahi ropt' e njeriut tē huj,
Që nukë ka as gjakun as gjuhën tuj.
Qani ju shpata qani ju dyfeqe,
Se u zu Shqipënia si zogu nē leqe.
Tē qajë trimënia tē qaj bashk me ne,
Se ra Shqipënia me faqe nē dhe.
Ene s'i ka mbetun as bukë as mish
As zjam nē votër as drit as pish
As gjak nér faqe as ner nē shokë
Por asht rrëzumun asht bamun trokë
Mblidhuni ju vajza mblidhuni ju gra
Me ato sytë e bukura që dinë me qa
Ene tē vajtoni Shqipërin e mjerë
Qi ka mbet e veje si grua pa burrë
Si nana qi nuk ka bamun fëmi kurrë
Kujt i ban zëmra me lan me vdek
Kët far trimënish as po dot e lam
Kët nanë tē dashme as po dot' a lamë
Qi njeriu i huj t' a shkeli me kamë ?
Nuk nuk këtë marrëzi kur kush s- e do
Kët faqe tē zezë kur kush s' e duro
Para s' e tē humi kështu Shqipënia
Me pushk nē dorë le tē vdesë trimënia
Çohni Shqipëtarë prej gjumit çohi
Tē gjithë si vllazën nē një besë shtrëngohi
Ene mos shikoni Qisha e Xhamia,
Se feja e Shqipëtarit ashtë Shqipënia
Që prej Tivari deri nē Prevezë,
Gjithë kun ku Iëshon dielli vap e rezë.
Ashtë toka jonë pleqt na e kanë lan
Kush mos na e përkas se vdesëm tē tan.



Se vdesim si burrat që vdiqnin që motit,
Për mos me u turpnu para Zotit.

Gjithë kombet e botës sakrifikojnë më ç' do mënyrë therorë për lartësimin, lulëzimin dhe sigurimin e jetës kombëtare duk' e përnderuar nisiatorët, fatorët që shërbijnë ca më shumë sigurimit e interesit të përgjithëshm por sot për sot në Shqipëri është për kundrazi. Qeverria rrebele q' u formua në Durrës pas ikëjesë lartësis së tij Mbretit e cila sundohet prej njëj Komisioni që filloi më 22 Vjesht e I të përbërë prej delegatëve rrebelë të kujdo qyteti vendosnë si kryetar të komisionit Mustafa Ndronjën më q' ay kish qënë më i pari guximtar në kryengrijtjen me flamur të huaj për të çkatërruar organin e shënjtë të kombit. Fillon pra nga puna e marrëzuar të sundimit e saj rrebel me shpirt, më shënja dhe më gjuhë të huaj, me antarë të atillë ideje si dhe me një kryetar që s' të ka as një cilësi për veç therorinë që ka bërë duk' e ngulur barakun e Turkut më i pari.

Një lloji Qamil Elbasani, rrebel kundra rrebelëvet kërkoi të pushtojë qytete më luftë.



Mb' anë tjatër Greqia duk' e përfituar nga sundimet antikombëtare sulmon më të gjith' anët. Më 20 Vjesht e I. në Lopës, Bolena, në malet e Tërbac — Vranisht, më 26 të Mait në Skrapar e Tomorricë dhe më 27 të Mait ryri në Berat. Të dy fuqitë kryengrijtëse të përbëra prej dy luarish njërës antiidealiste përpinqen njëra më tjatërën duk' e dëshruar si të marrë, të shtyjtur nga të huajtë cila më shumë të gjërësojë vëndin e saj!. Italia përgatitet për t' ardhur në Shqipëri mbasi e mbaroi qëllimin si deshi vetë, por ajo tash përtash akoma e asnjëanëshme në luftën botore, nuk' i jep dorë kaqë shpejt të hedhë këtë çap të duhur. Për të mos parë kundrështim kur ajo do hedhë çapin e pushtimit në Shqipëri tha të duroj deri sa Shqipëtarët të murziten nga grindëjet e tyrej të përbrëndëshme dhe vendosi aillokimin e Shqipërisë duk' e mos lënë të vijë në Shqipëri as një lloji ushqimi.

I par'i tradhëtorëvet Esati merr në dorë frën' e Qeverrisë rrebele.

Esati duk' e përfituar nga inflyenca antinomike që kish trashëguar me kohë nga populli fanatic fetar të pa ndienja kombë-

tare të cilët pandehnin se ay duaj t'u mbaron kërkimet e pa arrësyshme dhe të dëmshme për enteresin jetnore të tyrej; mori guximin të lozë dramën më të madhe në maskë të fesë duk' e vënë në veprim programin e çkatërimit të shtetit për të siguruar enteresin dhe bujën trathëtore të tij.

Gjithë ay gjak si lu'në q' u derth prej popullit fanatik kondër enteresit jetnore dhe iderit kombëtar që shkakëtoi përfundim i dramës trathëtore, për fat të keq shkakëtoi rrezikun e Shqipërisë eroike dhe sigurimin e interesaset personale të tradhëtorëvet si Esati me shokë.

Përfundim i programës të fqinjëve t'anë armikër të cilën Esati me shokët e vëtë e vunë në veprim, ish e bazuar që pas çkatërrimit e organit kombëtar, Esati ish siguruar të quhej Princ në Shqipëri të mesme e cila natyrisht duaj kish një jetë fort te shkurtër dhe pjesat e tjera të Shqipërisë duaj t'i mirr Italia, Greqia, Serbia dhe Malizi.

Mësasi Esati i kumbisur n' inflyencën antilligjore i arrijti qëllimit të përfundojë dramën e trathëtisë në kurris të popullit Shqipëtar, duk' e çkatërruar Qeverrinë le-



gale, organin e shënjtë shpëtimtar Kombëtar; shkoi n'Itali të prëhet. Mbasi mori çpérblimet e trathëtisë dhe sigurimin e enteresavet q' ushqente në dëmin e Shqipërisë nga dhiplomacia e atij shteti, shkoi te Venizellua i Greqisë dhe te Pasiçi Sërbisë ku gjith'ashtu u lith mirë me armiq-të shekullorë të kombit Shqipëtar të cilët ishin të gatitur në plotësimin e ndihmës së tij kur t' a lypte nivoja duk' e turrur, pushtuar vizet e Shqipërisë eroike.

Në një kohë kur Qeverria rrëbele ! gjithë fuqin e saj e kish në Skrapar duk' e lëftuar me Greqinë, Esati i bashkuar me 5 mijë Malësorë Dibranë e të tjerë arrijti si kuçedra në Durrës ku pa fare kundrështim mori frën e atij sundimi në dorë.

U ngul bukur në Pallatin Mbretënor; u xgjoth si kryetar i asaj Qeverrie dhe lajmëroi vizet dhe shokët e tij rrebelër në gjuhë Turqisht dhe zyrtarisht duk' e i u thënë se Shqipëria do të mbetet nënë hie të Turqisë e më së fundi do të kryesohet me një Princ nga Trashëgjimtarët e Turqisë.

Me mënyrë dëshpërie thërrët Qamil Elbasanë i cili i kundrështonte rreptësisht me armë dhe e burgosi; gjith' ashtu dhe të tjerë kundrështarë të tij arrijtin në rrë-



zikun e humbëjes të jetës e tyrej. Për të fituar akoma sympathi fali të dhjetat, ndaloj pullat me zhgabë si dhe gjuhën Shqip, flamurin kombëtar e vulat në gjuhën amtare të zyravet.

Kryetarët e komisionevet të ç' do qyteti po ven' e vijnë në Durrës për të treguar plotësisht bindëje duk' e çfaqur se ata do të jenë kurdohera gati të sakrifikojnë jetën e tyrej për themelimin e idesë, të formësë Turkomane në Shqipëri.

Për veç fanatikëvet fetarë të cilët ishin të siguruar se ay sundim duaj qe i rrënjosur por dhe shumë njëritë idealistër të cilët ishin lodhur së kundrështuari si me armë ashtu. me pëndë, fatkeqësisht e përkranë atë sundim trathëtor për t' i arrijtur qëllimevet, ambicivet dhe egoizmavet personale. Shumë pulle postare me fytyrë të Skënder beut u shitnë në fanatikërit rrebelë mbasi u vunë një vulë Turqisht e cila këndon (Arronautlëk postallari) dhe Italisht (posta Albanese) ku në mes të vulës një yll i cili tokonte mbi fytyrën e Skënderbeut.

Esati përpinqet ng' an' e Veriut e e Perëndiunit të shqipërisë të gjërësojë sundimin rrebel si në Skodër e në Malësi gjithë ashtu dhe në mirëditë. Por mbasi idealiz-



ma e atyre vëndëvet i kundrështoi, vendosi Qeverria rrebele t' i bindë me fuqi. Mbëlodhë gjithë ushtarët duk' e i shtrënguarë e duk' e i u djegur shtëpitë atyrej që nukë do të marrën pjesë. Në Vlorë, për këtë qëllim dolli vetë komisioni për t' i bindur katundet që t' i apën ushtarë sa më parë. Por shkaku i mos bindëjes n' atë urdhër dhe vendim i popullit për t' i kundrështuar me armë shtrëngoi kryetarin e komisionit besnik i fortë i fronit t'atij sundsmi të vejë me të çpejtë te Esati ku përfundim i bisëdimevet të tyrej shkakëtoi dërguarëjen natën në Vlorë me Vaporrr të 500 rrebelëvet. 3 Vjetht' e III qyteti kënditur me rrebelë, valon fla nuri i Turqisë dhe këngë Turqish. Këjo fuqi rrebele mori tërë municionet, mbëlodhi armët si në Kaninë ashtu në Nartë dhe i dërgoi në Durrës. Kuman-dant' i tyrej Mustafa Ndروjani me fuqin' e komisionit të Vlorës zunë 40 kundrështarë të cilët i shpunë syrgjyn në Durrës, Komisioni u dorëzoi shumë të holla nga të arkës. Nga këjo therreri dhe besnikri e madhe që tregoi Z. Osmën, fitoi simpatinë e kryetarit të Qeverrisë Rrebele; Esati e emroi Prefekt si më vonë kur tërë qytet sundoheshin prej të tillë Hoxhë fanaticër.



njërës të pa dalur kurrë në fushën politike kombëtare.

Dëshir'e armiqve fqinjër q' ushqenin në dëm të Shqipërisë u mbarua plotësisht nga trathëtorët të cilët përdorë ç' do mënyrë dëri sa i çkatëruan kreit bazat e forta kombëtare vënur prej kuvëndit të përgjithshëm të Ismail Qemalit.

Italia pushton Stazanë, nukë shkoi shumë ditë kur Greqia dërgon ushtarë të tjerë të rregulluar në Shqipërinë Jugore të cilët përveç që ishin të ngarkuar me munitione por në vënt të flamurit Epirot vari flamurin e saj. Gjith' ato vize në të cilat ish çpallur komedia e aftonomisë Epirote u funë kreit në sundimin e Greqisë e cila çpalli n' Evropë se ky pnshtim do të jetë i përkohëshm me që do të respektohet vendim i Konferencës së Llodrës si dhe i Florancës, gjith' ashtu dhe Italia.

Musa Qazimi, rrebel mbi rrebelë.

Me gjithë që Esati luajti shumë rrolë për t'i pasë të bindur rrebelët por, ata mbasi e panë mirë se në vënt të babës që dëshironin ay gati po u siell papën; u ngrijtën tërë qytetet e Shqipërisë e mesme



për kondra atij. Dha e mori dhe s' qe e mundur t' i bindë.

Musa Qazimi, Myfti i Tiranës i cili gjëndej po thua në vrejtëje në Durrës u bë miaft i zoti sa të gënjejë Esatin duk' e i thënë se ësht' i zoti t' i bindë kryengrijtësit. Mbasi u betua duk' e i u zotuar se do të qëndrojë kurdohera besnik' i tij shkoi pa durim në Tiranë.

Më qëllim kundreshtimi mbëlodhi popullin rrëbel dhe mbasi çpalli kryengrijtëjen u derdhë për mbi Durrës, pushtuanë miaft vënde, Esatit i mbeti vetëm Durrësi dhe Vlora. Dy fuqi rrëbele të çnderuarë nga nderi njërejzor dhe kombëtar po lëftojnë rreptësisht duk' e dhënë shumë dëme nga të dy anë.

Pushtim' i Vlorës prej Italianëvet.

Anarqitë, trubullimet, mizoritë dhe varfëritë që vazhdojnë prej shumë kohë në Shqipëri shkakëtuanë që opinioni publik erdhi më një shkrillë sa nukë munt t' i bëhet ballë.

Më nj' anë Greqia, m' anë tjetër luftimet midis të dy Qeverrivet rrëbele shkakëtoi pa fare kundreshtim, t'i ulet duk' e i thënë dërrit dajko më së fnt dhe Italisë e cila



mbas pushtimit e Stazanit bëhet gati pér në Vlorë.

Kushulla Italiane ish marrë vesh me kohë më parësinë Atdhemohonjës të cilët kishin përkrahur komedinë Esadiste përt'i arrijtur ditës që të mbarojnë dëshirat e trathëtisë me ardhëjen e Italisë në Vlorë. Kish bërë një Spital për të vobektër, kish hapur një shkollë, kish qirtur muzikën në mës të qytetit, kish bërë ca golupe në sqelë për kuaj, shëtisnin në qytet tërë një ushtarë kalorës të cilat qenë shënjat e push-timit.

Dita 24 Shënëndre 914 u hap fjala prej prapagandistëvet Italianë se (nesër dotë gjajë një gjë këtu në Vlorë). Më të nesëret 25-XII-1914 ditën e Prëmte në mëngjes ora 7, hidhen kobure më shumë vënde prej Elmas Aliko Golëmbit, Zeman Delvina dhe Lame Golembit të cilët ishin të paguarë prej Çakos duk'e bërtitur (erdhi Greqia). Njëri u zu dhe dy të tjerët u funë në kushullatë Italianë.

6 vaporrë t'Italisë paskan ardhur në sqelë, ora ish 8 kur Amiral Patrisi hodhi dy gjashtara, qirti 1000 ushtarë detarë në sqelë, Prefekti ish në Durrës, zv. Ali Asllani shkoi te Kushulla ku i tha pse duallë



ushtarë Italianë në sqelë në një kohë kur këtu mbretëron qetësia — Kushulla i u përgjeq — nukë pyitet nga tinë ajo gjë për të cilën është marrë vesh Rroma e Durrësi.

Një trumë ushtarë mbenë në sqelë në vënt të Politit që përzunë dhe një trumë tjatër e bashkuar me ca Italiane që gjendenë në këtë qytet, në mest të njëj murzie e të njëit pikëlimi të popullit shkuan para kushullës ku brrinë me zë të lartë (viva nostra Valona) rroftë Vlora jonë. Një tufë ushtarë të tjerë shkuan për mes pazarit në kryesi të njei oficerit i cili kish nxjerrë kllëçin, ushtarët me dyfEQE në duar u sosnë në Prefekturë ku vunë nga një ballë fishekë në malipher dhe qëndruan pakë minuta. Komisioni si dhe parësia rrebele ish duk'e pirë kafen'e mëngjezit në Prefekturë, Ahmet Lepenica radhiti xhandërmarinë dhe i prinë ushtarët Italianë me nder armësh duallë në dritare dhe kuvëndoja në mbi shijimin e pemëvet që suallë nga sundim i tyrej që vazhduan me therori. Në Prefekturë Yalon flamuri Turk, që nd'atë ditë ushtarët Italianë mbasi muarrë në dorëzim pa kundreshtim Policinë dhe Xhandërmarinë pushtuan me radhë kodrat e Vlorës.



Në këtë kohë Prefekti rrebell Osman Haxhiu i cili kish vatur në Durrës me të holla për të marrë sympathinë dhe urdhërin definitif për Prefekt nga Esati, lajmëron Vlorën me telegram duk' e thënë — po vij me gëzim të math — gezim i cili nuk ish gjë tjatër për veç që siguroi nëpunësinë dhe që përfitoi dhe ay shijimin e pushtimit të Vlorës prej Italianëvet rriedhur nga sundimi rrebell dhe nga bisëdimet që bënин për hera menjërs Atdhe mohonjës.

Dit' e pushtimit më darkë herë u publikua në popull prokllami që vijon më poshtë prej Patris-it kumandant i divizonit detar dhe prej Kushullës Italiane.

(Proklamim për qytetarët e Vlorës)
Me rastin e çkarkesës në Vlorë t'ushtarëvet e defit Italianë u drejtua në qytetarët e Vlorës prokllami që vien më poshtë.

Qytetarë!

Trubullirat e mbëdha që gjajnë në këtë krahinë njëri mbas tjatërs e në kohëra të shkuara kanë paralizuar tregëtinë e qetësinë duk' e hedhur në rrezik jetën edhe malline e ndënjosëvet. Qeverria Italiane, ruajtës i vrejtëshm e kujdestar i fatit të Shqipërisë do që qetësia e juaj e vënë në



një shprovë kaq të madhe të jet e siguruar.

Të thërritur për ndihmë nga dëshirat t' uaj, ushtarët detarë t' Italisë shkarkchen sot ng' avulloret për të përbajturi rregullin e qetësinë edhe për të mbajtur juve.



Më 28 të muait pasdreke u hap lajmërimi verbal i Kushullës që më të nesëret dotë ngrihet flamuri kombëtar. Natet u hoq flamuri Turk i cili jetoi në Vlorë 3 muaj e 26 ditë.

Më 29-12-1914 që në mëngjes u radhitnë Gjendarmeria dhe një trumë ushtarë Italianë përpala Prefekturës, duk' e qënë gati një remet Shqipëtarësh, ora më 8 në mëngjes hapen 2 flamurë të paraqitur prej Amiralit, njeri kombëtar dhe tjetëri Italian nga të cilët i Italisë më të djathët dhe i Shqipëris më të mëngjër në portë të Prefekturës.

Arrin nj'ushtëri e shumtë stereje, i 10-ti regjiment i bersalierëvet nën kumandën e Kolonel Moskës të cilët muarrë vëndin në dorëzim nga ushtarët detarë.

Pas marrëjes në dorëzim të policisë dhe gjendarmarisë, nukë vonoi shumë kur Italianët muarrë me radhë në dorëzim Pre-



fekturën, Katundarinë. Postëtelegrafin, Doganën e të tjera zyra si dhe gjykatorët dëri sa u bënë zotër në pushtimin e përgjithëshmë të Vlorës.

Opioni publik i popullit fort' i dëshpëruar me shkak që kuptëtoi fort mirë qëllimin e politikanëve Italianë të cilët në kuvëndimet verbal tregonin vazhdimin e njëit politike të dobishme në të ndrejtat kombëtarë por mb' anë tjetër veprimet, punërat dhe qëllimet e tyrej të çfaqura n'a siguronin politikën e tyraj grabitëse dhe pushtuëse krejt në dënim, humbëjen e interesit kryesor të kombit Shqipëtar.

Tërë fuqia financiare Italiane q' u dërtahn' axhentat, spiunët e tyrej e ca më shumë mos kapaçitet' i Prefektitë i të tjerë autoritetevet Shqipëtarë me nëpunësira të trashëguara që nga autoritetet rrebelë të cilët nga pazotëi e tyrej nukë hiqnin dorë së vaturi e së kërkuar ndihmë n' autoritet Italianë, shkakëtoi q' armiku të hedhë miaft rrënje të forta uë dorëzimin, pushtimin e plotë të qytetit.

U bë zot tham Italia në Vlorë duk' e marrë në dorëzim tërë administratën e vëndit me nëpunës Italianë e me nga një



Komiser të cilët muarrë emërin (kujdestarët Mbretënor).

Fatkeqësisht nukë shkoi shumë kohë kur gjith' Administratat, gjithë Qyteti u ndryshua duk' e organizuar mbi gjuhë të tyrej e duk' e vartur jaftat. Italisht në portëra t' Administratavet.

Partizanët e Esatit, enteresantër, fanatikër të famëshm, autoritetër të trashëguar prej sundimit rrebel të cilët guxuan që Vlorës eroike t' i xhveshin petkat kombëtare, t' a veshën me pëtka otomane dhe më vonë i arrijtin qëllimit duk' e veshur me petka e me formë Italiane.

Shumë Shqipëtarë antikombëtarë të shitur nukë hiqnin dorë së vaturi për here te kushulla dhe te autoritët Italianë duk' e çfaqur veten si përfaqësonjës të popullit e si njerës dëshëruës, miq t' atij sundimi.

Këto marrëveshëje antikombëtare që vazhdojnë tërë një prej autoritetëvet e njërzvet në fjalë shkakëtoi guximin e bashkimit të shumë kombëtarëvet prej krahinave Mesaplik dhe Kudhës të cilët shkuanë pranë kushullës dhe i thanë këto: I falemi nderit fuqisë madhështore për masat që mori! jemi sigur se Italia, e madhe, mikesh e Shqipërisë nukë dotë na-



katoset në administratë e në shkelëjen e enteresavet kombëtare. Populli ynë nukë ka fare nonjë përfaqësonjës që të mirret vesh me ju. Po të këtë nevojë është gati populli të shënojë përfaqësonjës kombëtarë duk' e çfaqur që tash se autoritetët rrebelë nukë kanë më të ndrejtë përfaqësimi).

Ky kundreshtim patriotik i kushtoi miaft dhe shumë pakë i futi në dyshim autoritet Italianë të cilët formuanë zyrën politike, përkrahnë fanatizmën fetare duk' e i u bërë propagandën si mbas ëndës së tyrej. Zyra politike e përkrahur në fanatikët fetarë, n'autoritet rrebellë të cilët ca më shumë punojnë pa hequr për kondra enteresit kombëtar; nukë humbi kohë së vepruari me ç' do mënyrë për të ç' rrënjosur kreit nga trut' e njerësisë ndienjat e shënjta kombëtare.

Mb' anë tjetër Musa Qazimi po përparon dëri sa me shumë humbëje nga të dy anët kish pushtuar Durrësin më 5 të Shënëndreut 1914. Esati me fuqin e vetë u fut në vaporr, më 6 të atij muai bëhet një luftë ë rrepët përfundim i të cilës nga bombardim i vaporrëvet Italianë shtrëngoi fuqin' e Musa Qazimit të lënë Durrësin në duar t' Esatit. Më 31 Shëndëndre, fuqia



rrebele e Musa Qazimit kish pushtuar dhe Fierin e Beratin. Por në Berat filluanë lëvizëje, Bektash Cakrani pushton Ballçin' e Sëllishtn. Fuqia e Musa Qazimit mbasi lëftoi me Esatin pushtoi plotësisht prapë Beratin e Fierin më 16 të Jenarit 1915.

Fuqit e Musait me Esadistët lëftoi në Malas i cili është një orë lark nga qaf' e Murzinës, fuqia e Musait mbasi qëlloi me top hodhi lumin e Devollit ku nga Esadistët u vra Fërit Vokopola, Jashari më të vëllanë nga Malasi. Fuqia e Musait zunë katundin Bishovë i cili është një orë lark nga Ballçi. Bektashi u trëmp dhe duk' e lënë Qeverrinë në vënt arrijti në Vlorë. Zyra politike italiane me ç'do mënyrë përpinqet të çkatërrojë fuqin' e Musa Qazimit i cili mbasi e kupëtoi këtë dhelpëri ndaloj marrëdhëniet me Vlorë.

Malësorët e Veriut sulmojnë më një therori të Madhe dhe marrën Jakovën por një fuqi e shumtë sérbe më 15 të Marsit 915 e pushtuanë prap.

Fuqia rrebele e Musa Qazimit e shtrën-guar nga mos pasia ushqim, si të tërbuar më 23 Mars 915 sulen prapë përmbi Durrës duk' e bombarduar me top Pallatin e Mbretit në të cilën rrinte Esati. Tmerim i Dur-



rësit arrijti më një shkallë sa populli të banojnë anave dedit, Musa Qazimi, për të siguruar ushqimin e fuqisë së vetë mbëlodhi tërë drithët, pasuninë e popullit. Shumë të këqia bëjnë në Myzeqe. Duk' e qënë vetë gati Musa Qazimi në Berat, më 25 Prill 915 varrë, vranë shumë njërsi idealistër Shqipëtarë si Baki Gjirokastra me Smail Klosin, Doktor Kajana e të tjera të cilet sa doz' u vunë në plump pa fare mshire pse se deshnin nderin e mvehtësinë e Shqipërië e që nukë u bashkuan me luaritë por dhe në minutë të fundit nukë harruanë dëshmorët e kombit së thënuri pa reshtur " rroftë Shqipëria, rroftë flamuri i kombit ..

Trathëtor i math Esati me anë të Alush Loit kërkon të pushtojë Shëngjinë por mbasi nukë mundi dot të bëjë gjë as me fuqi, propagandë as me të holli shkoi në Shkodrë ku mbasi u prëgatit mirë me një fuqi të shitur e cila pandehë se duaj të kryente mejtimin e vetë duk' e vartur flamur e Turqisë ; filloi vënien në veprim të qëllimit. Kundrshtim i atdhetarëvet Shkodrianë shkakëtoi hidhrimin e rrepët nga të mos pranuarit e idësë fanatike dhe ashtu u sulsi i tërbuar të pushtojë Taraboshin. Hap flamurë e Turkut dhe gati të fillojë luftimi



me idelistet shqipëtarë. Kushullat rynë midis tyrej duk' e i porositur të rrijë Alushi i qetë së ndryshe gjën vëndi të zonë! Idea kombëtare e Shkodrës së famëshme kish aqë rrënjej të forta sa sulmet e fanatikëvet Esadistër të cilët nuk' e kupëtonin se më këto sielli janë duk' e rëmihur varrin e vëddit të tyrej; duall kreit të kota.

Fuqia Italiane, me përdorimet politike të këqia q'është duk' e përdorur në Shqipëri ka fituar një antipathi aqë të keqë sa nukë munt të përhapet në pushtimin e krahinavet të Vlorës për veç pakë katundevet në Topallti ku kish mundur të mbëlidhët gjith arët. Pra zyra politike kish vendosur që të sigurojë bindien e popullit me anë të mos dhënëjës e ushqimit: gjith'ashtu kish ndaluar tregëtarët nga të prurit drithë së jashtësini deri sa popull' i krahinavet të Vlorës me 6 Prill rrudhini në Vlorë me lutie të blejnë bukë. Shumë kohë shkuanë që zotimet e autoritetëvet italianë për t'u shitur drithë duallë të rrëme. Populli i mjerë u dëshpërua urish sa shumë vëtë i dhanë funt jetës së tyrej duk' e vrarë vehten, dhe shumë të tjerë si në Radhimë e tej u marrosnë nga të ngrënurit bar të helmurar. Lajmet që vijnë



në qytet më 22 Prill 1915 siguronin se në krahina të Vlorës kanë vdekur urish dhe kanë vrarë vehten nga ky shkak shumë njërs. Krahin' e Lopësit lajmëron autoritetët italianë duk' e i siguruar se ata dojenë gati të bashkohen me armikun Grek o me Musa Qazimin në qoftë se nuk' u dërgohet ushqim.

Më së funt, më 24 Prill 1915 mundët' arrijnë 1200 dhe më 7 Maj 1000 kuntalë drithë të cilat fatkeqësisht kush duai t'i merrte më parë.

Sot në këtë kohë kaqë të zezë e të rrezikëshme për veç vrásievët, varievët dhe vojtievet e popullit po bën ballë rreptësisht kriza ushqimore të cilat u shkakëtuan nga trubullimet dhe nga kryengrijtëjet e pushtimet më shumë sojë Qeverri.

Për veç gjysmë e Shqipërisë që Konferenc' e Llondrës e la në pushtim t'armikëvet por dhe gjysma tjeter q' ajo Konferencë e njohu për Shqipëri indipendente fatkeqësisht u bë qëndër' e lodravet, dramavet të feodalëvet e të trathëtorëvet të cilët shkakëtuan për ndarien në sundimet dhe Qeverrivet të poshtëthëna.

1º Qeverri e Shkodrës kreit kombëtare.

2º Qeverri e Durrësit m' anë t'Esatit.



- 3º Qeverri e Musa Qazimit që sundon Shqipërin' e mesme.
- 4º Vlora nënë pushtimin Italian.
- 5º Vizet e Shqipërisë Jugore nënë Greqinë.
- 6º Yizet e Veriut nënë Serbinë.

**Mjërimet, vojtëjet fatkeqe e barbare
në popull të shkakëtuara
nga autoritetët politikë Italiane.**

Italia, më së fundi mezi mundi të gatitet që të marrë pjesë në luftën botore e cila më 22 Maj 915 i preu marrëdhëni me Austrinë dhe më 23 ditën e Diell në mest nate filloi lufta midis tyrej.

Dit' e zezë filloi të duket, mjërimet në popull të Vlorës filluan të çfaqen që kur se Italia ryri në luftën botore nıbasi pa fare kundrështim politik hodhi në gëthetrat rrëçjepëse administrațën e vëndit.

Si lubi e madhe hapi gojën e rrëçjepur dhe po ngiste dhëmbët e gjatë, me buzë të zeza e të tmeruara filloi të drobitë trupa Shqipëtarësh për të bindur që të zapëtojë pa kundreshtim Malesinë e Labërisë. Por menjton një shkak, një mënyrë t' organizuar me anë të së cilës të fillojë duk' e vënë në



veprim programin e rrepët të pushtimit, të fatkeqësivet, të këqiavet dhe barbarizmavet natyrale të tyrej.

Ish në muain Maj 1915 kur Gastoldi i zyrës politike me mënyra dhëlpërie përkrahte fanatizmën për kondër idealistevet, i shoqëruar me Çakon, Ali Beqirin dhe me autoritetët e vëndit rrebelë bisëdonte mënyrën e krijimit të njei vepre fatkeqe e cila të shkakëtonte grindie që përcarëjë në popull dhe ajo më pastaj si lubi gjakpirëse të mbaronte qellimin e saj.

Plagosëj's Ali Beqirit prej armiqvet personal u paralizua si e shkakëtuar prej njëi komplloti Shqipëtar. Mbasi u organizua mirë komplloti dhe ankim'i të së plagosurit në gjyqin ushtriak — u vrava prej kompllotit Shqipëtar me që kurdohera kam punuar për kondra Shqipërisë në favor të Italisë — u vërtetua prej autoritetëvet rrebel Prefekt Osmën Haxhiu, Major Ahmet Lepenica, Elmas Bedini e shumë të tjerë filloj rreptësisht së vepruari gjyqi ushtriak duk'e burgosur ma se 50 idealistër kombëtarë. Me shumica ushtarësh rrethohen shtëpira, lidhen njërsës prej krahinavet dhe ashtu ca më shumë mbushën burgjet pitër më pitër me njërsës.



Gjukatoria ushtériake gjérsohet rreptësisht dhe plotësisht mbi hetimin e këtij komplloti i cili plotësohej aqë shumë sadita ditës gjérsohej më tepër deri sa arrijti më një shkallë sa të varen ca nga të quajturit kompllotistër të pa fajshëm me qëllim të rrënjoset ca më shumë armihu në vizet arbënore.

Gjyqi ushtériak më shkak të këti komplloti i dha popullit aqë një tmer e një frikë sa s'mbeti guxim njérëzie më që atëças lidhej dhe burgosej në binca të thella n'errësirë si antar i kësaj pune.

Përfundim i bisedimevet në Rromë mbi këtë çështëjë u nda më ndysh: Një parti dëshëronte që me faj pa faj të shduken ca nga kompllotistërit e një parti tjetër Parlamentare më e fortë i hoqi vrejtëjen Qeverrisë italianë që të vazhdojë një politikë pakë të kumbisur në bazat njérëzore siç e kish Austria.

Një komision i dërguar nga Rroma filloi ndrejtësisht në hetim të çështëjes e organizuar dhe vendosi lirimin e më të shumëvet pas 5 muaj burk dhe një pakicë prej tyrej u mërguan n'Itali.

Zyra politike e cila me përpjekëjet e saj pandehu se e çrrënjosni dhe çkatëroi



idenë kombëtare dhe për veç që u rrënjos ca me mirë por provoi tërë kundreshtarët të cilët filloi ca nga ca me qindra po thua t'i ndajë nga fëmij' e tyrej duk'ë i hedhur për kohë të gjatë në Sicilia e në Favinjanë.

Partia tjetër Shkipëtare që fituanë simpathin' e zyrës politike duk'ë i u ushqyér veprimin e qëllimevet të saj në dëm të Shqipërisë muarrë në punësira, fituanë shumë të holla me anë të tregëtisë. Por kush nukë kish besimin e plotë t'autoritëtëvet Italianë shkuanë një jetë të keqë duk'ë qënë në sytë keqë të zyrës politike, të Policisë dhe të Kärbinerisë të cilët nuk'i lejonin as pakë të luajnë nga shtëpit'e tyrej.

Italia e madhe u tregua aqë likështë për kondra një grusht njërsë Shkipëtarë sa popull'i shkretë i habitur, i shtypur kreit me anë të lubisë madhështore, të spiunëvet e shumtë e të disa persona antikombëtarë të përkrahur prej asaj fuqie, i dhanë guxim Italisë të mbarojë qëllimin e saj duk'ë demoralizuar ndienjat kombëtarë, karakterin dhe zakonin e duk'ë shtrënguar ca më shumë prapagandënë me anë të



shkollavet që hapi në çdo katunt mbi gjuhënë Italisht.

Gjuh' e shenjtë, Shqipija e duhur, e bukur dhe e vjetër e kombit bujar u ngre dhe librat mbenë të hedhuta në pluhurin e shumtë të bincavet e thella.

Ushtarët e shumë Italianë, 100 e camijë shpirt që çkarkuanë në Vlorë në Mars të 1916^{rs} e forcuanë akoma këtë discipline t'egër jashtë kufisë njerëzore dhe qytetënore të cilët u ngulë më ç' do kënt e më çdo katunt duk' e bërë forteza të plota dhe udhëra të shumta deri sa Vlorën e bënë një verdun të dyjtë.

Pat' i mbshëhet i Londrës 1915

Më parë duhet të përmëndëm, çështëjen kur Austria ishte në luft' e sipër uë një kohë që Risia e rreptësuar ishte unjur deri në Karpat, Italia mikia besnikë e Perandorivët qëndrore gjeti kohën më të bukur duk' e i paraqitur një notë Austrisë e cila përbante programin e kërkimevet Italiane. Me këtë mënyrë gjeti kohën më të mirë të përfitojë kërkimet e saj ose ndryshe ishte gati të mejtohej për vehte.

Pas këtyrej kërkimevet Italia duk' e



ngulur këmbë në programin e saj kërkonte akoma ng' Austria t' i njihet Vlora dhe kështu e tutje Austria të mos kish të ndrejtë interesimi as pak për punë të Shqipërisë kur Italia t' a përdorte si të duaj.

Franca dhe Inglitera i përkrahnin shumë interesat e pa ndrejfa t' Italisë e të Rusicë duk' e i u shkakëtuar ushqimin e lakëmimëvet për kondra sulmevet e Perandorivet qëndrore.

Austria e përulur dhe e shtrënguar miaft nga ushtëria Ruse, në Karpat, me qëllim të sigurojë asnje anësin' e Italisë për gjithë-kohën e luftës, u shtrëngua të njohë vetëm ca të drejta të veçanta t' Italisë mbi Vlorën. Pasi kuptohet nga nota e Italisë 8 Maj 1915 ku rrëzon lidhien Austro Gjermane midis Italisë e cila thotë — Austria vendosi të njohë interesin e veçantë t' Italisë mbi Vlorën — me gjithë këtë Italia pasi bëri marrëveshëje me anën tjatër Anglo Franceze, duk' e parë se Austria gjëndet gati në shkallë të çkatërrimit vendosnë politikanët Italianë të çpallën luftë kondra perandorivet qëndrore.

Mbas formimit e Patit të mbëshehët të Llondrës çpalli luftë koddra tyrej.



Austria, për të mburuuar veten e saj, si domos për të siguruar enteresat në Shqipëri me të çpëjtë i dha një shqelm të fundit Sërbisë dhe ryri në Shqipërë!

Pasi u përmënt më lart, kur Italia merrresh vesh me aleatët e vjetër për çështjen e asnjëanësisë të cilën duhesh t' a mbante gjer në fuñt të luftës; mb' anë tjetër prap n' atë kohë kish filluar në marrëveshëjet e mbëshehta me aleatët e rij. Dhipllomacia Italiane pëlqeu më mirë të lërë Aleatët e vjetër dhe të sigurojë enteresat e saj me Patin e mbëshehetët të Llondrës i cili u nënëshkrua më 26 Prill 1915.

Kyj Pat kreit në dëm të Shqipërisë bazi me zotimet q' i kishin dhënë Aleatët Esatit; i cili i ipite Italisë Vlorën me qarket e saj si dhe të ndrejtat e zotimit kundruall aleatëvet e rij për Shqipërinë.

Kyj pat i dëmshëm i cili gërmoi varrin e thëllë të kombit Shqipëtar i shtrëngoi italianët lakëmonjës të vërviten në luftë.

Kyj pat i djallëzuar për veç që Italisë i dha Vlorën, limanin e famëshmë dhe Stazanë, akoma copëtoi tërë Shqipërinë si nga Juga ashtu dhe nga Veriu duk' e i u a ndarë Sërbisë e Greqisë kur t' a detë nevoja. Mbenë në një mejtim që në ish e



mundur kur Shqipëri e mesme të formohej një Qeverri e vogël, të mos kundrështohej as njëra fuqi.

Aleatët, pasi ndanë Shqipërinë në fqinjët barbare dhe lakëmonjëse të saj, nukë harruanë fare mundimet trathëtore t' Esatit por dhe atij ja paguan shpërbllimin e veprës duk' e emëruar më vonë Princ n' atë copë Shqipëri të mesme e cila natyrisht duaj kish një jetë fort të shkurtër.

Lufta Italo-Austriake në qarke të Vlorës

Ushtëria Austriake, mbasi kupëtoi përfundimin e prishëjes së politikës me Italinë pa humbur kohë prishi Sërbinë fuqin e të cilës duk' e çkrehur këmbë në këmbë arrijti nd' anë të Vijosës duk' e pasur me vehte shqipëtarët e vizevet veriore si dhe të Kossovës.

I pari Airoplan Austriak arrijti në Vlorë më 19 të Marsit 1916. Filloi lufta midis dy fuqivët të mbëdha duk' e qënë të bashkuara me fuqi shqipëtare e cila shkakëtoi dëme të mbëdha nga të dy anët. Më 8-30 Qershor 916 vijnë shumë italianë të plagosur nga Vijosa në Vlorë. Durrësi bombardohet rreptësisht dhe më në funt ra në duar t' austriakëvet.



Më 13-14-15-16 Gusht bombardohot qytet' i Vlorës ku digjen shumë shtëpi e dyqanë.

Italianët kundrështnjnë me topa e me mitraloza. Luftime gjajnë si në tokë ashtu dhe në det. 11-12 Vjesht e III 916 u mbyt G. Bandini me shum' ushtarë midis Stazanit e Karaburunit i cili u varros në Vlorë. Italianët miaft të trëmbur futen pa pushim në për trinçerat e shumta të gatitura me ç' do anë ku n' atë kohë u shkakëtua një zjarr prej tyrej i cili dogji 126 copë dyqane.

Dëshir' e shqipëtarëvet të vizevet veriore për të marrë Vlorën me luftë u ndalua prej Austro-Gjermauëvet me shkak se Vlora mburohej me forteza në form modern e cila quhej një Verdun i dyjtë. Shtypi Gjerman kish çpallur kundër armiqvet tyrej në mënyrë se çështëj' e Vlorës ma me rëndësi për Perandoritë qëndrore nukë do të merte funt as me luftën e Vjosës, as me bisëdimet në Romë o në Vjenë por ka për t' u përfunduar ajo çështij me rëndësi në përfundimin e provimit t' armëvet që do të përdoren s' afërmë në Karso.



Pushtim' i visevet Jugore prej ushtërisë Italiane

Italia më 23 Gusht 1916 pushtoi Himarën dhe më pastaj pushtoi tërë vizet Jugore duk' e ndjekur Grekërit.

Franca dhe Italia me qëllim të shtrën gojnë Kostandin' e Greqisë të dalë ng'asnjëanësia dhe t'a bëjnë shoqe me vete, ushtëria Italiane pushtoi Janinën. Mbeti vëtëm Korça në të cilën Fransezet krijuan Republikën Autonome nënë mbrojtëjen e ushtërisë Franceze ku qirti dhe kartë monëllë n'ëmër të Korçës.

Në këtë kohë populli vlleh të Pindos ç' pallë Autonominë e Krahinës së tyrej si dhe ata të zgorit duk' e u bashkuar me Shqipërinë nënë mbrojtëjen e Italisë. Dëshir' e tyrej u paraqit dhe në kuvëndin e e pages më 24 të shkurtit 1919 prej Turhan Pashës q'ish kryetar i Qeverrisë Shqipëtare të Durrësit dhe krye Delegat i dërgatës në Konferencë.

Janina u lirua prej Italianevet me shkak që Venizellua besnik i Aleatëvet zuri vënd'e Kostandinit e ikur.



Politikë qesharake.

Franca nga Korça dhe Italia nga Vijosa përpiken të thyejnë fnqit e Qeverrivet Qëndrore duk' e qënë të bashkuara me Grë-kërit dhe me Shqipëtarët. Dhipllomatia Italiane, për të pasur Shqipëtarët besnikër dhe shokë të vërtetë në luftë kundër sulmevet e rrepët t' armikut çpalli më 3 Qershori 917 mvehtësin e Shqipërisë nënë mbrojtëje të saj me qëndër Gjirokastën duk' e përjashtuar Vlorën e me këtë mënyrë të mundë të sigurojë interesin e saj, të forcojë fuqinë morale të çkatëruar t' ushtërisë e vetë. Mb'anë tjetër, dhe Austria kish çpallur një të tillë gjë nënë mbrojtjen e saj.

Por ajo u bazua në mbrojtjen e të ndrejtavet kombëtare duk' e lënë administratën e vëndit në duar të Shqipëtarëvet të cilët kanë si kryeqytet Shkodrën. Austria nuk' u tregua pushtonjëse si Italia e cila u përpooq aqë shumë kondra interesavet kombëtare duk' e shtrënguar milicinë Shqipëtare të derdhë gjak të kotëshm dhë të humbasën shumë prej tyrej në luftën Italo-Austriake. Kohëra plot me hidherime në të cilën Italia filloi të shtrëngojë ca më shumë dhes-



potizmën e vetë duk' e mërguar njërsë të pa fajshm e duke vrarë, vartur dhe humbur njërsë Shqipëtarë me qëllim të mos guxojnë dot në formim të nonjëi marrëveshëje me kryeqytetin Shkodër.

Koh' e shkratë dhe anormale në të cilën spiunët e shumtë rrojnë të kënaqur dhe Patriotët e fieshtë vuajnë në për burgje duk' e mbetur fëmij e tyrej keq e mos më keq nga të gjitha. Këto mierime vazhduanë deri në kohëra të fundit të vitit 1920. Popull' i krahinave të Vlorës, i përulur fort duk' e i u bërë mes atyrej mjerimevet jashtë kufisë njërzore sa Autoritetët Italianë qenë sigur qint për qint se Vlonjatë nukë do të marrën kurrë guxim në kundrështim kondra atij sundimi. Por ata që ujihnin fort mirë psikologjinë, patriotizmën dhe therorinë e këtij populli ishin në dyshim se këto mizori të çuditëshme nukë kanë bërë gjë tjatër për veç themelinit ca më tepër t'idealit dhë të nderit kombëtar dhe çfaqën kurdohera që politika Italiane e siellur në këtë mënyrë ka shkakëtuar dëmin dhë çkatërrimin e vërtetë t'enteresit të saj.



Mënyra e xbritëjës të flamurit Kombëtar prej Italianëvet në Vlorë

Politika grabitëse e Italisë e cila në ballë u tregua si mbrojtëse duk' e ngrijtut flamurin kombëtar dori në 15 Maj 1916. Duk' e u themeluar mirë filloi së vepruari politikën batakçeshë në xbritëje të flamurit ku e vetmja shënjë kombëtare që kish mbetur dori tash pa grabitur. Më 17 Maj ditën e Mërkurë nukë ngrijtin as një flamur në Prefekturë. Pas ca ditëvet vazhdoi prapë ngrijtëje e flamurëvet. Më 20 Gusht prap nuk' i vari dhe atë ditë hoqi jaftat Shqip dhe vuri ato me koronën e Mbretërisë së tij.

Më 15 vjeshtë e parë 916 varet në zyrat e Qeverrisë vetëm flamuri Italian i cili vazhdoi së varturi rregullisht, lidhi Vlorën me Leçen duke njojur si një Provinçë të saj. Ndaloj rreptësisht sereemonin' e festimevet kombëtare ku që ditën që shkeli e deri afro 4 vjet nuk' u ndie fare në Vlorë nonjë festim o nonjë lloji këngë kombëtare.

Festim i 28 Vjeshtës e III të 1918, në mest t' asaj diçiplinë fatkeqe të fortë mundi të festohet prej njei grupit idealistër me nisiativën e Avni Rustemt e të Bairam



Hallkos të cilët ligjëruan rreptësisht në shesh të math përpara Kumandës.

Ligjératat e kësaj ditë qenë aqë të nxehtha sa filloi me nxitim të çkëthen dejat e ngrirë të Shqipëtarëvet por fatkeqësisht mungim i njerëzisë duk' e mos ardhur të marrën pjesë shkaktoi dyshimin duk' e mos i arrijtur qëllimit që të varën flamurin kombëtar në Prefekturë.

Ca pika më me rëndësi të ligjératës e bërë prej idealistik e dyjtë janë këto : Më vien shumë hidhur që sot në këtë festim të shënjtë rrëth flamurit kombëtar gjënden më shumë Italianë se Shqipëtarë. Shqipëtari duhet të mos t'a trathetojë, të mos t'i shuajë ndienjat kombëtare duk' e mos frikuarë, duk' e mos i u hequr ç' do rrezikut që munt të gjajë për arrësyë kombëtare. Të mos shitemi në të huaj se ajo dotë sjellë dëme të mbëdha n' Atdheu t' onë. Shqipëtari nukë trëmbet kurrë nga disciplina e ushtarëvet Italianë që gjënden rrotull nevëj. Pse se këta nukë kanë ardhur për të zapëtuar tokën t' onë të bekuar por kanë ardhur me qëllim të ndalojnë sulmet e armiqvet tyrej. Toka e bekuar e Vlorës e e tërë Shqipërisë është jona në të cilën duhet të rrojmë të lirë dhe asnje fuqi



nukë munt të na ndalojë dot nga kyj qëllim. Shqipëria mb' anë të Jugës e të perëndimit ka kufinë natyrale me detërat q' e ndajnë nga Greqia dhe Italia. Përtej buzës e Adriatikut është motra e madhe sylarushe dhe përkëtej në buzën lindore të Stazanit është motra e vogël syzezë të cilat vështrojnë njëra tjatërën me-sy të zgurdulluar „.

Karabinierët e shumtë Italianë t'armatosur vijnë rrottul gati ti ndalojnë por guxim i plotë i idealistëvet i ndalonte me frikë se duaj derdhej gjak dhe ngjarie e tillë duaj t'i kostonte më shtrenjtë politikës Italiane.

Politikanët Italianë u hidhruanë fort nga këjo nisiative e idealistërvet në një kohë q'ata nukë pandehnin me që popullin e qytetit thua po ë kishnë stërvitur në sermonit e festimevet të tyrej. Për shëmbëll seremonia e trekut të mbuluar më 31 Maj 918 e ajo e spitalit civil në Teferiq më një Qershori ku u kënduan shumë ligjërata të gatitura prej Italianëvet si mbas enteresavet e tyrej. Në të parën u fol thënia e gatitur prej zyrës politike nga Qazim Kokoshi Shqip, Petro Korçari Italisht dhe në të dyjtën V. Goxhamani e Seid Qemali



i cili ish emēruar Prefekt nē vēnt tē Os-mēn Haxhiut.

**Armē pushim i luftesë botore
dhe Konferenc'e Paqës**

Më 31 Gusht 1918 mundi tē vihet nē veprim çpallēj'e përfuncimeve tē marrē-veshëjet që kishin vazhduar deri tash mbuhehtazi prej qarkevet politikore midis fuqivet e mbëdha dhe Wilsonit t'Amerikës duke u pushuar lufta gjekësore 4 vjeçare që kish filluarë më 31 Korrik 1914; mbi bazë tē 14 pikavet e Wilsonit.

Gjermanët njërsë lufte, trima dhe tē qytetruar, tē përparuar më shumë se tē tjerët kishin pushtuar Rusin'e madhe dhe më pastaj i u resht Evropës me qëllim t'a pushtojë për t'i bërë ballë krizit ekonomik.

Dhipplomacia Amerikane u përpoq materialisht dhe politikisht për t'a shpëtuar Evropën nga kyj rrezik, nga këjo prishëje e domoshdoshme prej turrës Gjermane e cila e kish po thua si lodrë pushtimin e tyrej. Gjermania e qyteteruar me tē vërtetë, që e shtrënguar politikisht tē pushojë luftën duke marrë për sigurim tē liris'e popujvet tē ndryshmë bazën e tē 14 pikavet e Wilsonit.



Filloi pra të hiqet rregullisht nga vëndet e gjëra që kish pushtuar.

Pushim i armëvet filloj nga Bullgaria dhe pakë më vonë filloi rrivolusioni n'Austri i cili për pakë dit i dha funt Mbretëris'e famëshme të F. Zhozhefit. N'atë kohë ushtëria Austriake u shtrëngua të lërë vizet e Shqipërisë. Më të çpejtë ushtëria Italiane balloi duk' e pushtuar Shqiperin' e mesme dhe të veriut për veç Shkodrës e cila ish pushtuar më parë prej ushtërisë ndërkombëtare si dhe Korçës e cila gjendej në duar të Francezëvet.

Dhipllomacia Italiane, mbasi mori frën e Shqipërisë në dorë thirri të parët e kujdovëndi në Durrës ku me anë të këtij kongresi formoi Qeverrinë Shqipëtare, një Ministri nënë kryesi të Turhan Pashës dhe M. P. brëndëshme Myfit Libohova e të tjerë si Mustafa Kruja njërsë të simpatizuar prej Asaj Qeverrie.

Kongres i Durrësit i mbëledhur më 25 Dhjetor 1918, në mbëledhjen kombëtare, e mbaruan kuvëndin me formimin e një Qeverrie të përkohëshme së cilës i u vu për detyrë kryesore t' i rrëfente e t' i provonte botrs se në mest të Adriatikut e të Jonit me një anë, të Vardarit, të Bosnës



ë të Malit të Zi me tjatërnë rron një komp që kërkon vëndin e vetë ndërmjet shtetevet të lirë të Europës.

Një Delegaci Shqipëtarë nënë kryesi të Turhan Pashës natyrisht të ndihmuar me ç' do mënyrë prej dhipplomacisë italiane marrën pjesë në konferencën e paqes të Parizit duk' e i paraqitur kuvëndit e paqes kërkimet e interesatëshme të kembit Shqipëtar.

Për fat të këq dhipplomacia grabitëse italiane ngutet së nguluri këmbë rreptësisht së kérkuari porësinë (mandatën) mbi Shqipërinë dhe pushtimin definitivë të Vlorës. Anglia dhe Franca me qënë se kishin marrë barërë kundruall Italisë me faktin e Llondrës të mbushtehtë i cili ishte çfaqur prej Bolshevikëvet, nukë mundën të bëjnë ndryshe për veç të binden në njohëjen e kérkesavet italiane.

Gjëndej e polilitikës në këtë pozitë shtrëngoi Turhan Pashën t' i shtrohet n' atë mejtim. Disa antarë të Delegacisë çfajnë pa kënaqësin' e tyrej dhe mbasi e rrëzuan kryetarin e Delegacisë paraqinë rishtazi shkrujnë dhe protestime në kuvëndin e paqes. Në kundrështim të këtij mejtimi ishin shumica e Dhipplomacisë Shqipëtarë.



Por për fat të keq nukë panë as një përkrahije prej fuqivet të mbëdha. Mb' anë tjetër Italia thirri me të çpejtë në Paris. Myfit Lubohovën e të tjerë të cilët formuan shumicën duk' e bashkuar në mejtim të Turhan Pashës.

Delegacia Greke e përkrahur dhe ajo në ndihmën e fuqive të mbëdha kërkon të futë nënë sundim definitive tërë Shqipërinë e Jugës duk' e çfaqur se tërë orthodhoksët që banojnë në Shqipëri janë Grekë. Por këjo kërkesë u rrefuzua me prova të shendoshëta prej Delegacisë Shqipëtare.

Fqinjët, armiqjtë t' onë të rrepët me një organizim shekullor përpiken për dëmin e Shqipërisë, sa më fjalë aqë me pëndë e sa edhe me të holla ; mjete të cilat nevej nakanë pasë munguar kreit deri sot dhe sot ekëndiparë janë të pa miaftuëshme.

Sado që Delegacia e jonë u përpoq rreptësisht me memorandumet që paraqiti në konferencë prej Turhan Pashës d. 12 Shkurt, 24 Shkurt e tej por nuk munt t' i arrijnë dot qëllimit mbasi organizata e armiqvet nguti dhipllomacinë e pa shpirt njërzore të veprojnë në dëm të Shqipërisë tue kujtuar se mos njohëja mvehtësinë e Shqipërisë si me thënë të presën një ferrë, një



bimë te egër që i bën jezull përparimit njérëzor.

Konferenca e ca më shumë Vilsoni i cili njihte for mirë intrigat e fqinjëvet t' anë; mbeti në dyshim e në mosmundëje me shkak se sheh që Aleatët e tij Evropiane mbasi u siguruanë nga rrëziku Gjerman filluanë nga të mos bazuarit mbi të 14 pikat që kishinë pranuar më parë.

I vetëmi Vilsoni që bazohej mbi të ndrejtat kombëtare ngul këmbë duk' e dërguar në Shqipëri për të bërë hetimet e duhura mbi dëshirat e popullit në Shqipëri një Delegat Amerikan i quatur Gjyzepe Havanë i cili erdhi në proto të vitit 919 dhe shetiti gjithë vizet e Shqpërisë.

Kudo që shkeli si në vizet Veriore ashtu dhe në Jugore të Shqipërisë nukë pa nj'armoni të plotë me shkak se bajoneta Italiane nukë premtonte një të tillë guxim që populli të çfaqë dëshirat e zëmërsë kombëtare.

Gjenerral Ferrerua u përpoq duk' e shëtitur vetë tërë vizet me qëllim të preqatitë popullin që të kërkojnë porësinë Italiane. Shumë të holla derdhi, shumë propaganda me të mirë dhe më të keqë bëri por as një qytet nukë pranoi të çfaqë të tillë dë-



shirë për veç ca të pakë Grekomanë · të Gjirokastrës të cilët guxuan të kërkojnë porësinë Italiane me qëllim të përcajnë, e të trubullojnë opionin politik që të mos sigurohet drejtim i enteresavet kombëtare. Me gjithë që ceremonia e pritëjes së tij u preqatit mirë në çdo qytet për veç Vlorës por përfaqësonjësit e popullit nukë mundin të çfaqnin tërë vojtëjet, mos kënaqësitë si dhe ndalimin e shënjave kombëtare prej autoriteteve Italianë.

Shumë përshtypëje i bëri zotit Delegat në mefshtësinë që vazhdonte në popull' i cili brënda në një kohë miaft të gjatë të pushtimit prej Italianëvet s' ka pasë guxmin e shenjtë të sakrifikojë një lëvizie kombëtare me qëllim të sigurojë jetën e tij kombetare në një kohë kur fat' i vetë gjukohet para Wilsonit në Konferencë të Parizit.

E para armë e shenjtë, e para kryengrijtëje kombëtare është ajo e Përmetit më 6 Mars 1919 e cila tronditi aqë keq politikën Italiane sa Gjenerral F'errerua morri qërtime të mbëdha ng' autoritetët e tij.

Autoritetët në fjalë si në çdo qytet ashtu dhe në Përmet kishin marrë masat e du-



hura me çdo mënyrë për të mos ngjarë nj' e tillë lëvizëje patriotike që të qëllonte palcën e zëmërs të politikës Italiane duk' e qenë Delegati i shoqëruar me oficera dhe me Karabinerë të shumtë t' armatosur.

Qëllimi origjinal i kësaj fuqie t' armatosur ish të ndalonte qellimet dhe veprat e patriotëvet të vërtetë që të mos mundën t' i vënë në veprim por si qëllim të çfaqur kishin vënë shkakun se Shqipëtarët janë t' egër e munt të vrashin Delegatin. Dy oficerë Shqipëtarë nga të Milicisë e Përmetit Demo Korça dhe Bairam Hallko muarr guximin duk' e i paraqitur një notë Delegatit me anë të së cilës i bënin të ditur gjithë rrolet, dramat që lozta Dhipllomacia Italiana në Shqipëri për kondra parimevet kombëtare për të siguruar interesin e tyrej.

Delegati mbas bisëdimevet e çfaqura dhe të vecanta që bëri me Oficerat në fjalë iku gga Përmeti dhe n'atë kohë burgosen të dy idealistërit në fjalë. I madhi idealist Sihat Baga nga Nivica me shumë ushtarë shoqërohen me oficerët e burgosur dhe çpallën një rivolusion, një luftë të rrepët brënda në qytet duk' e vrarë shumë ng'armiqjtë dhe nëpër mes të gjith'asaj shumice duallë jashtë qytetit,



Trathëtim i disa Oficerëvet të tjerë Shqipëtarë që nukë vazhduanë në shoqërim të tyrej si mbas fjalës, mbytej e Demos në lumë nga shtrëngim i zaganjosies prej ushtërisë Italiane, vrasëj e Sihatit prej ushtërisë Shqipëtare në Nivicë, të kryesuar prej Kapiten Ali Sevrantt, shkakëtoi të mos arrijë në përfundim qëllimi i shënjtë i tyrej i cili kish për të sjellur pa tjetër pemë të dobishme në dobinë kombëtare.

Mb'anë tjetër Qeverri e Durrësit e cila kish kohë që vazhdonte një politikë të gabuar guxoi të pranojë kërkimet Italiane duke dërguar dërgatës Italiane në Paris një përmëndore me datë 14 Prill 1919 me anë të së cilës me gjithë që pikë së pari nuk'ë njohën Patin e Llondrës por pandehën që dotë jetë e mundur t'arrijë puna, me një ndreqie së bashku që të ruajë Italia Liman'ë Vlorës si dhe mandatën e Shqipërisë. Në këtë kohë ish e vetëmia shoqëria. Vatra e Amerikës e cila përpinqej si kurdoherë me çdo mënyrë të shpëtojë Shqipërinë nga rreziku. Por Dhipplomacia gjabitëse e Konferencës së Pariset fatkeqësisht kishte ardhur më një shkallë sa munt të thuhet çiltazi se ajo ishte bërë lobia e keqe, folea e intrigavet dhe të pa ndrejtësivët në kurris të



popujvet e pa fuqishm. Mbas kthyerjes e Myfit Lubohovës nga Parisi, antarët e Qeverrisë së Durrësit ishin në një mëjtim nevojërisht mbi përfundimin e anarqisë që mbretëronte në Shqipëri nga pengimet q'i dëftoneshin prej autoritetëvet ushtëriake Italianë. Mejtuau që të bëhej një akort në një mënyrë që të mos i përkishte indipendencës Shqipëtare duk'ë marrë disa masa të cilat rrithnin nga pushtimi provizor i ushtërisë Italiane.

Myfit Lubohova, Fejzi Alizoti e të tjerë bëjnë një akort më 20 Gusht 1919 i cili pa mos firmuar rregullisht prej gjithë antarëvet Ministrore dhe e dërguan në Paris, Pasi u pa prej Delegatëvet Shqipëtarë që nukë ruante frymën e indipendencës që ish për prensip, u rrefuzua dhe nga an' e tyrej u bë një kondër projekt i cili pasi ju komunikua Delogacisë Italiane në Paris, një kopie tjatër i u dërgua Qeverrisë së Durrësit për t' i a komunikuar Dhipllomacisë e Romës me të cilët kishin kuvënduar.

Fatkeqësisht vanë të kota gjithë shpresat e Shqipëtarëvet q' ushqenin nga gjyqi naltë i Parisit me qëllim se ay duk' e mbështetur ndrejtësisht mbi parimet kom-



bëtarë duaj të fut në gjin' e mëmës së tyrej dhe Kosovën e Çamërin akoma.

Vate kot dhe shpresë e popujvet të tjerë të cilët derdhë gjakun si lume në luftëngjakësore 4 vjeçare duk' e shpresuar se do sigurojnë lumtërinë njërëzore të trashëguar. Gjithë kejo shpresë ishte e plotë dhe mbasi u nenëshkrua armistica e pastaj. Gjithë kyj gas arrijti të kthehet në dëshpërim që kur filloi padrejtësia nga mbledhëja e përfaqësonjësvat e kombevet luftëtarë në Paris për të xgjidhur problemat e fështira të përbotëshme.

Kur bisëdimet e pa ndrejta zunë të çfagen prej Konferencës së Parizit gjithë bota e pa fuqishme si dhe ca më shumë Shqipëria ushqente shpresën e shpëtimit vetëm nga Vilsoni i cili duaj të vepronë pa tjetër të 14 pikat e pranuara prej fuqivet në luftë.

Lloyt George, Clemenceau dhe Orllan-
dua me Venizellon të mbështetur në Dhipplomacinë grabitëse të vjetër murziten të nxjerrën në shesh të ndrejtën edhe nga kyj shkak i shtrojnë përpara Kartëra të firmuara prej Shqipëtarësh si dhe prej Qeverrisë së Durrësit kú thoshin — pa fjalë nënë frikën e bajonetës, se nukë janë



të zotërit t' a qeverrisën Shqipërinë dhe i luten Konferencës që barrën e Qeverisë Shqipëtare t' i a apën Italisë të cilat vijnë një me parimet ndërkombëtare që kishnë për prensip të 14 pikat.

Me të vërtetë Vilsoni kish perpara dhe shumë memurandume dhe shkresa të shqipëtarëvet kombëtarë të cilët përfaqësonin dëshirat e vërteta të kombit Shqipëtar por duk' e i kqyrur të gjitha me radhë i u mbush mëndia se shumica rëndon ng' an e Italisë; gjith' ashtu u bint dhe çfaqi mendimin e tij mbi pushtimin e Skelës së Vlorës, dhe mandaton e Shqipërisë. Në memorandumin e 9 Shënëndreut 1919 që i u dërgua Ministris' e Jashtësme t' Italisë prej konferencës njihnin pushtimin e Vlorës prej Italisë si dhe mandaton mbi tërë Shqipërinë.

Më 14 Janar 1920, Anglia, Franca dhe Italia, duke përfituar nga mos gjëndëj e Vilsonit çelnë bisedimin e Adriatikut dhe në vendimet që dhanë rrëzonin kreit kuptimin e memurandumit të 9 Shënëndreut 919 me qëllim të ndajnë Shqipërinë midis të tri fuqivat si mbas Patit e Llondrës përt' i pasur në një armoni të tri fuqitë, Itali-Serbi-Greqi.



Më 10 Shkurt 1920, Wilsoni u dërgon një notë t'ashpërë më anë të sëcilës i proteston rreptësisht mbi vendimet e pa ndrejta q' u bënë pa pëlqimin e Amerikës duk' e u dhënë të kupëtojnë se nukë munt të ndahet Shqipëria.

Në përgjigjëjen e 17 Shkurtit 1920 q' i dhanë Amerikës Anglia dhe Franca i bënë të njojur pranimin e kupëtimit të memurandumit 9 Shënëndre 919.

Pra nukë mbeti më gjë për Shqipëtarët Idealistër për veç të ngrihen me armë në dorë, t'i tregojnë tërë botës se tërë shkresat, memurandumet dhe tërë argumentet që u prezantuanë në konferencë janë të rrëma e në kundreshtim me ndienjat e vërteta të kombit Shqipëtar i cili ka dëshirë të pa tundur të rrojë i bashkuar edhe të jetë zot në vete në Shqipërin' e tij të dashur.

Shkaqet të cilat ngutnë popullin Shqipëtar të mbledhen dhe mbasi të formojnë një Qeverri provizorë, të shtien Qeverrinë e Durrësit; ishin të shumta, por ato ma të parat janë këto:

1° Deshpërim i math që ndjen populli mbas lajmëvet të fundit për vendimin e 3 fuqivet të entëtës pëycopëtimin e Shqipërisë.



- 2º Vendimet e Qeverrisë së përkohëshme të Durrësit iashtë tagrit e kompetencës e kondër programit që i u ngarkua prej kongresit e Durrësit më 25 Dhjetor 919.
- 3º Pëngimet që ka treguar Qeverria e përkohëshme për ndalimin e mbële-dhëje të senatorevet të vendosur prej kongresit të Durrësit si mbasdëshirës të popullit, e përzëmëria e tyrej me shndërim prej Feizi Alizotit.
- 4º Anarqia, pa qetësia që mbretëronte në gjithë vizet e Shqipërisë të shkakëtuame prej pa kujdesisë të Qeverrisë e Durrësit.
- 5º Mos vijim i Delegatëvet nepër detyrat e tyrej në Durrës e largim i tyrej prej detyrës pa arrësy.
- 6º Ndalimi zyrtar e intrigat dhe vrassëjet politike të përdorura për prapsimin e mbledhëjes të kongresit kombëtar të Lushnjës i dëshruar prej gjithë popullit shqiptar për të dalë zot Atdheut që ndodhet në rrezik.
- 7º Projektet e lidhëjet, dhe gati pranim i protektoratës prej tyrej pa kompetencë e pa mos u biseduar çash-



tëja nga një mbëledhje kom-bëtare.

Kongresi Lushnjës.

Që në Veri deri në Jugë të Shqipërisë, qìell i Shqipërisë ishte nxirë e bërë skë-terrë, ato rë të zeza vinin rrotull mbi krye të njerëzisë ku tregonin se si kur s'kish mbetur më as një shpresë për kombin Shqipëtar.

Mund' ato kohë kur filluanë ashpërisht rëtë e skëterme e të rrezikëshme të mbu-lojnë malët, vëndet e bekuara Arbërore çohat dor' e hekur' e idealit fisnik t' a shpë-tojë Shqipërin' e dashur.

Fat mirësia e vëndit bujar, Arbënор të bekuar në një kohë kur tërë bota e qyte-tëruar kish vendosur varrimin e saj duk' e copëtuar në duar të fqinjëvet barbare; u ngre një fuqj kombëtarë kraharuar hëkurt, e shtytur natyrisht nga ndienjat fisnike e cila çpalli bujarisht në botën Evropiane dnk' e i thënë se fati Shqipërisë dipendohet prej bijvet e saj bujarë.

Mbëledhije famëshme e njei grusht Shqipë-tarësh në Lushnjë çau, shtëmëngi rët' e zeza dhe prishi e çkatërrroi tërë vendimet e mar-



rëveshëjet të pa drejta të botës e të qarkevet politike q' ishin në dëm të Shqipërisë.

Ajo mbëledhëj' e famëshme e kongresit në fjalë e përbërë prej Delegatëvet e kujdo vëndi nënë kryesi t' Aqif Pashës u mbëloth në Lushnjën stratigjike më 21 Janar 1920 e cila pati për qëllim të përmysë Qeverrinë Shqipëtare të Durrësit që kish mejtim anti-patriotik dhe që ish vegël e verbër e Italianëvet si dhe të formojë një Qeverri mbi baza kombëtare duk' e mos pranuar asnje mbrojtëje të huaj në Shqipëri.

Ushteria Italiane që gjëndej më çdo kënt të Shqipërisë, Qeverria e Durrësit dhe Esadistët të bashkuar për kondra këtij kongresi ishin të siguruar në mbarimin e qëllimit të tyrej duke shpresuar se nukë do t'ish e mundur një grusht idealistër të vijnë kondra njëi të tillë fuqie madhështore.

Fatmirësisht dha pemë të mira përfundim i njeit rroli kombëtar duke bërë të binden Esadistët, duk' e u dhënë fjalë si mbas ëndës e tyrej se doj të thërrisnin Esatin mbasi të përfundohet qëllim i shënjtë i kongresit. Me këtë mënyrë Esadistët u bindë dhë muarrë pjesë së bashku me të tjerë kombëtarë të cilët mbasi formu-



Unë Statutin shumë të vogël kombëtar paraqinë një protestë te kuvend'i paqes në Paris e rë qarket politike të botës ku thanë : Shqipëtarët kombëtarë goditën të përmysën e të kthejnë së prapthi rrënjesh Qeverrin e Durrësit fillo Italiane dhe të formojnë një Qeverri fjeshtë kombëtare në Tiranë me qëllim të shpëtojnë Shqipërinë dhe të sigurojnë mvehtësinë e Shqipërisë me kufirin e 1913-ës.

Qeverri e Durrësit krejt aristokrati dhe antipatriote e bashkëpunuar me autoritetet Italiane kundreshtoi rreptësisht dhe me çdo mënyrë fuqie për të çkatëruar kongresin e shënjtë lindur prej idës fjeshtë kombëtare duk'e qënë Ministrat e asaj Qeverrie në mejtim e në politikë të gabuar se Shqipëtarët nukë janë të zotërit të rrojnë më vete të tyrej pa mbrojtëje të njëi Qeverrie të huaj. Mejtim i Dhipllomacisë fë Qeverrisë e Durrësit me gjithë q'ish krejt anti-kombëtare por ata besonin se duk'e ushqyer idetë Italiane në Shqipëri duaj shkakëtonte pa tjatër mürzinë dhe bindëjen e Sërbëvet dhe të Grekëret të cilët për të mërguar Italianë nga buza lindore e adriatikut doj t'ishin të kënaqur të formonin njakort në favor të Shqipërisë duk'e sakri-

fikuar Kosovën dhe Çamërinë Shqipëtare.

Besoj të kish qënë ca më mirë që kongrës i shënjtë i Lushnjës mbasi u formua dhe mbasi formoi statutin kombëtar ; më parë se të rrëzojë Qeverrinë antilegale të Durrësit të kish bërë një marrë veshëje me Sérbo—Grekërit të cilët jam sigur se ata për të siguruuarë buzën Jugor perëndimtare t'Adriatikut nga ndërhyrëja dhe pushtim i njëit fuqie të madhe fuqi e cila duajt'i dënon ata për vdekëje, pa fare dyshim duaj shkakëtonte sakrifisë e tyrej duk'e hequr lakëmitë mbi Kosovë e Çamëri me konditë që idealistët Shqipëtarë t'i vinin dërmën Italisë së madhe e cila duajt' ish për t'a një kalë e trashë në sy të tyrej.

Muk' u bë n' atë mënyrë e cila të prapstë lakmitë dhe sytë e zgurdulluar të fqinjëvet t'anë me fuqi t' akordevet politik dhe t' armës Arbërore me shkak se nuk premtonte koha dhe mb' anë tjetër Qeverria e Durrësit antiligjore e bashkuar me Esadin duajtë sill miaf trubullime e pengime derisa Qeverri e lindur prej kongresit e shënjtë të imbaronte marrëveshëjen me Sllavo-Grekërit.

Sado, që Qeverri e Durrësit dor' e fortë



e sëcilës ishte Mustafa Kruja, me zëmërim të math nguli këmbët të mos tundet nga froni duk' e quajtur kongresin e shënjtë i cili themeloi fronin e Shtetit si mbële-dhëje trathëtore por përpara sulmevet e fuqisë kombëtare që si vesa përpara diellit ku frika e popullit e bëri t' ikij natën duk' e lënë vëndin pa dashur në duar të Qeverrisë kombëtare të Tiranës.

Si mbaë Statutit e Shënjtë Kombëtar të Lushnjës ndofta mbi baza të forta kombëtare por si mbas kohës kritike e anormale me lëndë të lehtë; u formua Qeverri e lindur prej kongresit madhështor me kryeqytet Tinanën, me një kshillë të lartë prej 4 vetash të përberë prej ZZ. Aqif Elbasanit, Dr. M. Turtullit, Imz. Bumçi dhe Abdi Toptani, gjith' ashtu një Ministri nënë kryesi të Sulejman Delvinës, M. P. Brëndëshme Ahmet Zagolli, M. P. Jashtësme Mehmet Konica. M. Arrësimit Sotir Peci, M.-i Drej. Hoxha Kadria, M. i Financave Ndoci Çoba, M. i Post-teleg. I. Kosturi dhe i Botores Eshref Frashëri, si dhe përfaqësonjësit e kujdo qyteti që formuanë kongresin të cilit formonin Kshillën Kombëtare (senatorë).

Vendimet e kongresit shpëtimtar që dhamë zana të përgjithëshme janë:

- 1º Rrëzimi me zana të plota pa kundrështim fare, i të Qeverrisë së përkohëshme të Durrësit.
- 2º Zgjedhëj e Dërgatës Shqipëtarë pranë Konferencës së Paqes në Paris prj Imzot Bumçit, Mehmet Konica dhe M. Turtulli.
- 3º Zgjedhëj e Këshillës së naltë përtë përfaqesuar me aftësinë e Shtetit Shqipetar deri sa te vinte mbreti në fron të Shqipërisë të cilët janë: si ma nalt.
- 4º Zgjedhëj e kabinetit të përkohëshm nënë kryesinë e Sulejman Delvinës si u the ma nalt.
- 5º Formjm i një Kshille Kombëtarë prej 37 Kshillonjësvet me kompetencë parlamentare.

Shqipëria filloi prapë një jetë kombëtare si dhe ajo e 1912-13-14, por ky organ formohet pas kaq therori e sakrifica dhe prova të kohëravet e kaluara të luftëravet Evropianë, i themeluar në baza kombëtarë e i mbrijtur me gjakun e shënjtë të fisit Shqipëtar.

Mbretëria e Zhgabës filloi së vazhduari rugën e shpëtimit të kombit bujar dhë zhgaba trime 2 krenore po valon madhisht



në Tiranë ; gjith' ashtu dhe këtë radhë zhgaba çau ato re të zeza që kish mbuluar tokën e bekuar e brigjet e Adriatikut si më 1912 kur duk' e qënë i mburuar prej Profitit e lirisë Arbenore e të apostolëvet e tij më besnikë siguroi fronin dhe lirinë kombëtare, liri të cilën e kish grabitur një barbar që më 17 Nëntor 1467 ditë fatkeqë e vdekëjes së Skënder Beut.

Valon ay flamur i shënjtë i lirisë i cili u prit më 1912 prej Vlonjatvet me kënaqësi e mbasandaj shkoi në Durrës populli i cili e kish kundreshtuar e gjith' ashtu këtë radhë valon madhësisht në Tiranë ku dhe ata në kohen e Esatit e kishin kundreshtuar. Gjith' ata që e kundreshtuan zhgabën trime shënj' arbënore, ajo u vate pranë dhe u zbuti zëmerat e tyrej e u solli mirësinë e begatinë në fëmijat fisnike të tyrej.

Mb' anë tietër Italianët të cilët përmbannin në duart' e tyrej gjithë vizet Shqipëtare duk' e pare përparimin kombëtar, gjëndëj e rezikëshinë përtà, në të cilën gjëndeshin ; lanë me të shpejtë vizet e Shqipërisë duk' e hequr më ca vënde anë deti e në shumë në Vlorë e në qarkun e sajku kishin sy të veçantë.

Të mos shkojmë pa mos treguar katego-



rikisht se Delegacia e parë Shqibëtare në Paris me gjithë gabimet e saj, Dhipllomasht s' la gjë pa bërë që Shqipërisë t' i epeshin kufitë e saj q' i ka falur zoti dhe me shkresat e paraqitura në konferencë më datë 12 Shkurt 17 Mars, 8 Maj dhe 1 Qershor 1919 kërkoi jo vetëm tërësinë tokësore t' Atdheut pa varur në kufirin e 1913^a por edhe bashkimin e vizevet Shqipëtare që më lparë kongres i Berlinit dhe më pastaj konferencë e Llondrës më 1913 i kish këputur nga gjiri i mëmës së saj.

Mirë po kuvënd' i Paqes, pasi tham dhe më parë, ish poshtuar, ish vogëluar e ish bërë një vënt ku bisedohesh me dhelpëri Dhipllomatike duk' e marrë vetëm para sysh interes' i të fuqishmëvet e jo e ndrejt e të dobërtvet e e Kombëvet të vegjëj.

Përfundim dhe vazhdim i Konferencës së Parizit kish luajtur Shumë nga pikat kryesore të Vilsonit duk' e siguruar lakëmit' e fqinjëvet barbarë dhe në vënt që të vazhdonin ndrejtësish duk' e rrëzuar Traktatin e mbshëhët të Llondrës më 1915 e të dërgojës një komision ndërkombëtar për të kqyrur punët e për të vazhduar një plebivist të cilën nevej do t' a kishim pritur me një kënaqësi të plotë nga që e



dinim se s' kishim kërkuar vëndin e botës por ato të fjeshta dhe ndrejtësisht t' onat; ata n' a u përgjeqnë më parë me marrëveshëjen Titoni-Venizelos në Gusht 1919 dhe me pas me memurandumin që tham të 9 Shënëndreut 919 e me kompromeson që tham më 14 Janar 1920.

Tërë këto vendime e marrëveshëje ishin në dënimin e Shqipërisë ku me fort pakë ndryshime përsëritez gjithë pa ndrejtësia e traktatit 1915 duk' e bërë një Shqipëri të vogël, të dobërt e të skllavëruar. Pra populli Shqipëtar atë herë mundi të vijë në kupëtim se po shkelët e ndrejta kombëtare e se nukë munt të bëhesh punë të shpresuarit te një konferancë që kish përprensim tërë intrigat e gënjeshtërat e sidomos nukë mundimë dot Shqipëtari të durojë nënë thundërtë njëj Dhipllomacie t'atillë tue shpresuar sigurimin e jetë fatale siç ishte duk' e shpresuar Qeverri e Durrësit dhe vendosi të vdesë e t' a shesë shtrënjtë lëkurën e tij të varfër. U bë mbëledhej Lushnjës dhe u formua Qeverri e Tiranës e cila mori frën e popullit në dorë dhe punon pa reshtur. Por puna ish miaft e ndaluar nga që Italia ka ngulur këmbët e po mbahet rreptësisht në Vlorë si dhe prapë



ajo Itali përpinqet me çdo mënyrë e më anë t' Esatit duk' e çpyfur një farë Osmën Bali me shokë me qëllim të prishën Qeverrin' e Tiranës, të vijë Esati në vënt të saj dhe Italia mbetej në Vlorë.

Si më parë ashtu dhe në një kohë kur filloi vezhdim' i luftës së Vlorë Osmën Bala me të tjerë Esadistër të cilët u lodhë së kërkuar prurien e Esatit, trë herë bënë kryengrijtëje të rrepta dhe të ndihmuar me çdo farë mënyre e gjith'ashtu me të holla prej Italisë. Për fat të bardhë Kabineti Sulejmën Delvinës dor'e hekurt e sëcilës ishte pa dyshim si kurdoherë Ahmet Zogu, dijti t'u lozë rrolin më të math; gjith'ashtu më së fundi fuqia e Aqif Pashës; Mustafa Krujës dhe e Bajram Curit i arrijtin qëllimit duk'e i prishur kreit kryengrijtësit dhe shkakëtarët i burgosi në fortesë të Gjirokastrës.

Shërbimi më ndrejtësi më armoni, vazhdim i njëj politike të kënaqëshme prej Qeverris e Tiranës shkakëtoi përfundimë të mira në dobi t'Atdheut. Dorëzim i Korçës prej Francëzëvet në duar të Shqipëtarëvet më 26 Maj 1920 si dhe e Shkodrës prej fuqivet Ndërkombëtare t'Alcatëvet ku bashkim i të dy qytetëvet kryesore më



pöpull më të xgjuar e idealistër siguroi themelimin e mbretëris së zhgabës e ca më shumë fuqinë morale të popullit.

Politik'e përlorëndësme e cila përfundoi në një mënyrë fort të pëlqyer/ ndryshoi kredit opinionin publik të jashtësm, gjith' ashtu siguroi plotësimin e mejtimevet e të Idevet të popullit, shqipëtar, popull i cili me një bashkim të çkëlqyer mori masat e duhura si për luftën e Vlorës ashtu përvrasëjen e trathëtorit Esat, masa të cilat ishin të duhura e të domosdoshme sepse ishin dy ndalime kryesore që shërbën kurdohera të mos themelimit e të mos sigurimit e Shqipërisë së 1913^{ss}.

FUNT



Pakë Fjalë

Kemi nderin të plotësojmë një nga detyrat me të mbëdhë e një nga dëshirat e zhëmërsë kryesore e patriotike mbi lehtësimin e botimit të kësaj vepre të vlefshme e me rëndësi për të cilën ka pasë qënë çfaqur prej nesh sa kaqë herë nevoja e çpejt botimit e të dalëjes në dritë.

Nukë duamë këtu të bëjmë fjale mbi zotësinë, sjellëjen, karakterin e lartë, të fjeshtë e të asnjanëshm të auktorit mbasi njifet prej të gjithë qarkevet të ndryshm dhe nuhë munt të mohonet shërbimi q' i ka bërë At-dheut në raste të nevojshme por duamë vetëm t' a urojmë, t' a lavdurojmë për barrën e shenjtë e të rëndë që ka marrë për sipër për të cilën ka me u përkrahë si dhe kurdoherë që t' i arrijë qëllimit me sukse të plotë në përmbarim e realizim të idealit e shenjtë kom-bëtar për të cilën bën fjelë bujarisht në parëthënëjen e librit.

U përkrah dhe u ndihmua me fushatat q'u



bënë në vize e krahina të ndryshme me qëllim që ka për t' i shërbyer zgjimit, zhvillimit e arrësimit Shqipëtar e prandaj me shpresë të domosdoshme se libri ka me u pritë me entuziazme të plotë prej qarkëvet të ndryshme brënda e jashtë Shqipërisë; jo vetëm prej zotërijvet të cilët kanë shumë nevojë për të formuar një ide kombëtare mbi sa kanë gjarë në Shqipëri por ca ma shumë dhe prej zonjavet e zonjushavet Shqipëtare pët të mundur të rritën po me ato ndienja fisnike brezin e ri kombëtar; ay brez i ri i cili ka për t' i sjellur lulëzimin e fathardhësinë e shpejtë Shqipërisë kur ata të rriten prej nesh e mëmavet të tyrej me edukatë fjeshtë kombëtare siç thotë Viktor Hogua, që të rriten prej mëmavet e tyrej të zyguara.

**Fushatat e bëra për botimin e voprsës
Histori e Shqipërisë së Re.**

| | F. ari |
|--------------------------|--------|
| Zoti Ali Beqiri | 100,00 |
| Zonjusha Sadi Kreshpa | 40,00 |
| Zonja Ruki Kreshpa | 100,00 |
| Qarki Zonjavet të Vlorës | 300,00 |
| Demokracia Vlonjate | 200,00 |
| " e krah. Dukatit | 250,00 |



| | | Fr. ari |
|-------------------------------|---------------|---------------|
| Demokracie e krah. Mesaplikut | | 300,00 |
| " | " Kudhësit | 120,00 |
| " | " Topalltisë | 120,00 |
| Demokracia qytet i Beratit | | 500,00 |
| " | " Lushnjës | 100,00 |
| " | e Skraparit | 150,00 |
| " | e Kurveleshit | 300,00 |
| " | e Himarës | <u>190,00</u> |
| | shume | 2800,00 |

SHENIM :

I u falemi fort zotërijvet ndihmuës të cilët të shtyjtur prej idealit kombëtar kanë përkrahur sa kaqë herë botimin e veprës të dëshërueme e ca ma tepër nisiatorit e fushatave Z. Ali Begirit i cili me sjellëjet e tij fisnike ashtë tue i dhënë Demokracisë Shqipëtare provat ma të mbëdha. tue përkrahë realizimin e qëllimit kombëtar.

Vlorë 5-7-923

Auktori
S. HALEKOKONDI



| | |
|---|----------|
| Ardhëja e Mbretit në Vlorë | fazë 182 |
| Prap luft' e Beratit | » 194 |
| Rrebelet në Vlorë | » 195 |
| Mërgim' i Mbretit përkohësisht nga Shqipëria | » 200 |
| Proklollanimi që publikoi Mbreti para se të ikëjë | » 203 |
| Fat' i Shqipërisë në duar të rrebelet, vojtëjet e popullit, Qeverria rrebele | » 204 |
| I par' i tradhëtorëvet Esati merr në dorë frën' e Qeverrisë rrekele . | » 210 |
| Musa Qazimi, rrebel mbi rrebelë . | » 215 |
| Pushtim' i Vlorës prej Italianëvet . | » 216 |
| Mjerimet, vojtëjet fatkeqe e barbare në popull të shkakëtuara nga autoritetët politike Italiane . | » 228 |
| Pat' i mbshëhët i Llondrës 1915 . | » 232 |
| Lufta Italo-Austriake në qarkë të Vlorës | » 235 |
| Pushtim' i visevet Jugore prej ushterisë Italiane | » 237 |
| Politikë qesharake | » 238 |
| Mënyra e xbritëjës të flamurit Kom-bëtar prej Italianëvet në Vlorë . | » 240 |
| Armë pushtim i leftësë botore dhë Konferenc'e Paqës | » 248 |
| Kongresi Lushnjës | » 256 |
| Pakë Fjalë prej ndihmuësve | » 267 |
| Pushtat e bëra për botimin e pës Historie Shqipërisë së Re . | » 268 |

ΕΥΛΟΓΙΟΥ ΚΟΥΡΙΑ

ΑΑΥΓΑΝΤΙΟΥ ΕΠΙΦΑΝΙΟΥ

ΑΥΕΩΝ ΠΡΑΓΜΑΤΙΚΗ ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ



PJESË PARË

HISTORI

E

SHQIPËRISË SË RE

Mbi gjendjen, ngjarjet dhe ndryshimet
fort tentesratëshme të gjallërimit.

KOMBËTAR

PRES SALI HALLKOKONDIT

ΕΥΛΟΓΙΟΥ ΚΥΡΙΑΑ
ΑΓΓΡΙΩΤΟΥ

AYEQN API.



Kushton Fr. ar 5,00